

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR
ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR
2026–2040**

Tabela e Përmbajtjes

1	PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK	6
1.1	Hyrje dhe qëllimi i dokumentit	6
1.1.1	Rëndësia e sektorit minerar	6
1.1.2	Përputhshmëria me dokumentet strategjike	8
1.2	Kuadri Ligjor dhe Institucional	9
1.2.1	Korniza ligjore	9
1.2.2	Harmonizimi me acquis të BE-së	10
1.3	Institucionet kryesore	11
1.4	Arritjet dhe sfidat	14
1.4.1	Arritjet kryesore të sektorit minerar deri në vitin 2025	14
1.4.2	Sfidat kryesore të sektorit minerar	18
1.5	Vizioni i Strategjisë Minerare	25
2	PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	25
2.1	POLITIKA I - FORCIMI I VLERËSIMIT DHE NXJERRJES SË BURIMEVE MINERARE	25
2.1.1	Qëllimi i politikës	25
2.1.2	Situata aktuale	25
2.2	Objektivat Specifike	27
2.2.1	OS 1. Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve Gjeologjike	27
2.2.2	OS 2. Rivlerësimi i vendburimeve me rezerva ekzistuese sipas standardit ndërkombëtar UNFC (United Nations Framework for Resources/Reserves Classification).	27
2.2.3	OS 3. Integrimi i kërkimeve gjeologjike me planifikimin hapësinor, zhvillimin territorial dhe mbrojtjen e mjedisit	27
2.2.4	OS 4. Krijimi i mekanizmave të përbashkët publik–privat për financimin dhe promovimin e kërkimeve të reja gjeologjike dhe minerare.	28
2.3	Treguesit kryesorë	28
3	POLITIKA 2 - MODERNIZIMI, RICIKLIMI DHE DIVERSIFIKIMI I ZINXHIRIT TË PLOTË TË VLERËS NË SEKTORIN MINERAR	28
3.1	Qëllimi i politikës	28
3.2	Situata aktuale	29
3.3	Objektivat Specifike	30
3.3.1	OS 1 Rregullimi i kornizës ligjore për leje perpunimi në gjithë zinxhirin e vlerave	30
3.3.2	OS 2 Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit përmes teknologjive të inovacionit	30
3.3.3	OS 3 Rritja e përpunimit lokal dhe e vlerës së shtuar në vend.	31
3.3.4	OS 4 Zhvillimi i industrisë përpunuese dhe ricikluese të lidhur	31
3.3.5	OS 5 Integrimi i zinxhirit të furnizimit dhe inicimi i projekteve strategjike në kuadër të Aktit Evropian për CRM	31

3.4	Treguesit e arritjes	32
4	POLITIKA 3 - SIGURIA, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	32
4.1	Qëllimi i politikës	32
4.2	Situata aktuale	32
4.3	Objektivat specifikë	33
4.3.1	OS1 – Rritja e sigurisë teknike në punë në sektorin minerar	33
4.3.2	OS2 – Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave minerare dhe rehabilitimi i zonave të ndotura dhe rehabilitimi i atyre të trashëguara dhe/ose ekzistuese.	34
4.3.3	OS3 – Zbatimi i standardeve mjedisore dhe certifikimi i impianteve përpunuese.	34
4.4	Treguesit e arritjes	34
5	POLITIKA 4 - Forcimi i kapitalit njerëzor dhe teknologjisë	34
5.1	Qëllimi i politikës	34
5.2	Situata Aktuale	35
5.3	Objektivat Specifikë	36
5.3.1	OS4.1 – Nxitja e interesit publik dhe e të rinjve për arsimin dhe karrierat në fushat e gjeologjisë, minierave dhe përpunimit të lëndëve të para minerale dhe në vecanti atyre kritike (CRM)	37
5.3.2	OS4.2 – Përshtatja e programeve arsimore, kërkimore dhe profesionale me kërkesat e tregut për profesione të reja të punës	37
5.3.3	OS4.3 – Krijimi i infrastrukturës moderne kërkimore dhe laboratorike që mbështet arsimin, inovacionin dhe industrinë minerare	37
5.3.4	OS4.4 – Nxitja e rikthimit të specialistëve shqiptarë të formuar jashtë vendit dhe forcimi i arsimit profesional në zonat minerare	37
5.3.5	OS4.5 – Rritja e kapaciteteve të institucioneve publike për monitorim, kontroll dhe menaxhim cilësor të sektorit minerar	37
5.3.6	Treguesit kryesorë të performancës	37
6	POLITIKA 5 - INFORMACION I INTEGRUAR DHE TRANSPARENCË NË SEKTORIN MINERAR	38
6.1	Qëllimi i politikës	38
6.2	Situata aktuale	38
6.3	Objektivat specifikë	39
6.3.1	OS5.1 – Krijimi i një databaze kombëtare të integruar dhe digjitale për të gjitha të dhënat minerare dhe gjeologjike	39
6.3.2	OS5.2 – Sigurimi i aksesit të strukturuar dhe të diferencuar për përdoruesit publikë dhe privatë	39
6.3.3	OS5.3 – Mbështetja e vendimmarrjes strategjike, planifikimit të qëndrueshëm dhe transparencës publike	39
6.4	Treguesit kryesorë	40
7	MASAT PRIORITARE TË QEVERISË PËR IMPLEMENTIM	40
7.1	POLITIKA 1 – FORCIMI I VLERËSIMIT DHE NXJERRJES SË BURIMEVE MINERARE	40

7.1.1	Masat Prioritare - OS1 – Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve Gjeologjike	40
7.1.2	Masat Prioritare - OS2 – Rivlerësimi i vendburimeve sipas standardit UNFC	41
7.1.3	Masat Prioritae - OS3 – Integrimi me planifikimin territorial dhe zonat e mbrojtura mjedisore	42
7.2	POLITIKA 2 – MODERNIZIMI, RICIKLIMI DHE DIVERSIFIKIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS	43
7.2.1	Masat Prioritare - OS1 – Rregullimi i kornizës ligjore për leje përpunimi dhe procesimi në gjithë zinxhirin e vlerës	43
7.2.2	Masat prioritare - OS2 – Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit përmes teknologjive të inovacionit	44
7.2.3	Masat prioritare - OS3 – Rritja e përpunimit lokal dhe vlerës së shtuar ne vend	45
7.2.4	Masat prioritare - OS4 – Zhvillimi i industrisë përpunuese dhe ricikluese të lidhur (mbetje/mining waste)	46
7.2.5	Masat prioritare - OS5 – Projekte strategjike CRM dhe integrimi evropian	47
7.3	POLITIKA 3 – SIGURIA, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	48
7.3.1	Masat prioritare - OS1 – Siguria teknike dhe shëndeti në punë	48
7.3.2	Masat prioritare - OS2 – Rehabilitimi dhe menaxhimi i zonave minerare	49
7.3.3	Masat prioritare - OS3 – Standardet mjedisore dhe certifikimi	50
7.3.4	Masat prioritare - OS4 – Përshpejtimi i tranzicionit drejt dekarbonizimit dhe përshtatjes klimatike	51
7.4	POLITIKA 4 – KAPITALI NJERËZOR DHE TEKNOLOGJIA	51
7.4.1	Masat prioritare - OS4.1 – Nxitja e interesit publik dhe të rinjve për arsimim ne gjeologji dhe miniera	51
7.4.2	Masat prioritare - OS4.2 – Përshtatja e programeve arsimore, kërkimore dhe profesionale me tregun modern të punës	52
7.4.3	Masat prioritare - OS4.3 – Krijimi i infrastrukturës moderne kërkimore dhe laboratorike	53
7.4.4	Masat prioritare - OS4.4 – Nxitja e rikthimit të specialistëve të diasporës dhe forcimi i arsimit profesional	53
7.4.5	Masat prioritare - OS4.5 – Rritja e kapaciteteve institucionale për monitorim, kontroll dhe menaxhim cilësor	54
7.5	POLITIKA 5 – INFORMACION I INTEGRUAR DHE TRANSPARENCË	54
7.5.1	Masat prioritare - OS5.1 – Krijimi i një databaze kombëtare të integruar dhe dixhitale për të gjitha të dhënat minerare dhe gjeologjike	54
7.5.2	Masat prioritare - OS5.2 – Sigurimi i aksesit të strukturuar dhe të diferencuar për përdoruesit publikë dhe privatë	55
7.5.3	Masat prioritare - OS5.3 – Mbështetja e vendimmarrjes strategjike, planifikimit të qëndrueshëm dhe transparencës publike	56
8	PJESA IV – IMPLEMENTIMI, PËRGJEGJËSIA DHE KOORDINIMI	56
8.1	Mekanizmat institucionalë për zbatim	56
8.2	Përgjegjësitë e institucioneve	57

8.3	Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit	57
8.4	Pjesëmarrja e aktorëve privatë, akademikë dhe shoqërisë civile	58
9	PJESA V Analiza Buxhetore	58
9.1	Vlerësimi i kostove indikative të strategjisë 2026–2040	58
9.2	Burimet e financimit	59
9.3	Hendeku financiar dhe krahasimi i dy opsioneve buxhetore	60
9.4	Arsye kryesore për zgjedhjen e Opsionit II	61
10	Aneks	63
10.1	Aneks 1 – Matrica e Masave Prioritare	63
10.2	Aneks 2 – Rezervat minerare, treguesit sasiorë dhe cilësorë	69

1 PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrje dhe qëllimi i dokumentit

Qëllimi i kësaj strategjie është të zhvillojë një sektor minerar konkurrues, efikas dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, duke krijuar një kornizë të qartë, të integruar dhe të koordinuar për menaxhimin, zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve minerare kombëtare. Strategjia synon të sigurojë që burimet natyrore të vendit të shfrytëzohen në mënyrë racionale, transparente dhe me përfitim afatgjatë për ekonominë, mjedisin dhe shoqërinë.

Dokumenti synon të transformojë sektorin minerar nga një industri e bazuar kryesisht në nxjerrjen dhe eksportin e lëndëve të papërpunuara, drejt një sektori të integruar industrial që prodhon vlerë të shtuar kombëtare, gjeneron punësim të qëndrueshëm, miqësor me mjedisin, të pranuar nga komunitetet e zonave minerare dhe shoqëria në përgjithësi në bazë të maksimizimit të përfitimit të tyre prej kësaj industrie dhe nxit zhvillimin ekonomik rajonal.

Në vijimësi të Strategjisë Minerare 2010–2025, strategjia e re ndërtohet mbi arritjet dhe mësimet e dekadës së kaluar, duke reflektuar gjithashtu nevojën për një qasje të re, të përshtatur me sfidat dhe mundësitë e epokës së tranzicionit të gjelbër dhe digjital, si dhe me zhvillimet e fundit ekonomike, mjedisore dhe gjeopolitike që po ndikojnë në mënyrën e menaxhimit të burimeve natyrore në nivel evropian dhe global.

Në këtë kuadër, ajo synon të pozicionojë Shqipërinë në hartën evropiane të burimeve natyrore, si një vend me potencial të rëndësishëm për lëndët e para kritike dhe strategjike (CRM/SRM) – si kromi, kobalti, nikeli, bakri, titani, boksiti, mangani, fosforiti dhe mineralet e rralla – të cilat janë thelbësore për industrinë e gjelbër, energjinë e pastër, teknologjitë digjitale dhe mbrojtjen kombëtare.

Strategjia forcon lidhjen midis politikave minerare dhe zhvillimit të qëndrueshëm, synon të integrojë dhe harmonizojë dimensionin ekonomik me atë social dhe mjedisor, me qëllimin e krijimit të një ekuilibri racional dhe të qëndrueshëm të zhvillimit industrial dhe ruajtjes së ekosistemeve natyrore, në përputhje me objektivat kombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e mjedisit, riciklimin dhe ekonominë qarkulluese.

Strategjia, si dokument themelor për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë minerare në vend, përfaqëson një sintezë të analizës SWOT të periudhës që nga miratimi i ligjit minerar deri më sot, ndërsa suksesi i saj do të varet nga menaxhimi efikas i burimeve minerale ekzistuese dhe atyre të reja, shfrytëzimi racional i rezervave dhe bashkërendimi efektiv i të gjithë faktorëve ndërveprues në këtë fushë.

1.1.1 Rëndësia e sektorit minerar

Sektori minerar ka qenë historikisht një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke kontribuar ndjeshëm në punësim, të ardhura fiskale, eksporte dhe Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) të vendit. Gjatë periudhës së tranzicionit si dhe pas reformimit të industrisë në tërësi kushtet e ekonomisë së tregut, sektori ka ruajtur një rol të qëndrueshëm ekonomik, duke kontribuar në mënyre direkte në PBB kombëtar, dhe njëherësh me një ndikim të konsiderueshëm, përmes industrisë përpunuese, transportit dhe shërbimeve mbështetëse.

Liberalizimi i tregut ju ka dhënë subjekteve private privilegjin e realizimit 100% të prodhimit minerar. Ata operojnë mbi bazën e të drejtave minerare konkurruese dhe të dhëna në përputhje me ligjin që rregullon në tërësi aktivitetin minerar, duke përfshirë detyrimin për leje mjedisore paraprake. Modeli i aplikuar garanton konkurrencë të hapur, përmirësim të standardeve të operimit dhe përgjegjësi mjedisore në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Shqipëria zotëron rezerva të konsiderueshme të kromit, bakrit, nikelit, titanit, boksitit dhe fosforitit, të cilat janë thelbësore për zinxhirin e furnizimit të vendit dhe të Bashkimit Evropian në energjinë e rinovueshme, elektromobilitet, elektronikë dhe mbrojtje. Në këtë kontekst duke vlerësuar kërkesën gjithnjë në rritje për mineralet, qasjen e re të BE dhe globalisht në vlerësimin e rolit të produkteve minerare dhe në transformimin e gjelbër dhe dixhital, konceptit jo thjesht si produkte por si në një forcë strategjike për produktet tona minerare fokusimi **TANI** në sektorin minerar mund të jap efekte pozitive në drejtim të rritjes ekonomike për vitet në vazhdim.

Aktiviteti minerar zhvillohet në disa grupe kryesore mineralesh:

Mineralet metalore: Kromi, bakri, hekur-nikeli, nikeli silikat, kobati, titanomagnetiti, boksitet (alumini), mangani, mineralet e grupit të platinut, ari, argjendi, plumbi, zinku, litiumi, uraniumi, mineralet e tokave të rralla, vanadiumi, etj.

Mineralet dhe shkëmbinj të industriale: Fosforitet, dolomit, magnezitet, fluoriti, kaolinat, squfuri, albitofiret, olivinitet, bariti, bentonitet, rërat kvarcore, xhami vullkanik, talku dhe gurët e talkut, pirofiliti, trepelet, grafiti, materialet ndërtimore (gëlqerorë, gurët dekorativë, argjilat, gipsi dhe anhidriti, ranorët), etj.

Lëndët e para energjetike: bitumet, pirobitumet, rërat bituminoze, qymyret, torfat.

Sektori minerar kontribuon drejtpërdrejt dhe tërthorë në ekonominë kombëtare. **Renta minerare**, e llogaritur si përqindje mbi vlerën e shitjes së prodhimit, është një nga burimet kryesore të të ardhurave publike, duke reflektuar ndikimin ekonomik të burimeve natyrore. Niveli i rentës minerare për mineralet metalore të përpunuara është rritur gradualisht sipas Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për Taksat kombëtare në RSH”, i ndryshuar, nga 6% deri në 9%, duke siguruar një menaxhim më të përgjegjshëm dhe shpërndarje më të drejtë të përfitimeve.

Eksportet minerare përbëjnë një burim të rëndësishëm të valutës së huaj, duke përfaqësuar, në disa vite, deri në 10–12% të eksporteve totale. Në kontekstin e tranzicionit të gjelbër dhe kërkesës së rritur për lëndë të para kritike, sektori minerar shqiptar, në përputhje me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. 2024/1252) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, ka marrë një dimension të ri strategjik dhe ka potencialin të bëhet partner i rëndësishëm dhe i besueshëm për industrinë evropiane.

Sektori minerar gjithashtu përfaqëson një burim të rëndësishëm të punësimit dhe zhvillimi lokal, të zhvillimit të jetes sociale, të infrastrukturës dhe popullimit të tyre, sidomos në zonat malore dhe rurale, ku mundësitë për aktivitete të tjera ekonomike janë më të kufizuara.

1.1.2 Përputhshmëria me dokumentet strategjike

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Sektorit Minerar mbështetet në kornizën kombëtare të politikave të zhvillimit dhe dokumenteve strategjike që orientojnë integrimin ekonomik, institucional dhe ligjor të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Procesi i përafrimit me *acquis communautaire* është tashmë në zhvillim dhe përfshin harmonizimin me direktivat kryesore të BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve minerare, transparencën dhe ekonominë qarkulluese.

Strategjia Kombëtare Minerare është ndërtuar në përputhje me tre dokumente themelorë kombëtarë dhe evropianë, duke garantuar që prioritetet kombëtare të jenë në linjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe standardet e Bashkimit Evropian:

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE 2030)**, miratuar me VKM nr. 88, datë 22.03.2023, që përcakton vizionin afatgjatë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, forcim të kapitalit njerëzor dhe modernizim institucional.
- **Rregullorja (BE) 2024/1252**, miratuar më 11 prill 2024, “Për Lëndët e Para Kritike (Critical Raw Materials Act – CRMA)”, që vendos objektiva për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe konkurrues të lëndëve të para kritike brenda BE-së.
- **Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligent (S3) 2025–2030**, miratuar me VKM nr. 824, datë 26.12.2024, që orienton ekonominë drejt njohurisë dhe teknologjisë, duke nxitur inovacionin, digjitalizimin dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së industrive nxjerrëse.

Prioritetet kryesore për sektorin minerar sipas SKZHIE 2030 dhe S3 janë:

- **Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve minerare:** Përdorimi efikas i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik dhe reduktimit të varësisë nga importet.
- **Rritja e përpunimit dhe vlerës së shtuar:** Përpunimi dhe rafinimi i mineraleve në territorin shqiptar për rritjen e të ardhurave, uljen e ndotjes dhe zhvillimin e aktiviteteve me vlerë të shtuar.
- **Përmirësimi i efikasitetit dhe teknologjisë:** Përdorimi i teknologjive moderne, sistemeve digjitale dhe sensorëve gjeologjikë për monitorim në kohë reale dhe reduktim të mbetjeve.
- **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe kërkimore:** Forcimi i infrastrukturës kërkimore dhe laboratorike, bashkëpunimi ndërmjet universiteteve, institucioneve shkencore dhe industrisë minerare, dhe përgatitja e profesionistëve në gjeoshkencë, inxhinieri minerare dhe menaxhimin e mjedisit.
- **Integrimi në zinxhirin e furnizimit të BE-së:** Përshtatja e kuadrit strategjik dhe ligjor të Shqipërisë me standardet e Rregullores (BE) 2024/1252 dhe pozicionimi si furnizues i besueshëm i lëndëve të para kritike si kromi, nikeli, bakri, boksiti, titani, fosforiti, magneziti dhe mangani.
- **Promovimi i inovacionit dhe digjitalizimit:** Zhvillimi i teknologjive të avancuara dhe të qëndrueshme, përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe forcimi i qëndrueshmërisë së industrive nxjerrëse sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.

Në këtë mënyrë, Strategjia Kombëtare Minerare harmonizon zhvillimin e sektorit me vizionin e zhvillimit të qëndrueshëm, inovativ dhe teknologjik të Shqipërisë, duke e pozicionuar industrinë nxjerrëse si një shtyllë të rëndësishme të rritjes ekonomike, integritetit në tregun e BE-së dhe zhvillimit të një zinxhiri kombëtar të vlerës me qëndrueshmëri dhe efikasitet maksimal.

1.2 Kuadri Ligjor dhe Institucional

1.2.1 Korniza ligjore

Legjislacioni shqiptar për sektorin minerar bazohet në Ligjin Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse. Në vitet e fundit janë ndërmarrë hapa për të forcuar transparencën, sistemin e licencimit dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar, është përafëruar me Direktivën 2006/21/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 15 mars 2006, “Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse”, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 102, datë 11.04.2006, fq. 15–34.

Aktet e tjera ligjore për sektorin minerar përfshijnë:

- Ligji nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”;
- Ligji nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike”;
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- VKM nr. 347, datë 29.04.2011 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”;
- VKM nr. 726, datë 02.09.2015 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar 2016–2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme”;
- VKM nr. 664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për vitet 2019–2021, në zbatim të strategjisë minerare”;
- VKM nr. 380, datë 01.06.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për vitet 2022–2024, në zbatim të strategjisë minerare”;
- VKM nr. 233, datë 23.03.2011 “Për miratimin e formës së raporteve, të mënyrës së publikimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin minerar si dhe të nivelit të konfidencialitetit në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse”;
- VKM nr. 364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare, vlerës minimale të investimit dhe të prodhimit për një leje minerare”;
- VKM nr. 820, datë 21.10.2020 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, të kushteve, të kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata në veprimtarinë studimore projektuese në fushën minerare”;

- VKM nr. 442, datë 06.06.2011 “Për miratimin e kushteve, të dokumenteve vërtetuese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave për autorizimin e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara”;
- VKM nr. 741, datë 09.09.2015 “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”, i ndryshuar;
- VKM nr. 969, datë 02.12.2015 “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit të punëmarrësve në industritë minerare nxjerrëse, sipërfaqësore dhe nëntokësore’”;
- VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”;
- VKM nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

1.2.2 Harmonizimi me acquis të BE-së

Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar, me acquis-in e Bashkimit Evropian në fushën minerare, përbën një nga shtyllat themelore të integritimit Evropian të vendit, si dhe të përgatitjes së tij për pjesëmarrje në tregun e përbashkët të lëndëve të para. Qëllimi kryesor i këtij procesi është krijimi i një kuadri ligjor, institucional dhe teknik të përputhshëm me standardet e BE-së, që garanton zhvillim të qëndrueshëm, konkurrueshmëri industriale dhe mbrojtje të mjedisit në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe tranzicionit të gjelbër.

Në këtë proces, harmonizimi mbështetet në disa kapituj kyç të acquis-it, të cilët mbulojnë fusha ndërsektoriale që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin dhe modernizimin e sektorit minerar.

Ky proces përfshin disa kapituj të rëndësishëm të politikave dhe legjislacionit për sektorin minerar:

- **Kapitulli 3 – E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime:** lidhet me mundësinë që kompanitë minerare të vendosen dhe të ofrojnë shërbime brenda tregut të përbashkët Evropian në kushte konkurruese dhe pa barriera të panevojshme.
- **Kapitulli 19 – Politika Sociale dhe Punësimi:** ka të bëjë me sigurimin e kushteve të sigurt dhe të drejta pune për punëtorët në industrinë minerare, përfshirë shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- **Kapitulli 20 – Ndërmarrjet dhe Politika Industriale:** lidhet me mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues të ndërmarrjeve minerare, duke nxitur inovacionin dhe modernizimin teknologjik të sektorit.
- **Kapitulli 25 – Shkenca dhe Kërkimi:** kontribuon në përmirësimin e praktikave minerare përmes kërkimit shkencor, zhvillimit të teknologjive të pastra dhe rritjes së efikasitetit në përdorimin e burimeve natyrore.
- **Kapitulli 27 – Mjedi dhe Ndryshimet Klimatike:** ka rol kyç në mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e veprimtarive minerare, në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe në reduktimin e ndotjes dhe emetimeve.

Kjo qasje siguron që zhvillimi i sektorit minerar të jetë i harmonizuar me standardet kombëtare dhe evropiane, duke përfshirë aspektet ligjore, sociale, industriale, energjetike dhe mjedisore.

Në këtë kuadër, Shqipëria po përafron kuadrin ligjor kombëtar me direktivat dhe rregulloret kryesore të BE-së që mbulojnë sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve minerare, transparencën e industrisë nxjerrëse dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese. Ky proces siguron që zhvillimi i sektorit minerar të bazohet në standarde të përbashkëta evropiane të qëndrueshmërisë, efikasitetit dhe përgjegjësisë mjedisore.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përafrimin e me direktivat e BE-së, që mbulojnë sigurinë, mjedisin, mbetjet dhe transparencën. Deri më tani, legjislacioni kombëtar ka përafruar:

- Direktivën 92/91/KEE dhe 92/104/KEE për sigurinë dhe shëndetin në punë në industrinë nxjerrëse;
- Direktivën 2006/21/KE për menaxhimin e mbetjeve minerare;
- Direktivën 2004/35/KE për përgjegjësinë mjedisore;
- Direktivën 2011/92/BE (me ndryshimin 2014/52/BE) për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- Direktivën 2013/34/BE për raportimin financiar dhe transparencën në industrinë nxjerrëse;
- Direktivën 2012/18/BE (Seveso III) për menaxhimin e rreziqeve industriale;
- Direktivën 2008/98/BE për mbetjet dhe ekonominë qarkulluese.

Një element thelbësor në këtë përafrim është Rregullorja (BE) 2024/1252 “Për Lëndët e Para Kritike”, e cila vendos kuadrin për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe konkurrues me lëndë të para strategjike brenda Bashkimit Evropian. Ky akt i ri shërben si pikë referimi për Shqipërinë në procesin e harmonizimit, duke e pozicionuar vendin si një partner të besueshëm dhe të rëndësishëm në zinxhirin Evropian të furnizimit me minerale kritike.

Rregullorja vendos objektiva të qarta për vitin 2030; të paktën 10% e konsumit të BE-së të mbulohet nga burime të brendshme; të paktën 40% e përpunimit të kryhet brenda BE-së; dhe 25% e nevojave të plotësohen përmes riciklimit.

Shqipëria ka potencial të bëhet një partner i besueshëm dhe furnizues rajonal për minerale kritike si kromi, nikeli, bakri, boksiti, titani, fosforiti, magneziti dhe mangani. Për ta arritur këtë, kërkohet modernizimi i politikave minerare, përmirësimi i sistemit të lejeve dhe vlerësimeve mjedisore, dhe zhvillimi i një zinxhiri kombëtar të vlerës që përfshin kërkimin, përpunimin dhe riciklimin në mënyrë të qëndrueshme.

Zbatimi i kësaj rregulloreje do të forcojë pozicionin gjeostrategjik të Shqipërisë në tregun Evropian të lëndëve të para, duke e integruar atë në mënyrë të plotë në ekonominë e gjelbër dhe digjitale të Bashkimit Evropian.

1.3 Institucionet kryesore

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Sektorit Minerar mbështetet në një sistem të integruar institucional, që përfshin organet qendrore të politikbërjes, agjencitë teknike, strukturat e sigurisë dhe institucionet e inovacionit e transparencës. Ky bashkërendim siguron që menaxhimi i burimeve natyrore të bazohet në parimet e qëndrueshmërisë, transparencës, inovacionit dhe sigurisë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

MIE është institucioni politik përgjegjës për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën e burimeve minerare. Ajo udhëheq hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare Minerare, përgatit dhe miraton aktet ligjore dhe nënligjore, zhvillon programet e investimeve dhe mbikëqyr forcimin e instrumentave ligjorë dhe institucionalë për zbulimin, shfrytëzimin, përpunimin dhe rehabilitimin e zonave minerare. MIE koordinon gjithashtu përafrimin e politikave minerare me acquis të BE-së, duke siguruar përputhshmërinë me:

- Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritit Evropian 2030;
- Rregulloren (BE) 2024/1252 për Lëndët e Para Kritike;
- Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

AKBN, një agjenci teknike në varësi të MIE, është përgjegjëse për administrimin, vlerësimin dhe monitorimin e burimeve natyrore, përfshirë minerale, hidrokarbure dhe burime të tjera nëntokësore. Ajo ka kompetenca për:

- Përcaktimin e zonave minerare në përputhje me strategjinë minerare dhe planet trevjeçare/vjetore;
- Shqyrtimin dhe miratimin e kushteve teknike dhe financiare për marrjen e lejeve minerare;
- Mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të rezervave minerare;
- Monitorimin e procesit të licencimit dhe të aktiviteteve minerare (kerkim - zbulim, shfrytëzim);
- Mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave minerare;
- Sigurimin dhe zbatimin e kushteve ligjore, teknike dhe të rehabilitimit mjedisor;
- Monitorimin post minierar të minierar të mbyllura dhe zonave minerare të ndikuara nga aktiviteti minierar.

AKB siguron cilësinë, integritetin dhe sigurinë e informacionit minierar kombëtar dhe mbetet shtylla teknike e rëndësishme e aktivitetit minierar të shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve klasike dhe atyre kritike (CMR).

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

SHGJSH është Institucion këshillimor, teknik dhe shkencor kombëtar për kërkimin, vlerësimin dhe studimin e burimeve minerale. Detyrat kryesore përfshijnë:

- Kryerjen e studimeve përgjithësuese dhe të detajuara mbi gjendjen dhe perspektivën e pasurive minerale;
- Vlerësimin e rivlerësimin e burimeve minerale dhe rezervave minerale sipas standardeve ndërkombëtare (UNFC.JORC, etj);
- Përcaktimin e zonave minerare të kërkim-zbulimit në përputhje me strategjinë minerare dhe planet trevjeçare/vjetore;
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit;
- Bashkëpunimin me agjenci kërkimore dhe universitete për përdorimin e teknologjive të reja (AI, sensorë gjeologjikë, GIS).

SHGJSH siguron cilësinë, integritetin dhe sigurinë e informacionit gjeologjik kombëtar dhe mbetet shtylla tekniko-shkencore e sektorit.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)

AKSEM është përgjegjëse për kontrollin teknik, sigurinë industriale dhe menaxhimin e rreziqeve në aktivitetet minerare. Detyrat e saj përfshijnë:

- Inspektimin e kushteve të sigurisë në miniera dhe impiante përpunimi;
- Monitorimin e masave të mbrojtjes në punë dhe trajnimet e specializuara;
- Hetimin e aksidenteve minerare dhe raportimin e shkaqeve;
- Koordinimin me strukturat e emergjencave civile, në përputhje me Direktivat 92/91/KEE dhe 92/104/KEE.

AKSEM ka për detyrë të garantojë standardet më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes së jetës njerëzore, duke reduktuar incidencën e aksidenteve në sektor.

Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para

Qendra Rajonale e Inovacionit në Elbasan koordinon zhvillimin e inovacionit, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me rrjetin Evropian të industrisë së lëndëve të para. Roli i saj përfshin:

- Zhvillimin e teknologjive të reja për kërkim, përpunim dhe riciklim të mineraleve;
- Trajnimin e ekspertëve dhe ndërtimin e kapaciteteve teknike;
- Integrimin e inovacionit digjital dhe inteligjencës artificiale në procese industriale.

RIC Albania kontribuon në integrimin e Shqipërisë në ekosistemin Evropian të inovacionit për lëndët e para kritike (CRM), duke zbatuar objektivat e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3).

Iniciativa për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Albania)

EITI Albania është mekanizëm ndërkombëtar i transparencës dhe përgjegjshmërisë publike, ku Shqipëria është anëtare që nga viti 2009. Në kuadër të Strategjisë Kombëtare Minerare, EITI luan rol thelbësor në:

- Monitorimin e flukseve financiare dhe fiskale ndërmjet qeverisë dhe kompanive minerare;
- Publikimin e të dhënave të hapura mbi taksat, rentën minerare dhe koncesionet;
- Forcimin e besimit publik dhe klimës së investimeve përmes transparencës;
- Sigurimin e përputhjes me standardet ndërkombëtare të raportimit (EITI Standard 2023).

Përmes EITI Albania, Shqipëria demonstroi angazhim të plotë ndaj qeverisjes së mirë dhe përafrimit me Direktivën 2013/34/BE për transparencën financiare në industrinë nxjerrëse.

1.4 Arritjet dhe sfidat

1.4.1 Arritjet kryesore të sektorit minerar deri në vitin 2025

Gjatë dekadës së fundit, sektori minerar shqiptar ka shënuar zhvillime të rëndësishme institucionale, ligjore dhe teknologjike, duke vendosur bazat për një industri më të hapur, konkurruese dhe të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian. Arritjet kryesore përfshijnë:

- ***Përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së***

Ligji nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përafruar në mënyrë të drejtpërdrejtë Direktivën 2006/21/KE për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse—kjo është direktiva kryesore e transpozuar brenda normave specifike të ligjit bazë të sektorit minerar. Ndërkohë, direktivat e tjera të rëndësishme të BE-së, si Direktiva 92/91/EEC (siguria dhe shëndeti në punë), Direktiva 2011/92/EU (vlerësimi i ndikimit në mjedis/EIA) dhe Direktiva 2013/34/EU (transparenca financiare dhe raportimi i pagesave të ndërmarrjeve nxjerrëse) janë përafruar dhe zbatohen përmes akteve të tjera horizontale sektoriale (Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Kontabilitetin etj.), të cilat janë gjithashtu të aplikueshme dhe detyruese për çdo aktivitet minerar në Shqipëri. Kjo qasje ka bërë të mundur që kuadri ligjor shqiptar të jetë funksionalisht në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së, me dispozitat mbi: i) standardet e sigurisë në miniera; ii) menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve minerare; iii) transparencën financiare të industrisë nxjerrëse; iv) monitorimin mjedisor dhe publikimin e të dhënave për efektet sociale e fiskale në kuadër të anëtarësimit në EITI (që nga 2009). Nëpërmjet këtij procesi, Shqipëria ka hedhur bazat për harmonizim të plotë me kuadrin rregullator të BE-së, në përputhje me Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (Regullorja (EU) 2024/1252) dhe me objektivat e Strategjisë Minerare 2026–2040 për zhvillim të qëndrueshëm, konkurrues dhe mjedisor të sektorit minerar.

- ***Rritja e investimeve private***

Në dhjetëvjeçarin e fundit, përmirësimi i kuadrit ligjor, rritja e transparencës së procedurave konkurruese dhe kërkesa globale për lëndë të para kritike kanë sjellë një intensifikim të investimeve private në sektorin minerar shqiptar. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për vitin 2025, në Shqipëri janë aktive 579 licenca minerare, që mbulojnë kërkimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e mineraleve metalore, jometalore dhe materialeve të ndërtimit.

Pjesa më e madhe e këtyre licencave është e fokusuar në nxjerrjen dhe pasurimin e kromit, bakrit, hekur-nikelit, si dhe të materialeve ndërtimore (rërë, zhavorr, gur gëlqeror, travertina, gur dekorativ dhe çimento), që reflekton interes të qëndrueshëm të investitorëve vendas dhe të huaj në të gjithë spektrin e industrisë minerare.

Sipas INSTAT, gjatë vitit 2024 investimet në makineri, pajisje dhe infrastrukturë teknologjike për sektorin minerar janë rritur me 2.8% krahasuar me vitin e kaluar, duke kapërcyer vlerën 5.3 miliardë lekë për kapital fiks të dedikuar për zhvillimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese.

Kjo tendencë reflektohet në zgjerimin e kapaciteteve të pasurimit të kromit, ku në vitin 2024 u prodhuan rreth 953,340 ton mineral kromi, në rritjen e aktivitetit në industrinë e materialeve të ndërtimit me një prodhim prej 5,370,377 m³, e cila po kontribuon në mënyrë të qëndrueshme në prodhimin kombëtar dhe eksportet shqiptare.

Prodhimi ,në tërësi, për vitin 2024 i mineraleve metalore ka qenë 1,828,464 ton dhe krahasuar me prodhimin e vitit 2023 (1,433,428 ton) kemi një ***rritje prej rreth 21.6 %***. Prodhimi i mineralit të Kromit për këtë vit ka një rritje prej rreth 4.58 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Një rritje domethënëse ka prodhimi i mineralit të Bakrit (Cu), i cili krahasuar me vitin 2023 (460,628 ton – 2023) ka një rritje prej rreth 180% në vitin 2024 (829,644 ton – 2024). Rritja është rezultat i çmimit të bakrit në bursë, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në të ardhurat nga eksporti.

Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2023, eksportet e grupit “*Materiale ndërtimi dhe metale*” arritën në mbi 71 milionë euro, duke përfaqësuar një nga zërat kryesorë të rritjes së eksporteve shqiptare. Megjithëse në vitin 2025 është regjistruar një ulje sezonale prej –1.2%, prodhimi dhe konsumi i brendshëm i materialeve ndërtimore, i mbështetur nga investimet publike, ndërtimi dhe turizmi mbetet i lartë, duke zënë rreth 14% të përdorimeve të brendshme të prodhimit kombëtar. Rritja e investimeve private, në bashkëpunim me partnerët strategjikë të qeverisë dhe institucionet financiare ndërkombëtare, po krijon bazat për një industri minerare të integruar dhe të qëndrueshme, që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e eksporteve, punësimit dhe zhvillimit infrastrukturor të vendit.

- ***Rritja e kontributit ekonomik dhe eksporteve***

Sektori minerar ka mbetur një shtyllë e rëndësishme për ekonominë shqiptare, duke ndikuar ndjeshëm si në prodhimin e brendshëm bruto, ashtu edhe në eksportet e vendit. Sipas të dhënave të INSTAT, në periudhën 2022–2024 aktivitetet nxjerrëse dhe përpunuese kanë kontribuar mesatarisht 1.4–1.6% të PBB-së të Shqipërisë, edhe pse ky tregues ka një luhatje të lehtë vjetore për shkak të çmimeve globale dhe strukturës së prodhimit industrial. Kontributi në eksportet kombëtare ka qenë po ashtu domethënës: sipas raportimeve të rregullta mujore të INSTAT, eksportet e mallrave të grupit “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” kanë përbërë 9.7–14.5% të totalit të eksporteve nga viti 2022 deri në mesin e vitit 2025, me një rritje reale të shënuar gjatë muajve të rritjes së çmimeve dhe kërkesës për krom, materiale ndërtimi dhe naftë bruto. Kapacitetet prodhuese të sektorit, të shtrira në rreth 579 licenca aktive minerare sipas AKBN, përfaqësojnë një prani të konsoliduar në zhvillimin ekonomik rajonal, punësimin lokal dhe prodhimin e vlerave të shtuara materiale. Sektori minerar është marrë në konsideratë nga institucionet makroekonomike si një prej burimeve kryesore të balancës tregtare, sidomos në eksportet drejt BE-së, Kinës, Turqisë dhe Italisë. Pavarësisht ciklit të luhatjeve sezonale dhe ndikimit të faktorëve ndërkombëtarë, mineralet dhe materialet e ndërtimit (krom, bakër, hekur-nikel, gurë dekorativë, çimento etj.) vazhdojnë të zënë një peshë të lartë në strukturën e eksporteve shqiptare, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e qëndrueshmërisë makroekonomike dhe modernizimin e industrisë vendase.

- ***Rritja e transparencës institucionale***

Shqipëria ka qenë zyrtarisht anëtare e EITI (Extractive Industries Transparency Initiative) që nga viti 2009, duke u renditur ndër vendet e para të rajonit me përputhshmëri të plotë ndaj standardeve ndërkombëtare të raportimit për industritë nxjerrëse. Anëtarësimi i vendit në EITI është shoqëruar me ngritjen e Sekretariatit Shqiptar të EITI dhe publikimin çdo vit të raporteve të detajuara mbi

pagesat, kontributet fiskale, të ardhurat nga kompani minerare dhe hidrokarbure, pronarët përfitues dhe marrëveshjet e industrisë. Kjo qasje ka sjellë përmirësim të ndjeshëm të standardeve të raportimit financiar, social dhe ambiental të kompanive që operojnë në sektorin minerar dhe e ka kthyer raportimin publik dhe aksesin mbi të dhënat një praktikë të qëndrueshme për aktorët ekonomikë, investitorët, shoqërinë civile dhe median. Përtej kësaj, digjitalizimi progresiv i të dhënave minerare dhe gjeologjike nga SHGJSH, AKBN dhe Ministria e Infrastrukturës ka avancuar në vitet e fundit duke çuar ne:

- krijimin e portaleve publike për licencat, prodhimin vjetor, eksportet dhe raportimet mujore;
- ngritjen e një sistemi kombëtar të të dhënave minerare dhe gjeologjike që rrit ndjeshëm aksesin në informacion për përdoruesit publikë dhe privatë.

Një element kyç në këtë drejtim është procesi i harmonizimit të të dhënave kombëtare, që po zbatohet në kuadër të hartimit të “Roadmap”-it mbi potencialin e Lëndëve të Para Kritike (CRM), i udhëhequr nga Qendra Rajonale e Inovacionit e EIT RawMaterials në Elbasan. Qendra ka dizenuar një portal online institucional që synon lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve publike dhe partnerëve akademikë, duke harmonizuar bazat ekzistuese të të dhënave të institucioneve kryesore të industrisë minerare të vendit (SHGJSH–AKBN).

- ***Partneritete ndërkombëtare dhe mbështetje e shtuar ndërqeveritare***

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka marrë një dimension të ri strategjik për sektorin minerar shqiptar.

Partneriteti me EIT RawMaterials është konkretizuar me krijimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të EIT RawMaterials në Elbasan, e cila funksionon si një nyje kombëtare e ekselencës për kërkimin, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë minerare dhe të lëndëve të para kritike (CRM). Qeveria shqiptare, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Brukselin, ka rritur ndjeshëm vëmendjen dhe mbështetjen ndaj sektorit të burimeve natyrore, duke hapur një dritare të veçantë financimi për projektet minerare dhe të CRM-ve në kuadër të IPA III 2025–2027. Ky proces pritet të vazhdojë në vitet në vijim, duke kontribuar në fuqizimin institucional, teknologjik dhe kërkimor të sektorit. Paralelisht, partnerë të fuqishëm ndërkombëtarë si Banka Botërore, BERZH dhe institucione të tjera financiare shumëpalëshe mbeten të pranishëm në sektor, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e infrastrukturës, përmirësimin e standardeve të sigurisë, investimet në energji të pastër dhe modernizimin e industrisë nxjerrëse. Këto partneritete kanë krijuar një mjedis bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, institucioneve kërkimore dhe industrisë, që po orienton Shqipërinë drejt një modeli të ri të zhvillimit minerar të integruar, inovativ dhe në përputhje me objektivat e tranzicionit të gjelbër dhe digjital të Bashkimit Evropian.

- ***Hartimi i “Roadmap”-it Kombëtar për Lëndët e Para Kritike (CRM).***

Procesi i hartimit të “Roadmap”-it Kombëtar për Lëndët e Para Kritike, i udhëhequr nga Qendra Rajonale e Inovacionit të EIT RawMaterials në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), përbën një nga nismat më të rëndësishme strategjike të dekadës. Dokumenti synon identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e burimeve kombëtare të CRM-ve, përfshirë metalet bazë, ferrometalet dhe mineralet e rralla që kanë rëndësi të veçantë për teknologjitë e tranzicionit të gjelbër, energjinë e rinovueshme, mbrojtjen dhe industrinë digjitale. “Roadmap”-i shërben si

instrument planifikimi afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të zinxhirit kombëtar të vlerës, nga eksplorimi dhe nxjerrja, deri te përpunimi, riciklimi dhe integrimi industrial, duke garantuar përafrimin me objektivat e Aktit Evropian për Lëndët e Para Kritike (Regullorja (BE) 2024/1252).

- ***Rritja e prodhimit të kromit***

Sipas të dhënave të Anketës së Produkteve Industriale të INSTAT (2025), prodhimi vjetor i xeherorëve dhe koncentrateve të kromit në Shqipëri është vlerësuar mesatarisht në intervalin 588,000–953,340 ton për vitet e fundit, me kulmin në vitin 2019 kur arriti gati 1.3 milion ton mineral të nxjerrë, ndërsa që nga viti 2022 prodhimi ka mbetur relativisht stabil, duke luhatur mes 920,000 dhe 953,340 tonë në vit. Në raport me eksportet, AKBN raporton se për vitin 2022 janë eksportuar rreth 930,000 tonë krom, që përbën 66.5% të totalit të prodhuar në minierat metalore. Vlera e shitjeve të xeherorit dhe koncentrateve të kromit për vitin 2024 llogaritet mbi 14.9 miliardë lekë, ndërsa eksportet e kromit përbëjnë një nga zërat kryesorë të bilancit të industrisë minerare dhe të të ardhurave nga eksporti. Këto rezultate e rendisin Shqipërinë vazhdimisht në vendin e 7-të në botë për prodhimin total të kromit dhe në vend të 4-t për eksportin e këtij minerali strategjik, sipas vlerësimeve rajonale dhe statistikave të organizatave ndërkombëtare dhe burimeve të industrisë. Përkundër një rënieje modeste të prodhimit në vitin 2024 (–1.3% krahasuar me vitin e kaluar), industria e kromit mbetet sektori minerar lider i vendit në aspektin e volumit, eksporteve dhe ndikimit ekonomik, duke mbështetur mbi 4000 vende të drejtpërdrejta pune dhe duke siguruar të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit përmes rentës minerare.

- ***Arritjet në përpunimin e mineraleve***

Investimet private në sektorin minerar kanë çuar në një zgjerim të dukshëm të kapaciteteve përpunuese në vend, sidomos për kromin dhe bakrin. Sipas regjistrit të AKBN dhe listës së lejeve minerare, në Shqipëri janë aktive rreth 16 fabrika për pasurimin e kromit dhe një numër tjetër fabrikash për përpunimin e bakrit, përfshirë impiantet në Bulqizë, Kukës, Tropojë, Prrenjas dhe Rubik. Të gjitha këto njësi shërbejnë si shtylla të industrisë përpunuese minerare, duke tejkaluar mbi 1.1 milion ton prodhim të kromit të pasuruar në vitet më të fundit dhe duke kontribuar direkt në eksportin e lëndëve të para për tregjet evropiane dhe botërore. Këto investime kanë ndikuar në rritjen e vlerës së shtuar brenda vendit, punësimin e qëndrueshëm në zonat minerare, si dhe përmirësimin e bilancit të pagesave për ekonominë shqiptare. Sipas AKBN, aktiviteti i fabrikave të pasurimit mbështet rreth 3500 – 4000 punonjës dhe gjeneron mbi 14.9 miliardë lekë të ardhura nga eksportet çdo vit.

- ***Nismat për riciklimin e dambave dhe mbetjeve minerare***

Në kuadër të tranzicionit drejt ekonomisë qarkulluese, janë ndërmarrë projekte pilot për përpunimin dhe rikuperimin e mbetjeve minerare që dalin nga proceset teknologjike dhe nga sterilet e grumbulluara ndër vite. Këto nisma kanë për qëllim rritjen e nivelit të rikuperimit të elementeve me vlerë, shfrytëzimin e plotë të lëndëve të para sekondare (CRM), si dhe reduktimin e volumit të mbetjeve dhe depozitimeve minerare. Një zhvillim i rëndësishëm është riciklimi i dambave të bakrit, i cili tashmë nuk kufizohet vetëm në përfitimin e metaleve, por edhe në përdorime të tjera industriale dhe mjedisore, duke rritur efikasitetin teknologjik, qëndrueshmërinë ekonomike dhe rehabilitimin e mjedisit të ndotura historike. Këto nisma përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt shfrytëzimit të plotë të potencialit minerar kombëtar, duke kombinuar përfitimin ekonomik me mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me parimet e Aktit Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act) dhe objektivat e Green Agenda for the Western Balkans.

1.4.2 Sfidat kryesore të sektorit minerar

Megjithë përparimet e dukshme gjatë periudhës 2010–2025, sektori minerar shqiptar përballet me një sërë sfidash strategjike që ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e tij për t'u zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare. Këto sfida lidhen ngushtë me shtatë objektivat themelorë të Strategjisë Kombëtare Minerare 2026–2040 dhe kërkojnë një reformë të thelluar ligjore, teknologjike, mjedisore dhe institucionale.

- ***Mungesa e kërkime-zbulimeve të reja dhe vlerësimit gjithëpërfshirës të burimeve natyrore.***

Në fazën aktuale të zhvillimit, sektori minerar shqiptar përballet me sfida të mëdha që lidhen me kërkimin, zbulimin, vlerësimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore në përputhje me standardet bashkëkohore të Bashkimit Evropian. Një nga nevojat më të ngutshme është rinisja dhe zgjerimi i aktivitetit të kërkim–zbulimit për mineralet kryesore të vendit, si kromi, bakri dhe hekur–nikeli, si dhe për lëndët e para kritike (Critical Raw Materials – CRM), të cilat deri më sot kanë qenë pjesërisht të paeksploruara.

Gjatë viteve të fundit është vërejtur një rënie e ndjeshme e numrit të lejeve të kërkim–zbulimit, e cila ka sjellë ngadalësim të investimeve në eksplorim dhe pamundësi për të identifikuar vendburime të reja me potencial ekonomik e strategjik. Kjo situatë po kufizon zgjerimin e bazës së rezervave kombëtare kombëtare të mineraleve, si dhe aftësinë e Shqipërisë për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe të pavarur me lëndë të para minerare dhe kritike, duke e bërë të domosdoshme hartimin e një Plani Kombëtar të Kërkimeve Minerare dhe ngritjen e një kuadri të integruar institucional dhe financiar për kërkim–zbulimet e reja.

Një nga boshllëqet më thelbësore mbetet mungesa e një sistemi të unifikuar kombëtar të të dhënave minerare dhe gjeologjike, që të mundësojë qasje të koordinuar dhe transparente në informacionin teknik, teknologjik, ekonomik dhe mjedisor. Administrimi veçmas i të dhënave minerare dhe gjeologjike, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e bën të vështirë integrimin dhe analizën gjithëpërfshirëse të informacionit mbi potencialin mineral të vendit. Kjo situatë pengon hartimin e politikave të bazuara në evidencë dhe orientimin strategjik të investimeve në kërkim dhe shfrytëzim. Për këtë arsye, krijimi i një DataHub Kombëtar për Burimet Minerare dhe Gjeologjike, mbetet një domosdoshmëri për rritjen e transparencës, qeverisjes së mirë dhe planifikimit të qëndrueshëm të burimeve.

Një tjetër sfidë madhore është mungesa e standardizimit ndërkombëtar në raportimin e rezervave minerare. Përdorimi i pjesshëm i metodologjive si UNFC, JORC dhe PERC e bën të pamundur krahasueshmërinë e të dhënave shqiptare me ato të vendeve të BE-së, duke kufizuar besueshmërinë për investitorët dhe institucionet ndërkombëtare. Aplikimi i një Sistemi Kombëtar të Klasifikimit të Burimeve /Rezervave Minerare, i harmonizuar me standardet e BE-së, do të mundësonte raportim të unifikuar, rritje të transparencës dhe integrim më të plotë në rrjetet evropiane të menaxhimit të burimeve natyrore.

Në aspektin ligjor, përafrimi i kuadrit shqiptar me acquis të BE-së mbetet i pjesshëm. Megjithatë Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

ka integruar kërkesat kryesore të Direktivës 2006/21/KE për menaxhimin e mbetjeve të industrive nxjerrëse, zbatimi i plotë i standardeve mjedisore dhe të sigurisë kërkon një rishikim të thelluar ligjor dhe institucional. Në periudhën 2026–2040, sfida kryesore do të jetë përafrimi i plotë me Direktivën 2006/21/KE dhe me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act – Reg. (EU) 2024/1252), që synon garantimin e furnizimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe të gjelbër me materiale strategjike për ekonominë evropiane. Ky proces do të kërkojë riformatim të legjislacionit shqiptar, forcim të kapaciteteve institucionale dhe përafrim të mekanizmave të monitorimit, kontrollit dhe raportimit me praktikatat më të mira evropiane, duke e pozicionuar Shqipërinë si një partner të besueshëm dhe konkurrues në tregun Evropian të lëndëve të para kritike.

- ***Kapacitete të ulëta për përpunim dhe mungesë e sistemit të riciklimit të burimeve minerare.***

Një nga sfidat më të rëndësishme, me të cilat përballet sektori mineral shqiptar në periudhën 2026–2040, është zhvillimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit të burimeve minerare në mënyrë që vlera e shtuar të krijohet brenda vendit dhe të mos humbasë përmes eksportit të lëndëve të papërpunuara. Aktualisht, vetëm 20–35% e mineralit të kromit përpunohet në produkte përfundimtare (ferro krom), 100% e mineralit të bakrit deri në nivel koncentrat, përpunohet në territorin shqiptar, ndërsa pjesa tjetër eksportohet në formë të papërpunuar drejt tregjeve të huaja, kryesisht përmes kontratave me kompani ndërkombëtare që kryejnë pasurimin dhe rafinimin jashtë vendit. Ky model, megjithëse ka gjeneruar të ardhura afatshkurtra, nuk garanton zhvillim industrial dhe punësim të qëndrueshëm, apo rritje të qëndrueshme të PBB-së kombëtare. Edhe më problematike mbetet niveli shumë i ulët i riciklimit të mbetjeve metalike dhe mineraleve sekondare, që aktualisht nuk i kalon 5%, shumë poshtë mesatares së Bashkimit Evropian prej 25–30%. Kjo nënkupton se një sasi e konsiderueshme materiale me përmbajtje metalike dhe elemente kritike përfundon si mbetje e pashfrytëzuar, duke humbur potencialin e tyre të lartë ekonomik dhe duke shtuar presionin mbi mjedisin. Një problem kryesor është mungesa e impianteve moderne që mund të sigurojnë rikuperimin e elementeve kritike nga mbetjet industriale dhe sterile, veçanërisht për kromin, manganin, kobaltin, titanomagnetitet, silicin dhe nikelin apo elementë të tjerë me interes të drejtpërdrejtë për tregun Evropian. Shumë prej impianteve aktuale operojnë me teknologji tradicionale, me eficiencë të ulët energjetike dhe me normë të kufizuar rikuperimi, duke mos përfituar plotësisht nga potenciali i mineraleve të përbërë nga shumë elementë. Në aspektin ekonomik, mungesa e stimuljeve fiskale dhe financiare është një tjetër faktor pengues. Aktualisht nuk ekziston ende asnjë skemë e dedikuar lehtësuese për kompanitë që investojnë në përpunim të thelluar, pasurim të avancuar apo në teknologji riciklimi. Po ashtu, mungojnë mekanizmat kombëtarë që mbështesin investimet në impiante pilot, testime laboratorike ose partneritete kërkim–industri për zhvillimin e proceseve inovative të rikuperimit të materialeve me vlerë.

- ***Mungesa e diversifikimit dhe zhvillimit të zinxhirit të plotë të vlerës dhe furnizimit***

Ekonomia minerare shqiptare vazhdon të karakterizohet nga dominimi i fazës së nxjerrjes, me një pjesëmarrje të kufizuar në fazat e mëvonshme të zinxhirit të vlerës, si përpunimi, rafinimi, riciklimi apo prodhimi i produkteve finale industrial, ndërkohë që Komisioni Evropian ka hapur konsultimin mbi një Akt të propozuar për Ekonominë Qarkulluese të BE-së, me miratim të pritshëm në vitin 2026. Pavarësisht potencialit të konsiderueshëm mineral që vendi zotëron, vlera e shtuar lokale mbetet e ulët, pasi shumica e mineraleve eksportohen si lëndë të papërpunuara. Kjo situatë e kufizon ndikimin real të sektorit në ekonominë kombëtare, mban sektorin gjithnjë në varësi të përpunuesit,

i cili përcakton çmimet dhe sasinë që i nevojitet, duke reduktuar mundësitë për zhvillim të industrive mbështetëse, krijim të vendeve të reja pune dhe rritje të produktivitetit kombëtar.

Një sfidë e rëndësishme në këtë drejtim është mungesa e sinergjisë ndërmjet industrisë minerare, sektorit energjetik dhe teknologjive të materialeve. Aktualisht, bashkëpunimi ndërsektorial është i fragmentuar, duke penguar krijimin e zinxhirëve të integruar të furnizimit që mund të lidhnin burimet minerare me sektorët strategjikë të ekonomisë, si energjia, ndërtimi, mbrojtja, teknologjia digjitale dhe prodhimi industrial. Krijimi i një modeli të integruar “nxjerrje – përpunim – riciklim – prodhim industrial” do të mundësonte zhvillimin e një ekonomie qarkulluese, të aftë të gjenerojë produkte me vlerë të lartë dhe të ulë varësinë nga importet.

Një tjetër problem struktural lidhet me varësinë e lartë nga luhatjet e tregjeve globale. Çmimet ndërkombëtare të metaleve bazë, sidomos të kromit, bakrit dhe hekurnikelit, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e prodhimit, në të ardhurat buxhetore dhe në klimën e investimeve. Ndryshimet e menjëhershme të kërkesës globale ose të politikave tregtare ndërkombëtare shpesh çojnë në ngadalësim të prodhimit, pezullim të aktivitetit të minierave apo ulje të fitimit për kompanitë vendase, të cilat shpesh kanë kapacitete të kufizuara për t’u përballur me këto luhatje. Për të siguruar qëndrueshmëri të kapitalit ndaj ndryshueshmërisë së tregut, kërkohet ngritja e mekanizmave të stabilitetit fiskal dhe fondeve rezervë, që do të mundësonin balancimin e ndikimeve të cikleve të tregut në periudhat e rënies së çmimeve. Po ashtu, duhet institucionalizuar përdorimi i analizave të fizibilitetit ekonomik bazuar në metodën DCF (Discounted Cash Flow), që lejon parashikimin e rreziqeve, vlerësimin e kthimeve dhe planifikimin financiar afatgjatë për çdo projekt minerar apo industrial të lidhur me sektorin.

Në këtë kuadër, diversifikimi i zinxhirit të vlerës dhe furnizimit nuk duhet të shihet thjesht si objektiv ekonomik, por si një proces transformues kombëtar, që kërkon bashkërendim ndërsektorial, transferim teknologjik, harmonizim të politikave për CRM-të dhe Tranzicionin e Gjelbër, si dhe integrim aktiv në zinxhirët evropianë të furnizimit. Vetëm në këtë mënyrë sektori minerar shqiptar mund të shndërrohet në një motor të qëndrueshëm industrial dhe ekonomik, duke ndërtuar një zinxhir furnizimi të sigurt, të diversifikuar dhe konkurrues, në përputhje me standardet dhe objektivat e Bashkimit Evropian.

- ***Nevoja për rritje të sigurisë mjedisore dhe në punë në sektorin minerar***

Sektori minerar shqiptar përballlet me një sërë sfidash strukturore që lidhen me menaxhimin e ndikimeve mjedisore, sigurinë në punë dhe rehabilitimin e zonave historikisht të ndotura, të cilat mbeten ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të tranzicionit të gjelbër dhe programit kombëtar për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike.

Trashëgimia historike e veprimtarive minerare, e akumuluar për dekada pa standarde bashkëkohore teknike dhe mjedisore, ka lënë pas një gjurmë të thellë ndotjeje, veçanërisht në zonat e Bulqizës, Rubikut, Kukësit, Korçës, Rehovës, Pogradecit, Hasit, Ersekës, Munellës, Mamëzit, Mëzezit Memaliajt, Kurbneshit, etj, ku depozitimet e mbetjeve minerare, dambat, sterilet dhe drenimi i ujrave acide të ndotura me metale të rënda vazhdojnë të përbëjnë rrezik për tokën, ujërat nëntokësore dhe shëndetin publik.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, duke marrë konsideratë edhe faktin, që procesi i mbylljes së minierave jo efektive nuk është realizuar konform praktikës Evropiane, kostoja e rehabilitimit dhe rikuperimit të plotë të këtyre zonave tejkalon 100 milionë euro, çka e bën këtë ndërhyrje një prioritet strategjik kombëtar për periudhën 2026–2040 dhe një komponent kyç të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, si dhe të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Rritjen e Qëndrueshme 2023–2030.

Pavarësisht përmirësimeve ligjore dhe përpjekjeve institucionale, zbatimi i Direktivës 2006/21/KE për menaxhimin e mbetjeve të industrive nxjerrëse mbetet i pjesshëm. Shumë impiante përpunimi dhe depozitime historike minerare vazhdojnë të operojnë me sisteme të pamjaftueshme sigurie, pa monitorim të rregullt, pa sisteme paralajmërimi të hershëm dhe pa plane emergjencash të certifikuara në rast përmbutjesh ose kolapsesh strukturorë. Kjo situatë përbën një rrezik të vazhdueshëm jo vetëm për mjedisin, por edhe për komunitetet që jetojnë në afërsi të zonave industriale.

Një tjetër boshllëk thelbësor është mungesa e një Fondi Kombëtar për Rehabilitimin e Zonave Minerare, që do të siguronte mbulimin financiar për projekte të tilla si pastrimi, rehabilitimi, rikuperimi dhe ri-përdorimi i zonave minerare pas përfundimit të aktivitetit minerar. Megjithatë subjektet minerare në Shqipëri kanë detyrimin ligjor për rehabilitimin e mjedisit dhe sigurojnë garanci financiare individuale në formën e depozitave apo garancive bankare për zbatimin e planeve të rehabilitimit, kjo zgjidhje mbetet ende e fragmentuar dhe nuk përbën një Fond Kombëtar të integruar për rehabilitimin mjedisor të zonave minerare. Aktualisht, fondet dhe garancitë menaxhohen në mënyrë të decentralizuar, rast pas rasti, dhe përdoren vetëm për licencat aktive dhe sipërfaqet konkrete të prekura nga aktivitetet nxjerrëse. Kjo qasje rezulton e pamjaftueshme për të adresuar ndotjet e akumuluar, zonat e braktisura dhe të abandonuara apo pa pronar, ku ndërhyrja kërkon mekanizma të bashkërenduar publikë, buxhet të integruar dhe transparencë në menaxhimin e fondeve për rikuperimin mjedisor. Rregullimi i sektorit drejt një Fondi Kombëtar të unifikuar dhe mekanizëm financiar të integruar, ku kontributet e industrisë dhe fondet publike menaxhohen bashkërisht, është domosdoshmëri për periudhën 2026–2040. Vetëm përmes këtij instrumenti mund të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm, përputhja me Direktivën 2006/21/KE dhe implementimi i detyrimeve të Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252) dhe Aktin e Ekonomisë Qarkulluese që pritet të hyjë në fuqi në vitin 2026, duke garantuar rehabilitimin efektiv të të gjithë zonave minerare si atyre aktive dhe atyre historike.

Në aspektin e sigurisë në punë, situata mbetet problematike. Aksidentet në miniera janë ende mbi mesataren e Bashkimit Evropian, të ndikuara nga mungesa e trajnimeve të rregullta, monitorimeve dixhitale të parametrave jetësore sidomos në minierat nëntokësore, pajisjeve moderne mbrojtëse dhe inspektimeve teknike të certifikuara. Shumë operatorë vazhdojnë të përdorin teknologji të vjetruara, ndërsa inspektoratet shtetërore përballen me mungesë personeli dhe pajisjesh për kontroll efektiv në terren. Në Strategjinë për Sigurinë në Punë 2024-2030 e hartuar nga Ministria e Ekonomisë thuhet se sektorët që kanë numrin më të lartë të aksidenteve janë sektori i ndërtimit, minierat dhe bujqësia.

Për periudhën 2026–2040, sfida kryesore do të jetë krijimi i një kuadri të integruar mjedisor–teknik, që lidh sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin me zhvillimin e qëndrueshëm industrial. Kjo nënkupton forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike, harmonizimin e plotë me Direktivën 2006/21/KE dhe Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act – Reg. (EU)

2024/1252), si dhe rivendosjen e mekanizmave financiarë dhe fiskalë që do të garantojnë përgjegjshmëri mjedisore gjatë gjithë ciklit jetësor të një projekti minerar nga kërkimi dhe shfrytëzimi deri te mbyllja dhe rehabilitimi.

- ***Nevoja për forcimin e kapitalit njerëzor dhe modernizimin teknologjik në sektorin minerar***

Një nga sfidat më të thella dhe afatgjata të sektorit minerar shqiptar lidhet me mungesën e kapitalit njerëzor të kualifikuar dhe nivelin e ulët të modernizimit teknologjik. Në dekadat e fundit, pas një periudhe të gjatë tranzicioni dhe mungese investimesh në arsimin profesional, numri i studentëve në Fakultetin e Gjeologji–Minierave, krahasuar me vitet 90-të është reduktuar në masën mbi 80%. Kjo rënie drastike ka krijuar një boshllëk të dukshëm brezash në profesionet bazë gjeologë, gjeofizikë, inxhinierë minierash, metalurgë, pasurues, kimistë industrialë, etj duke e bërë gjithnjë e më të vështirë rigjenerimin e kapaciteteve profesionale të sektorit.

Ky defiqit njerëzor shoqërohet nga një ndarje strukturore midis sistemit arsimor dhe industrisë. Arsimi universitar dhe ai profesional vazhdojnë të funksionojnë shpesh të shkëputur nga nevojat reale të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike në industri. Mungesa e programeve duale (arsim–industri) dhe e partneriteteve të qëndrueshme midis universiteteve, qendrave të formimit profesional dhe kompanive minerare ka penguar krijimin e një zinxhiri të qëndrueshëm njohurish dhe aftësive. Si rezultat, të rinjtë nuk e perceptojnë sektorin minerar si një drejtim tërheqës karriere, ndërsa kompanitë përballen me vështirësi për të gjetur staf, teknikisht dhe menaxherialisht, të trajnuar.

Epoka e zhvillimit të industrisë minerar nxjerr në pah nevojën, që gjeneratat e reja duhet të përgatiten për një realitet të ri në industrinë minerare, ku teknologjitë e reja po transformojnë çdo hallkë të zinxhirit të vlerave. Nga kërkimet gjeologjike, ku përdoren algoritme të inteligjencës artificiale për të analizuar të dhënat e terrenit, tek proceset e nxjerrjes dhe përpunimit, ku robotika dhe automatizimi reduktojnë rreziqet për punëtorët, kërkohen aftësi të reja që shkojnë përtej formimit tradicional. Presioni i industrisë për efikasitet, siguri dhe qëndrueshmëri ka sjellë nevojën për profile pune si inxhinierë të të dhënave, që interpretojnë sinjalet e sensorëve në miniera; ekspertë të inteligjencës artificiale, që optimizojnë proceset e prodhimit; specialistë të robotikës, që operojnë pajisje në mjedise të rrezikshme; si dhe ekspertë të ekonomisë rrethore, që sigurojnë rikuperimin e materialeve kritike dhe reduktimin e mbetjeve. Kjo qasje e re e bën të domosdoshme investimin në edukim dhe formim profesional, në mënyrë që brezat e rinj të jenë jo vetëm pjesëmarrës, por edhe udhëheqës të transformimit teknologjik dhe të qëndrueshëm të industrisë minerare.

Një tjetër sfidë madhore është rrjedhja e ekspertizës shqiptare jashtë vendit. Shumë profesionistë të formuar në universitetet evropiane apo ndërkombëtare, për shkak të mungesës së mundësive, infrastrukturës moderne dhe skemave të qarta bashkëpunimi, nuk përfshihen në kërkimin shkencor apo industrinë vendase. Shqipëria ende nuk ka ngritur një program të qëndrueshëm për rikthimin e ekspertëve të diasporës, siç mund të jetë në të ardhmen nisma “Brain Gain Minerar”, që do të kanalizonte ekspertizën e diasporës në kërkim, inovacion dhe transferim teknologjie për sektorin minerar në përgjithësi dhe atë të lëndëve të para kritike (CRM) në veçanti.

Përveç komponentit njerëzor, infrastruktura kërkimore kombëtare mbetet e pamjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Laboratorët e AKBN, SHGJSH dhe institucioneve

akademike janë ende të pajisur pjesërisht me teknologji moderne për analiza të avancuara gjeokimike, metalurgjike, CRM dhe mjedisore. Mungesa e pajisjeve moderne analitike si ICP-MS (spektrometri me plazmë të bashkuar me masë), XRD (difraktometri me rreze X), XRF (fluorescenca me rreze X) dhe TGA/DSC (analizues termik për stabilitet dhe përbërje materiale) së bashku me mungesën e sistemeve dixhitale të menaxhimit të të dhënave laboratorike (LIMS), kufizon ndjeshëm aftësinë e institucioneve kërkimore për të kryer analiza të avancuara, për të verifikuar saktësisht rezervat minerare dhe për të mbështetur vendimmarrjen teknike dhe mjedisore me të dhëna të standardizuara e të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Përveç laboratorëve, përdorimi i teknologjive të reja si inteligjenca artificiale (AI), dronët, sensorët gjeohapësinorë dhe “airborne surveys” mbetet ende i kufizuar në shkallë kombëtare. Këto teknologji kanë potencial për të transformuar mënyrën e kërkimit dhe monitorimit të burimeve natyrore në Shqipëri, duke mundësuar eksplorime masive, zbulim më efikas të burimeve të reja dhe ndërtim modelesh 3D të rezervave. Për më tepër, zbatimi i tyre mund të ndërlidhet me sektorë të tjerë strategjikë, si infrastruktura, planifikimi territorial, energjia, bujqësia dhe mbrojtja nga rreziqet natyrore (rrëshqitje, përmbytje, lëkundje sizmike), duke kontribuar në menaxhimin e integruar të territorit.

Një dimension tjetër i sfidës është forcimi i kapaciteteve institucionale publike për t’iu përgjigjur kërkesave të reja të sigurisë, mbikëqyrjes dhe transparencës. Institucionet si AKSEM, AKBN, SHGJSH, Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Punës (ISHMP) dhe njësitë e kontrollit teknik kanë ende mangësi në pajisje moderne, staf të specializuar dhe mjete digjitale për monitorim në kohë reale. Përdorimi i mjeteve GPS, dronet Lidari inspektues dhe sensorët e fushës, si dhe ndërtimi i një Platforme Kombëtare të Monitorimit të Sektorit Minerar, do të forconte ndjeshëm kontrollin e sigurisë teknike, mbrojtjen e punonjësve dhe parandalimin e aksidenteve industriale.

Në horizontin 2026–2040, prioriteti strategjik duhet të jetë integrimi i kapitalit njerëzor të specializuar me teknologjitë inteligjente dhe forcimi i institucioneve publike. Vetëm përmes arsimimit të avancuar, digjitalizimit, kërkimit shkencor, dhe modernizimit institucional, sektori minerar shqiptar mund të arrijë standardet e BE-së, duke u shndërruar në një model të zhvillimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

Në aspektin e sigurisë në punë, situata mbetet problematike. Aksidentet në miniera janë ende mbi mesataren e Bashkimit Evropian, të ndikuara nga mungesa e trajnimeve të rregullta, monitorimeve dixhitale të parametrave jetësore sidomos në minierat nëntokësore, pajisjeve moderne mbrojtëse dhe inspektimeve teknike të certifikuara.

Një numër i konsiderueshëm i operatorëve vazhdojnë të përdorin teknologji të pa përditësuar, ndërsa inspektoratet shtetërore përballen me mungesën e personelit të trajnuar dhe pajisjeve për kontroll efektiv në terren.

Në Strategjinë për Sigurinë në Punë 2024-2030 e hartuar nga Ministria e Ekonomisë theksohet se sektorët që kanë numrin më të lartë të aksidenteve janë sektori i ndërtimit, minierat dhe bujqësia.

Për periudhën 2026–2040 aktiviteti minerar do të duhet të përballojë sfidat kryesore të aktivitetit në këtë fushë dhe ato mjedisore si vijon :

1. Sfida kryesore në aktivitetin minerar do të jetë:

- Ndërprerja, duke respektuar afatet ligjore, e aktivitetit minerare të shfrytëzimit në lejet pa rezerva apo me rezerva të kufizuara që përfaqësojnë një risk të konsiderueshem për jetët e punonjësve;
- Bashkimi gradual i njësive të vogla prodhuese në njësi më të medha, të cilat do të mundësojnë instalimin e sistemeve të integruara bashkëkohore të kontrollit të kushteve të sigurisë dhe mbrojtjes në punë në miniera, në mënyrë të veçantë të minierave nëntokësore.

2. Sfidë për krijimi e një kuadri të integruar mjedisor–teknik:

Në këtë drejtim, për periudhën 2026–2040, sfida kryesore do të jetë krijimi i një kuadri të integruar tekniko- mjedisor, që lidh sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin me zhvillimin e qëndrueshëm industrial.

Kjo presupozon forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike të kontrollit, mbikqyrjes dhe monitorimit, harmonizimin e plotë me Direktivën 2006/21/KE dhe Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act – Reg. (EU) 2024/1252), si dhe rivendosjen e mekanizmave financiarë dhe fiskalë, që do të garantojnë përgjegjshmëri në sigurinë në punë dhe atë mjedisore gjatë gjithë ciklit të jetës së një projekti minerar nga kërkimi-zbulimi, shfrytëzimi, mbyllja, rehabilitimi dhe ripërdorimi i zonës minerare për qëllime të tjera .

- ***Mungesa e informacionit gjeologjik dhe minerar të integruar dhe nevoja për rritje të transparencës dhe promovimin***

Një tjetër sfidë e rëndësishme që pengon zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikas të sektorit minerar në Shqipëri lidhet me fragmentimin institucional dhe mungesën e një sistemi të integruar kombëtar të informacionit gjeologjik dhe minerar. Aktualisht, të dhënat mbi kërkimin, shfrytëzimin, rezervat, licencat dhe potencialin gjeologjik administrohen nga disa institucione:

i- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN),

ii- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe

iii- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ,

por pa një mekanizëm të përbashkët për shkëmbim, sinkronizim dhe verifikim të informacionit teknik. Kjo ndarje institucionale sjell mungesë koherence të të dhënave, përsëritje të proceseve, vështirësi në raportim dhe ulje të efikasitetit në planifikimin e zhvillimit të sektorit dhe në tërheqjen e investimeve strategjike.

Procesi i digjitalizimit të informacionit minerar dhe gjeologjik ka njohur përparime, por sistemet ekzistuese të menaxhimit të licencave, raportimit teknik dhe të dhënave gjeologjike nuk janë ende ndërvepruese. Mungesa e një platforme të vetme kombëtare që bashkon informacionin mbi licencat aktive, raportet teknike, analizat gjeologjike, të dhënat e rezervave dhe hartat digjitale pengon krijimin e një panorame të plotë të sektorit, rrit rrezikun e mbivendosjeve në territor dhe vështirëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit minerar. Kjo situatë bëhet pengesë për rritjen e investimeve të huaja pasi pengon aksesimin e investitorëve dhe aktorëve të interesuar në të dhëna të sakta, të standardizuara dhe të krahasueshme me sistemet evropiane.

Një tjetër problem i rëndësishëm lidhet me zbatimin ende të kufizuar të parimeve të Open Data dhe standardeve të BE-së INSPIRE për qasje të lirë dhe të harmonizuar në të dhënat gjeohapësinore. Aktualisht, shumë nga informacionet minerare dhe gjeologjike të disponueshme nuk janë të azhurnuara apo të hapura në formate të standardizuara, e cila kufizon aksesin e institucioneve kërkimore, kompanive minerare dhe investorëve strategjikë në të dhëna që janë thelbësore për planifikim dhe vendimmarrje.

1.5 Vizioni i Strategjisë Minerare

Vizioni i Strategjisë Minerare është të paraprijë zhvillimin e industrisë minerare shqiptare drejt një modeli modern, të integruar dhe konkurrues në zinxhirin e vlerave evropiane. Synimi kryesor është përmbushja e objektivave të Lëndëve të Para Kritike (CRM) sipas pragjeve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian, si dhe rritja e efikasitetit të shfrytëzimit të burimeve minerare primare dhe sekondare përmes teknologjive të avancuara dhe riciklimit.

Shqipëria synon të kthehet në një qendër rajonale për prodhimin dhe përpunimin e mineraleve strategjike, duke kontribuar në tranzicionin e gjelbër, inovacionin teknologjik dhe sigurinë energjetike të Bashkimit Evropian. Ky vizion mbështet krijimin e një sektori minerar të qëndrueshëm, të dixhitalizuar dhe me vlerë të shtuar të lartë, që nxit zhvillimin ekonomik, punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e komuniteteve lokale, duke menduar në të njëjtën kohë për brezat e ardhshëm. Në të njëjtën kohë, ai garanton menaxhimin efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve natyrore, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

2 PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

2.1 POLITIKA I - FORCIMI I VLERËSIMIT DHE NXJERRJES SË BURIMEVE MINERARE

2.1.1 Qëllimi i politikës

Qëllimi i kësaj politike është fuqizimi i bazës minerare kombëtare përmes zgjerimit të kërkimit, zbulimit dhe vlerësimit të burimeve minerare, me fokus të veçantë të lëndët e para kritike (Critical Raw Materials – CRM), në përputhje me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252) dhe kërkesat e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian. Kjo politikë synon krijimin e një sistemi kombëtar të integruar të eksplorimit, raportimit dhe dixhitalizimit të të dhënave gjeologjike dhe minerare, i cili: i) mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar; ii) siguron furnizim të qëndrueshëm për ekonominë kombëtare; iii) kontribuon në integrimin e Shqipërisë në zinxhirët evropianë të furnizimit me lëndë të para kritike.

2.1.2 Situata aktuale

Situata aktuale, në kuadër të politikës së fuqizimit të nxjerrjes dhe vlerësimit të burimeve minerare në Shqipëri, mbetet sfiduese, por me mundësi të mëdha.

Pas viteve 1990, kërkimi dhe zbulimi mineral përfaqësohet tërësisht nga një aktivitet ekonomik privat, me përqendrim në vendburimet ekzistuese të kromit, bakrit dhe hekur-nikelit, ndërkohë që lëndët e para kritike të listuara nga BE (CRM) mbeten kryesisht të pazhvilluara. Sipas të dhënave të fundit nga AKBN (2024–2025), Shqipëria ka regjistruar 270–320 leje aktive për minerale metalore (krom, bakër, hekur–nikel, mangan, magnezit, titan, boksit, fosforit, etj.), me shpërndarje të orientuar kryesisht në qendrat historike minerare (Bulqizë, Martanesh, Tropojë, Kukës, Rubik, Munellë, Prrrenjas, Devoll, Elbasan, etj.).

Megjithëse aktiviteti minerar është i gjerë, kërkimet e reja eksploruese janë minimale gjatë dekadës së fundit. Shfrytëzimi i rezervave ekzistuese ka vijuar në kufijtë e njohur të vendburimeve pa kryer rivlerësime të mundësive të zgjerimit të tyre apo rivlerësime të reja sipas standardeve ndërkombëtare UNFC/JORC, çka ka reduktuar portofolin e rezervave dhe ka rritur pasigurinë për furnizimin afatgjatë. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), si autoritet përgjegjës për licensimin dhe administrimin e fondit kombëtar të të dhënave gjeologjike, nuk kryen aktualisht kërkime aktive për mungesë fondesh publike dhe për shkak të riskut të lartë të aktiviteteve eksploruese.

Në përputhje me Nenin 19 të CRM Act, Shqipëria ende nuk ka hartuar një Program Kombëtar të Kërkimeve Minerare (National Exploration Programme), dokument i cili duhet të përcaktojë zonat me potencial të lartë për lëndë të para kritike, hartat prognozë, fushatat gjeokimike dhe gjeofizike, dhe rivlerësimin e burimeve ekzistuese sipas standardit UNFC.

Ajo që karakterizon sektorin është dominimi i plotë nga aktivitetet për materiale ndërtimi: për periudhën 2022–2025 ekzistojnë 137 leje për gurë gëlqerorë inerte, 38 leje për lëndë të parë ndërtimi, 25 leje për gurë pllakorë dekorativë, 29 për blloqe dekorativë, si dhe me dhjetëra leje për materiale si bazalt, konglomerat, ranor silicor e brekcieve, kryesisht të përqendruara në qarqet Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Berat, Korçë, Vlorë dhe Kukës.

Aktualisht, sipas raporteve të AKBN-së mbizotëron prodhimi i materialeve për ndërtim, kështu në vitin 2018 dokumentohen 38 milion ton gurë gëlqerorë prodhuar për inerte dhe 2.3 milion ton për çimento, ndërsa prodhimi i metaleve mbetet në nivel modest. Kjo prirje, megjithëse mbështet fuqishëm ndërtimin, ka krijuar një boshllëk të madh në investimet për kërkim dhe zbulim të burimeve kritike metalore, duke rrezikuar portofolin rezervë të sektorit.

Dixhitalizimi i të dhënave dhe hartografia interaktive janë ndër arritjet më të avancuara të sektorit minerar, duke siguruar akses të shpejtë dhe të hapur për të dhënat e lejeve, hartave gjeologjike dhe pjesërisht të statistikave kombëtare. Kjo ka lehtësuar kërkimin dhe transparencën për investitorët, operatorët dhe publikun, si dhe ka rritur efikasitetin në menaxhimin e informacionit të sektorit.

Megjithatë, mungon ende standardizimi real i të dhënave sipas formateve të pranuara ndërkombëtare si UNFC, si dhe integrimi i një sistemi kombëtar të konsoliduar për raportimin, analizën dhe krahasueshmërinë e të dhënave të rezervave dhe prodhimit metalor/jometalor. Aktualisht, Shqipëria:

- Nuk ka miratuar ende një program kombëtar të koordinuar për kërkim–zbulim vendburimesh të ndryshme, i cili do të orientojë investimet publike dhe private drejt burimeve minerale strategjike dhe kritike;

- Ka leje metalore të shpërndara, pa integrim të plotë me harta prognozë apo një axhendë të qartë të kërkimit të ri;
- Në strukturën prodhuese, materialet e ndërtimit (gurë gëlqerorë, inerte) dominojnë si në numër lejesh ashtu edhe në raportimet statistikore, duke lënë në hije segmentin kërkimor për mineralet kritike dhe metalore.

Kjo situatë nënvizon nevojën për reforma të thella ligjore, thellim të dixhitalizimit dhe harmonizim të aseteve të të dhënave, për të plotësuar boshllëkun e standardizimit dhe për të mundësuar ndërtimin e një programi kombëtar modern për kërkimin e burimeve kritike. Vetëm përmes integritit të vërtetë të pjesës publike dhe private në një sistem të standardizuar, dixhital dhe të orientuar drejt UNFC/BE, mund të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm, inovativ dhe me interes afatgjatë kombëtar e Evropian për sektorin minerar shqiptar.

2.2 Objektivat Specifike

2.2.1 OS 1. Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve Gjeologjike

Ky objektivi synon krijimin e një programi të koordinuar kombëtar për kërkimin dhe zbulimin e burimeve minerale, me theks të veçantë të lëndët e para kritike (CRM), në përputhje me kërkesat e BE-së. Plani do të përcaktojë prioritetet gjeografike dhe minerale, do të promovojë përdorimin e metodave moderne gjeofizike, gjeokimike dhe hartografike, si dhe do të lehtësojë orientimin e investimeve publike e private drejt zonave me potencial të lartë ekonomik.

2.2.2 OS 2. Rivlerësimi i vendburimeve me rezerva ekzistuese sipas standardit ndërkombëtar UNFC (United Nations Framework for Resources/Reserves Classification).

Ky objektivi parashikon modernizimin dhe harmonizimin e sistemit të vlerësimit të burimeve minerale përmes aplikimit të standardit ndërkombëtar UNFC, që garanton krahasueshmëri dhe transparencë të të dhënave në nivel Evropian dhe më tej. Rivlerësimi do të mundësojë kategorizimin e rezervave sipas parametrave ekonomikë, teknikë dhe mjedisorë, duke përmirësuar cilësinë e informacionit për investitorët dhe politikëbërësit. Zbatimi i UNFC do të rrisë besueshmërinë e tregut minerar shqiptar, duke e bërë më tërheqës për partnerë strategjikë dhe duke siguruar bazë të qëndrueshme rezervash për furnizimin afatgjatë të industrisë.

2.2.3 OS 3. Integrimi i kërkimeve gjeologjike me planifikimin hapësinor, zhvillimin territorial dhe mbrojtjen e mjedisit

Ky objektivi synon koordinimin ndërsektorial midis kërkimit minerar, planifikimit të territorit dhe mbrojtjes së mjedisit. Përmes përdorimit të sistemeve GIS, do të mundësohet ndërthurja e të dhënave minerare me hartat e planifikimit urban, zonat e mbrojtura, zonat bujqësore dhe infrastrukturën kritike. Kjo do të garantojë një shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të burimeve, duke minimizuar konfliktet ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së ekosistemeve. Në këtë mënyrë, kërkimi dhe vlerësimi i burimeve minerare do të jenë pjesë integrale e politikave të zhvillimit të territorit dhe tranzicionit të gjelbër kombëtar.

2.2.4 OS 4. Krijimi i mekanizmave të përbashkët publik–privat për financimin dhe promovimin e kërkimeve të reja gjeologjike dhe minerare.

Ky objektivi ka për qëllim të nxisë partneritete strategjike ndërmjet sektorit publik dhe privat në fushën e kërkim - zbulimit dhe inovacionit mineral. Përmes krijimit të fondeve të përbashkëta, granteve konkurruese dhe nismave të bashkëfinancimit, do të sigurohet mbështetje për kërkime të reja gjeologjike, zhvillim teknologjik dhe trajnime të specializuara. Këto mekanizma do të mundësojnë reduktimin e riskut për investitorët, duke përfshirë gjithashtu edhe fondet evropiane për kërkim dhe inovacion. Në këtë mënyrë, sektori mineral shqiptar do të pozicionohet si një ekosistem i qëndrueshëm, inovativ dhe konkurrues, i aftë të kontribuojë në sigurinë e furnizimit Evropian me lëndë të para kritike.

2.3 Treguesit kryesorë

- Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që mundësojnë zgjerimin e kërkimeve minerare, përmirësimin e procedurave të licencimit dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare për raportimin e rezervave (UNFC/JORC), si dhe vendosjen e detyrimit ligjor për përgatitjen dhe miratimin e Planit Kombëtar të Kërkimeve Minerare çdo pesë (5) vjet, deri në fund të vitit 2030
- Programi Kombëtar i Kërkimeve Minerare miratohet deri në fund të vitit 2028, si instrument strategjik për orientimin e kërkimeve kombëtare në përputhje me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act).
- Rivlerësimi i të paktën 80% të burimeve/rezervave kombëtare deri në vitin 2030, në përputhje me standardet ndërkombëtare UNFC etj.
- Rritje me 50% e numrit të lejeve kërkim–zbulimi për mineralet pjesë e Listës së mineraleve kritike deri në vitin 2040, në raport me periudhën bazë 2025.
- Përfshirja e dimensionit gjeologo-mineral dhe të burimeve kritike në Strategjinë Kombëtare për Tranzicion të Gjelbër dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, duke siguruar integrimin ndërsektorial të sektorit mineral me energjinë, industrinë dhe inovacionin.
- Zbatimi, duke filluar nga viti 2026, nga SHGJSH, i programit kombëtar të kërkimeve në zonat me potencial të lartë për lëndë të para kritike me 2 deri 3 projekte kërkimore private publike çdo vit,
- Krijimi i “Exploration Data Packages” për të paktën 20 zona potenciale deri në vitin 2030, për t’u ofruar investitorëve informacion të standardizuar dhe të verifikuar gjeologjikisht.
- Rritje me 30% e investimeve private në kërkime minerare deri në vitin 2030, nëpërmjet skemave të bashkëfinancimit publik–privat dhe përmirësimit të klimës investuese.

3 POLITIKA 2 - MODERNIZIMI, RICIKLIMI DHE DIVERSIFIKIMI I ZINXHIRIT TË PLOTË TË VLERËS NË SEKTORIN MINERAR

3.1 Qëllimi i politikës

Krijimi i një zinxhiri të qëndrueshëm, të integruar dhe konkurrues së vlerës në sektorin minerar shqiptar, që përfshin kërkimin, zbulimin, nxjerrjen, përpunimin, riciklimin dhe prodhimin e produkteve të reja finale me vlerë të shtuar. Kjo politikë synon të transformojë Shqipërinë nga një eksportues i lëndëve të papërpunuara në një aktor të integruar në zinxhirin Evropian të furnizimit me lëndë të para kritike (CRM), në përputhje me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252), Aktin e EU për Ekonomisë Qarkulluese (Circular Economy Act) si dhe Direktivën 2006/21/KE për mbetjet minerare.

3.2 Situata aktuale

Sektori minerar shqiptar është në një fazë kyçe transformimi: potenciali i lartë gjeologjik për lëndë të para kritike e strategjike, nuk shoqërohet ende me një zinxhir të integruar të vlerës dhe furnizimit. Struktura aktuale mbetet e orientuar drejt eksportit të lëndëve të para të papërpunuara, ndërsa kapacitetet për përpunim të thelluar, pasurim, riciklim dhe inovacion teknologjik janë të kufizuara. Brenda këtij kuadri, kromi, bakri dhe nikeli përbëjnë bazën më të fortë për ndërtimin e një ekonomie minerare të qëndrueshme, në linjë me Reg. (EU) 2024/1252 (Akti CRM) dhe Direktivën 2006/21/KE.

Kromi. Shqipëria është një nga prodhuesit kryesorë në Evropë, me rezerva të përqendruara në masivet ultrabazike të Bulqizës, Tropojës, Kukësit dhe Shebenik–Pogradecit. Rreth 82% e prodhimit vjen nga Bulqiza (rreth 56% e rezervave të njohura). Kromitet janë të tipit podiform, me përmbajtje të lartë Cr_2O_3 , dhe raport të favorshëm Cr/Fe, të përshtatshme për prodhimin e ferrokromit dhe industrinë e çeliqueve të kromuar. Megjithatë, një pjesë e xeheroreve ka cilësi të ulët ($\leq 18\% \text{Cr}_2\text{O}_3$), çka ka rritur stokun e sterileve dhe ekspozon nevojën për pasurim më efikas. Sot operojnë 16 fabrika pasurimi (rreth 90 mijë ton koncentrat kromi/ vit, 48–50% Cr_2O_3), ndërsa ferrokromi në Burrel dhe Elbasan është ~70 mijë ton/vit, kapacitetet e instaluar nuk shfrytëzohen plotësisht për shkak të kostos së energjisë dhe luhatjeve të çmimeve.

Bakri. Industria, e zhvilluar fuqishëm para viteve '90, sot është e reduktuar dhe e përqendruar kryesisht në depozitat VMS të Mirditës (Munella, Spaç, Qafë Bari), të cilat japin mbi 90% të prodhimit vjetor.

Burimet e njohura gjeologjike llogariten në rreth 37,5 milion ton me një përmbajtje të Cu 1.3-2.5%. Rezervat gjeologjike në minierat në aktivitet prej 24,1 milion ton me 1.39% Cu. Rezervat gjeologjike në vendburimet e reja prej 13,4 milion ton me 1.853% Cu. Një pjesë e konsiderueshme e burimeve mbetet e pa vlerësuar sipas standarteve për mungesë zbulimeve verifikuese, infrastrukturës dhe teknologjisë së pa testuar.

Dambat historike të sterileve (Kurbnesh, Rubik) përmbajnë përqendrime të konsiderueshme të Cu–Zn–Ni–Cr, duke ofruar potencial real për rikuperim dytësor dhe projekte të modelit “Nga mbetjet minerare në burime” (mining-waste to resources).

Nikeli dhe kobalti. Vendburimet lateritike Fe–Ni dhe Ni–Si shtrihen përgjatë kufirit lindor (Kukës, Librazhd–Pogradec, Devoll). Rezervat (resurset) e mbetura vlerësohen rreth 310 Mt xeheror me ~1% Ni dhe ~0.06% Co; në total, mbi 3.3 Mt Ni metalik dhe ~184 kt Co mund të siguronin furnizim afatgjatë për tregun. Sipas rekordeve historike hidrometalurgjia me teknologjinë “Caron” në

Elbasan ishte joefikase, por inovacioni në këtë drejtim bazuar në teknologji të reja tashmë të aplikuara gjerësisht në botë mund ta bëjë efektiv përpunimin e nikelit në Shqipëri. Prodhimi aktual i mineralit mbetet nën 0.5 Mt/vit, i cili eksportohet tërësisht jashtë vendit për shkrirje. Një hap i rëndësishëm është ndërtimi i rafinerisë së parë të nikelit në Qafë Thanë (CVMR, 2025), që sinjalizon hyrjen në përpunim vendor të pastër dhe me profil mjedisor neutral.

Minerale të tjera strategjike. Titanomagnetiti (≈ 133 Mt mineral primar + ≈ 137 Mt depozita pluhuri, $\sim 6\%$ TiO_2) shihet si kontribues për zinxhirin evropian të titanit (BE është e varur 100% nga importet e TiO_2), veçanërisht për industrinë e mbrojtjes, hapësinore dhe mjekësisë. Potenciali për Tokat e Rralla REE (~ 1.17 Mt metalik në depozita pluhurore) e zgjeron më tej horizontin drejt materialeve për industrinë e mobiliteteve (magnetët permanentë), turbinat eolike dhe teknologjitë e gjelbra.

Kanalet e integritimit në EU. Me një prodhim të qëndrueshëm të kromit dhe perspektivë të qartë për Ni–Co, Shqipëria mund të kalojë nga eksportimi i lëndëve të papërpunuara drejt furnizimit të BE-së me **produkte të përpunuara** dhe **materiale dytësore** (përmes riciklimit/valorizimit të sterileve). Kjo kërkon modernizim teknologjik, rritje të kapaciteteve të pasurimit/rafinerimit, standardizimit të të dhënave dhe forcimit të menaxhimit të mbetjeve, në mënyrë që potenciali gjeologjik të shndërrohet në zinxhir të integruar të vlerës—në përputhje me Aktin CRM dhe objektivat e ekonomisë qarkulluese të BE-së.

3.3 Objektivat Specifike

3.3.1 OS 1 Rregullimi i kornizës ligjore për leje përpunimi në gjithë zinxhirin e vlerave

Synimi i këtij objektiwi është të vendosë një kuadër ligjor të qartë dhe funksional, i cili i jep përpunimit të mineraleve, metalurgjisë dhe rafinimit statusin e një hallke të veçantë (pajisje me leje të dedikuara apo të veçantë) në zinxhirin e vlerave minerare. Aktualisht, mungesa e një leje të dedikuar, për këto hallka përpunimi, ka bërë që proceset e përpunimit të trajtohen si pjesë dytësore e shfrytëzimit, duke mos konsideruar riperpunimin e lëndëve dytësore, ulur rëndësinë e tyre dhe duke krijuar boshllëqe në menaxhimin e burimeve natyrore. Synimi është që përmes rregullimit të kornizës ligjore të sigurohet ndarje e qartë e përgjegjësisë, kontroll më i fortë mbi teknologjitë e përdorura, si dhe rritje e transparencës në menaxhimin e resurseve. Ky objektivi synon gjithashtu të forcojë rolin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) si autoritet përgjegjës për miratimin dhe monitorimin e skemave teknologjike, duke garantuar që proceset e përpunimit të jenë të mbrojtura, efikase dhe të harmonizuara me standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, rregullimi i kuadrit ligjor nuk shihet thjesht si një masë administrative, por si një instrument strategjik për të mbrojtur burimet e parinovueshme, për të rritur konkurrueshmërinë e industrisë minerare dhe për të përshpejtuar tranzicionin drejt ekonomisë rrethore.

3.3.2 OS 2 Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit përmes teknologjive të inovacionit

Ky objektiv synon modernizimin e infrastrukturës industriale dhe teknologjike të sektorit minerar shqiptar përmes integritit të teknologjive të avancuara të pasurimit, përpunimit dhe riciklimit, të bazuara në inovacion dhe digjitalizim. Qëllimi është rikuperimi i plotë i lëndëve të para kritike në përputhje me kërkesat e Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRM Act), ulja e mbetjeve minerare, rritja e efikasitetit energjetik, si dhe garantimi i përputhshmërisë me standardet mjedisore të BE-së. Zbatimi i teknologjive moderne të pasurimit dhe përpunimit, si proceset hidrometalurgjike, leaching in-situ, bioteknologjitë për rikuperimin e metaleve, apo teknologjia e karbonilit paraqesin një zgjidhje të avancuar dhe të qëndrueshme për përpunimin e depozitave lateritike të nikelit, hekurit dhe kobaltit, duke ofruar efikasitet të lartë në rikuperimin e metaleve kritike dhe duke kontribuar në reduktimin e ndikimeve mjedisore. Nga ana tjetër përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) dhe sensorëve të automatizuar për monitorimin në kohë reale të proceseve, do të mundësojë transformimin e sektorit drejt një modeli industrial të qëndrueshëm, digjital, efikas, miqësor me mjedisin dhe konkurrues në nivel Evropian.

3.3.3 OS 3 Rritja e përpunimit lokal dhe e vlerës së shtuar në vend.

Ky objektiv ka për qëllim zhvendosjen e fokusit të industrisë minerare shqiptare nga eksporti i lëndëve të papërpunuara drejt prodhimit të materialeve të përpunuara dhe me vlerë të shtuar. Përmes investimeve në fabrika pasurimi, rafineri dhe qendra teknologjike të përpunimit të thelluar, Shqipëria mund të reduktojë varësinë nga eksportet bruto dhe të forcojë rolin e saj në zinxhirin Evropian të furnizimit me CRM. Zhvillimi i produkteve si ferrokromi i cilësisë së lartë, koncentratet e pasuruara të bakrit dhe përzierjet Ni-Co do të mundësojnë krijimin e një ekonomie minerare të qëndrueshme, inovative dhe të orientuar drejt eksportit të produkteve finale, duke shtuar vlerën ekonomike në vend.

3.3.4 OS 4 Zhvillimi i industrisë përpunuese dhe ricikluese të lidhur

Ky objektiv synon transformimin e mbetjeve minerare dhe industriale në burime dytësore përmes zhvillimit të një industrie kombëtare të riciklimit. Në këtë kuadër, dapmat dhe skoriet historike (p.sh. në Rubik, Kurbnesh, Kukës, Burrel, Elbasan) përfaqësojnë një potencial real për rikuperimin e metaleve me vlerë (Cu, Zn, Ni, Co, Cr, REE), duke kontribuar në tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese dhe reduktimin e impaktit mjedisor. Zbatimi i këtij objekti do të mundësojë jo vetëm valorizimin e mbetjeve ekzistuese, por edhe uljen e ndotjes, krijimin e vendeve të reja të punës, dhe integritimin e praktikave të “green mining” në përputhje me Direktivën 2006/21/KE për menaxhimin e mbetjeve minerare.

3.3.5 OS 5 Integrimi i zinxhirit të furnizimit dhe inicimi i projekteve strategjike në kuadër të Aktit Evropian për CRM

Ky objektiv synon pozicionimin e Shqipërisë si furnizues i besueshëm dhe strategjik i BE-së për lëndët e para kritike, përmes zhvillimit të projekteve kombëtare dhe rajonale që plotësojnë kriteret e Nenit 27 të Akti Evropian për CRM (Reg. (EU) 2024/1252). Ai përfshin krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit industrial dhe teknologjik me partnerë evropianë, ndërtimin e mekanizmave logjistike dhe zinxhirëve të gjelbër të furnizimit, si dhe certifikimin e burimeve minerare sipas

standardeve të BE-së. Përmes këtij procesi, Shqipëria do të mund të integrohet në mënyrë të qëndrueshme në tregun Evropian të lëndëve të para, duke ofruar produkte të përpunuara, materiale dytësore dhe shërbime teknologjike me standard të lartë.

3.4 Treguesit e arritjes

- Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252) dhe Direktivën 2006/21/KE deri në vitin 2030.
- Rritje me 50% e volumit të materialeve të ricikluara në industrinë minerare dhe metalurgjike deri në 2040.
- Deri në 2030, të paktën 30% e xeherorit të kromit, bakrit dhe nikelit të përpunohet brenda territorit shqiptar.
- Rikuperimi dhe valorizimi i minimumi 20% të sterileve ekzistuese deri në vitin 2040.
- Zbatimi i kuadrit “end-of-waste” dhe certifikimi ambiental i të gjitha impianteve të pasurimit deri në vitin 2030.
- Krijimi i Fondeve të Rehabilitimit të Zonave Minerare dhe Taskforce Kombëtare për Mbetjet Minerare, funksionale deri në vitin 2030.
- Rritja me 30% e materialeve dytësore të rikuperuara për përdorim në ndërtim dhe industri.
- Regjistrimi i të paktën 3 projekteve shqiptare si “Strategic Projects under the CRM Act” deri në vitin 2040 (për lëndet e para kritike).
- Përfshirja e Shqipërisë në Mekanizmin e Investimeve Strategjike të BE-së (InvestEU & IPCEI CRM) deri në vitin 2030.
- Rritje me 50% e investimeve private në projekte të integruara CRM (nxjerrje–përpunim–riciklim).
- Rritje graduale e eksportit të produkteve të përpunuara në BE.

4 POLITIKA 3 - SIGURIA, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

4.1 Qëllimi i politikës

Të garantohet një sektor minerar tërësisht të sigurt, të kontrolluar teknikisht e institucionalisht dhe të zhvilluar mbi standarde të larta mjedisore, në përputhje me objektivat e Tranzicionit të Gjelbër Evropian dhe Aktit Evropian për Lëndët e Para Kritike.

Politika synon të sigurojë: i) Parandalimin e aksidenteve industriale dhe ndotjeve; ii) Rehabilitimin e zonave historikisht të ndotura; iii) Forcimin e sigurisë teknike dhe në punë; iv) Përafrimin e plotë të standardeve mjedisore, ESG dhe shëndetit të punonjësve me praktikatat më të mira të BE-së.

4.2 Situata aktuale

Sektori minerar shqiptar përballët me problematika të mëdha të sigurisë në punë, degradimit të mjedisit dhe zhvillimit të paqëndrueshëm. Në vitin 2024 në total në rang vendi janë regjistruar 177 raste aksidentesh dhe sektori “Miniera–Kariera” përfaqëson 12% të të gjitha aksidenteve të deklaruar në punë. Në sektorin “Miniera–Kariera” ka pasur 3 aksidente me humbje jete, nga 33 në total në rang vendi dhe ato përfaqësojnë 9% të tyre, të cilat në pjesët më të madhe ndodhën në minierat e Bulqizës dhe në Vlorë. Minierat shqiptare akoma kanë një normë aksidentesh dhe fatalitetesh mbi mesataren e vendeve të BE-së.

Nga ana mjedisore, rezultatet e monitorimeve të MIE, AKBN dhe raporteve të EITI-t tregojnë prani të ndotjeve serioze në mbi 4.1 km² territor (0.014% e vendit) të lidhura me dambat historike të minierave, sidomos në Bulqizë, Rubik, Rehovë, Munellë, Kurbnesh e Përrenjas. Zonat e sterilit përmbajnë përqëndrime të larta metalesh të rrezikshme, duke rrezikuar tokën, ujërat dhe komunitetet lokale. Nga mbi 100 milionë euro të nevojshme për rehabilitim, vetëm një pjesë shumë e vogël është investuar deri më sot.

Kontrolli teknik dhe mbikëqyrja institucionale mbetet e fragmentuar, pa një Fond Kombëtar për rehabilitimin mjedisor, ndërsa operatorët zbatojnë detyrimet vetëm në kuadër të projekteve të reja, duke lënë zonat e vjetra të paprekura. Plan i monitorimit të AKBN dhe MIE targeton vetëm minierat aktive, ndërsa ndotjet historike apo zonat me leje të revokuara mbeten jashtë mbulimit të plotë.

4.3 Objektivat specifikë

4.3.1 OS1 – Rritja e sigurisë teknike në punë në sektorin minerar

Ky objektivi synon përmirësimin e kushteve të sigurisë në punë dhe mbrojtjen e jetës së punonjësve në të gjitha fazat e ciklit minerar, duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin, transportin dhe përpunimin e mineraleve.

Në kushtet aktuale të sektorit minerar në Shqipëri, ku një pjesë e konsiderueshme e veprimtarive zhvillohet në miniera nëntokësore me infrastrukturë të amortizuar dhe teknologji të kufizuar sigurie, rritja e standardeve teknike është një domosdoshmëri. Shumë subjekte përballen ende me mungesë të sistemeve efektive të ventilimit, mungesë të rrjetave mbrojtëse, pajisjeve të automatizuara të monitorimit dhe mjeteve moderne për ndërhyrje emergjente.

Për realizimin e këtij objektiwi, strategjia parashikon:

Forcimin e inspektimeve teknike përmes rritjes së kapaciteteve të AKSEM, pajisjes me instrumente moderne kontrolli dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit teknik;

Modernizimin e standardeve të sigurisë në përputhje me kërkesat e ISO 45001 dhe me praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian;

Zhvillimin e një kulture sigurie dhe përgjegjëshmërie profesionale, duke përfshirë edukimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve për rrezikun dhe parandalimin e aksidenteve;

Vendosjen e sistemeve të dixhitalizuara të monitorimit në kohë reale për parametrat e sigurisë në nëntokë (ventilim, gazra, lagështi, temperatura, lëvizje gjeoteknike) dhe raportimin automatik të rreziqeve;

Mbështetjen e investimeve në teknologji të sigurta dhe miqësore me mjedisin, që reduktojnë kontaktin e drejtpërdrejtë të punonjësve me zonat me rrezik të lartë.

Zbatimi i këtij objektivi do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi pune të sigurt, në uljen e aksidenteve dhe humbjeve njerëzore, si dhe në forcimin e imazhit të sektorit minerar shqiptar si një industri moderne, e përgjegjshme dhe në përputhje me standardet evropiane të sigurisë në punë.

4.3.2 OS2 – Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave minerare, rehabilitimi i zonave të ndotura, rehabilitimi i atyre të trashëguara dhe/ose ekzistuese.

Rivendosja e ekuilibrave mjedisorë dhe socialë në zonat minerare aktive dhe historikisht të ndotura, si dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të territorit pas mbylljes së veprimtarisë minerare. Politika synon kalimin nga koncepti i “mbylljes administrative të minierës” në “mbyllje funksionale me rikthim të qëndrueshëm të territorit”. Zbatimi i këtij objektivi do të mundësojë përdorimin efikas të fondeve publike dhe private për rehabilitimin e mjediseve të dëmtuara dhe integrimin e tyre në zhvillimin rajonal.

4.3.3 OS3 – Zbatimi i standardeve mjedisore dhe certifikimi i impianteve përpunuese.

Forcimi i kontrollit mjedisor dhe teknik në të gjitha fazat e ciklit jetësor të projekteve minerare, përmes certifikimit të detyrueshëm të impianteve, monitorimit të vazhdueshëm të ndotjes dhe aplikimit të standardeve të Bashkimit Evropian. Objektivi synon sigurimin e përputhshmërisë me Direktivën 2006/21/KE për mbetjet minerare, Direktivën 2010/75/BE për emetimet industriale, dhe Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252).

4.4 Treguesit e arritjes

- Reduktimin e aksidenteve në punë nëpërmjet zbatimit rigoroz të legjislacionit për sigurinë teknike dhe përditësimit të rregulloreve minerare;
- Inspektimi dhe raportimi publik i 100% të minierave aktive çdo vit, nëpërmjet sistemit të integruar të raportimit teknik dhe mjedisor.
- Funksionalizimi i Fondit Kombëtar të Rehabilitimit deri në vitin 2026 dhe financimi i të paktën tre (3) projekteve madhore të rehabilitimit deri në vitin 2040.
- Reduktim me 40% të sipërfaqeve të ndotura nga aktivitetet minerare deri në vitin 2035, krahasuar me nivelin bazë të vitit 2025.
- Certifikimi mjedisor i 100% të impianteve të rinj para fillimit të operimit, jo më vonë se viti 2030.
- Ricertifikimi i 80% të impianteve ekzistuese sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 50001 deri në vitin 2035, për të garantuar përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore dhe energjetike.
- Reduktim me 30% të konsumit energjetik për ton produkti të përpunuar deri në vitin 2040, përmes zbatimit të teknologjive efikase dhe sistemit të menaxhimit të energjisë.
- Zbatimi i Planit të Uljes së Emetimeve të GHG në industrinë minerare (target vjetor/ton)
- Zbatimi i Direktivës ETS/CBAM dhe raportimi i carbon footprint.

5 POLITIKA 4 - Forcimi i kapitalit njerëzor dhe teknologjisë

5.1 Qëllimi i politikës

Ndërtimi i një baze të qëndrueshme kapitali njerëzor, teknologjik dhe dixhital për industrinë minerare dhe sektorin e lëndëve të para kritike, përmes nxitjes së arsimit, kërkimit dhe zhvillimit profesional në të gjitha hallkat e zinxhirit mineral. Objektivi synon forcimin e kapaciteteve profesionale, inovative dhe institucionale, si dhe integrimin e teknologjive të avancuara dixhitale, inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave në arsim, kërkim dhe vendimmarrje. Nëpërmjet këtyre masave, Shqipëria synon të formojë një brez të ri specialistësh dhe institucione efikase, të afta të mbështesin tranzicionin e gjelbër, dixhital e industrial dhe të pozicionojnë vendin si aktor konkurrues në tregun Evropian të lëndëve të para kritike.

5.2 Situata aktuale

Pas viteve 1990, ndërtimi i një ekonomie tregu solli ndryshime të thella në strukturën e arsimit profesional dhe universitar në Shqipëri. Fakulteti i Gjeologji–Minierave, dikur me mbi 500–700 studentë aktivë çdo vit, sot numëron më pak se 50 studentë në total të rregjistruar në vitin akademik 2025-2026, duke reflektuar një rënie të qëndrueshme të interesit për profesionet që lidhen me shkencat e tokës, që historikisht janë konsideruar si të vështira dhe jopreferenciale për gjeneratat e reja. Ky fenomen është shoqëruar me mbylljen ose reduktimin e shumë shkollave të mesme profesionale (shkolla e mesme profesionale në Prrenjas, Korçë, Tiranë, Rubik) që përgatitsnin teknikë për nxjerrje, përpunim dhe ndërtim, ndërkohë që fokusi i të rinjve është zhvendosur drejt degëve ekonomike dhe sociale dhe së fundmi drejt teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike.

Kjo rënie ka prodhuar mungesa të theksuara të kuadrove të kualifikuar në profesionet minerare, si gjeologë, gjeofizikë, gjeokimistë, inxhinierë minierash, teknikë, mekanikë makinerish minerare, sondistë dhe specialistë të sigurisë teknike, çka ka sjellë një pabarazi ndërmjet zhvillimit teknologjik të sektorit dhe aftësive njerëzore në dispozicion. Në të njëjtën kohë, emigrimi i ekspertëve dhe plakja e stafit teknik kanë krijuar boshllëqe të thella në përgatitjen profesionale të brezit të ri dhe në transmetimin e njohurive.

Në një tjetër plan, zhvillimi teknologjik global po ndryshon mënyrën e kërkimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore. Përdorimi i inteligjencës artificiale, analizës së të dhënave gjeohapësinore, modelimit 3D të rezervave dhe teknologjive joinvazive në kërkimin gjeologjik ka transformuar industrinë, duke e bërë të domosdoshme përfshirjen e këtyre teknologjive në kurikulat akademike dhe programet profesionale. Për Shqipërinë, kjo sjell një nevojë urgjente për përditësimin e kurrikulave arsimore, modernizimin e laboratorëve dhe formimin e kuadrove të rinj që mund të përdorin teknologjitë dixhitale në proceset e vlerësimit, planifikimit dhe monitorimit mineral.

Paralelisht, rëndësia e lëndëve të para kritike (CRM) ka marrë një vlerë strategjike në nivel Evropian dhe global, pasi përdoren gjerësisht në prodhimin e energjive të rinovueshme, pajisjeve elektronike dhe industrive të mbrojtjes. Shqipëria zotëron rezerva të konsiderueshme të kromit, bakrit dhe nikelit – minerale të cilat janë në listën e lëndëve të para strategjike të BE-së. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT (2023), sektori mineral përfaqëson rreth 3.5–4 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PPB) dhe mbi 27 % të totalit të eksporteve, ndërsa përfshin më shumë se 12 000 të punësuar direkt. Kjo tregon rolin e tij qendror në strukturën e ekonomisë kombëtare.

Në fushën e materialeve ndërtimore, industria e inerteve, çimentos dhe gurëve dekorativë përbën një tjetër komponent të rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërtim dhe infrastrukturë.

Vlera e eksporteve të materialeve ndërtimore në 2023 arriti rreth 71 milionë euro, duke reflektuar një kërkesë të qëndrueshme të tregut rajonal.

Megjithatë, lidhja ndërmjet arsimit, kërkimeve shkencore dhe industrisë vazhdon të jetë e dobët. Investimet në kapacitete kërkimore, laboratorike dhe formim profesional janë fragmentare, ndërsa mungon koordinimi institucional për zhvillimin e politikave afatgjata që garantojnë furnizim të qëndrueshëm me kapital njerëzor dhe teknologjik. Sektori përballlet me sfidën e dyfishtë të rigjallërimit të arsimit teknik dhe modernizimit teknologjik, në përputhje me tranzicionin e gjelbër dhe kërkesat e ekonomisë dixhitale.

Së fundmi Drejtoria e Përgjithshme e R&D në EU, (DG-RTD) i besoi EIT Raw Material, drejtimin e Akademisë Evropiane të Materialeve të Avancuara me qëllim trajnimin e forcave të reja të punës me dije dhe aftësi për të udhëhequr gjeneratat e reja në materialet e avancuara. Po kështu, në këtë kontekst edhe Strategjia Kombëtare Minerare 2026–2040 vendos në qendër të vizionit të saj rigjenerimin e potencialit njerëzor dhe teknologjik të sektorit përmes një qasjeje të balancuar ndërmjet arsimit, inovacionit dhe politikave zhvillimore. Synimi kryesor është të rikthehet interesi publik dhe i të rinjve për profesionet minerare e teknike, duke ndërtuar një brez të ri specialistësh të formuar me standarte bashkëkohore dhe të aftë të përballojnë kërkesat e një tregu pune gjithnjë e më të sofistikuar. Ky proces do të mbështetet në modernizimin e infrastrukturës arsimore dhe kërkimore, përfshirë laboratorët dhe impiantet eksperimentale, si dhe në përshtatjen e programeve mësimore me zhvillimet më të fundit në teknologjitë digjitale, inteligjencën artificiale dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave gjeologjike.

Në të njëjtën linjë, strategjia synon forcimin e lidhjeve ndërmjet universiteteve, industrisë dhe institucioneve publike të kërkimit shkencor, duke krijuar një rrjet efektiv bashkëpunimi që lejon shkëmbimin e njohurive, trajnimin praktik dhe zhvillimin e inovacionit aplikativ për industrinë minerare. Një pjesë e rëndësishme e këtij procesi është nxitja e rikthimit të ekspertizës shqiptare nga diaspora përmes programeve të mentorimit, kërkimit të përbashkët dhe pozicioneve të reja profesionale në mënyrë që të përforcohet baza kombëtare e aftësive teknike dhe kërkimore.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme është integrimi i teknologjive inteligjente në të gjitha hallkat e ciklit minerar nga kërkimi dhe zbulimi gjeologjik deri në proceset e përpunimit, pasurimit dhe monitorimit mjedisor për të siguruar efikasitet, siguri dhe transparencë më të lartë në menaxhimin e burimeve natyrore. Për këtë arsye, strategjia parashikon gjithashtu rritjen e kapaciteteve institucionale të monitorimit dhe kontrollit, duke pajisur strukturat shtetërore me mjete moderne dixhitale, platforma monitorimi në kohë reale dhe programe trajnimi të specializuara për inspektimin teknik e mjedisor. Ky hap synon të forcojë rolin e institucioneve publike si garant të standardeve, sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit minerar.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve të ndërthurura: arsim, teknologji, inovacion, bashkëpunim institucional dhe monitorim të avancuar, strategjia synon të kthejë sektorin minerar shqiptar në një hapësirë moderne zhvillimi, të integruar me politikat e tranzicionit të gjelbër dhe digjital të Bashkimit Evropian.

5.3 Objektivat Specifikë

5.3.1 OS4.1 – Nxitja e interesit publik dhe të rinjve për arsimin dhe karrierat në fushat e gjeologjisë, minierave dhe përpunimit të lëndëve të para minerale dhe në veçanti atyre kritike (CRM)

Ky objektiv synon rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe tërheqjen e brezit të ri drejt profesionit minierar, për të siguruar rigjenerimin e kapitalit njerëzor që do të mbështesë zhvillimin afatgjatë të sektorit. Masat përfshijnë fushata promovuese, aktivitete edukative dhe programe bursash për studentët në disiplina tekniko–shkencore.

5.3.2 OS4.2 – Përshtatja e programeve arsimore, kërkimore dhe profesionale me kërkesat e tregut për profesione të reja të punës

Ky objektiv ka për qëllim modernizimin e arsimit universitar dhe profesional përmes integritit të teknologjive të avancuara, inteligjencës artificiale, sistemit të menaxhimit të të dhënave dhe metodave të reja dixhitale të mësimdhënies, për të përgatitur profesionistë të aftë për transformimin teknologjik të sektorit minierar dhe industrisë.

5.3.3 OS4.3 – Krijimi i infrastrukturës moderne kërkimore dhe laboratorike që mbështet arsimin, inovacionin dhe industrinë minerare

Ky objektiv synon ngritjen e qendrave kombëtare të trajnimit, laboratorëve të certifikueshëm dhe infrastrukturës që lejon testimin e teknologjive të reja për përpunim, rikuperim dhe riciklim të lëndëve të para kritike, duke lidhur kërkimin me industrinë.

5.3.4 OS4.4 – Nxitja e rikthimit të specialistëve shqiptarë të formuar jashtë vendit dhe forcimi i arsimit profesional në zonat minerare

Qëllimi i këtij objekti është rigjenerimi i kuadrove dhe rigjallërimi ekonomik i qyteteve minerare, përmes rikthimit të ekspertëve të diasporës, programeve të mentorimi dhe përmirësimit të shkollave profesionale në rajonet me traditë minerare.

5.3.5 OS4.5 – Rritja e kapaciteteve të institucioneve publike për monitorim, kontroll dhe menaxhim cilësor të sektorit minierar

Ky objektiv përqendrohet në trajnimin e inspektorëve dhe ekspertëve publikë, përmirësimin e sistemeve të raportimit në kohë reale dhe zbatimin e mjeteve dixhitale, inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave për monitorim teknik dhe mjedisor efikas.

5.3.6 Treguesit kryesorë të performancës

- Rritje me 50% e regjistrimeve në programe të gjeologjisë, minierave dhe teknologjisë mjedisore deri në vitin 2040.
- Skema kombëtare e bursave funksionale deri në 2030. Azhurnimi i plotë i kurrikulave universitare dhe profesionale në fushat minerare dhe teknologjike deri në 2027.
- Krijimi i moduleve të reja mësimore me fokus në IA, GIS, HSE dhe modelim 3D deri në 2040.

- 50 ekspertë të rikthyer deri në vitin 2040, përfshirë 30 mentorë aktivë nga diaspora në universitete shqiptare deri në 2040.
- kompani që ofrojnë praktika profesionale për nxënësit e arsimit teknik.
- 10 kompani spin-off dhe start-up teknologjike të ngritura nga profesionistë të rikthyer deri në 2040.

6 POLITIKA 5 - INFORMACION I INTEGRUAR DHE TRANSPARENÇË NË SEKTORIN MINERAR

6.1 Qëllimi i politikës

Qëllimi themelor i kësaj politike është ndërtimi i një sistemi kombëtar të integruar të informacionit gjeologjik dhe minerar, i cili ofron menaxhim të centralizuar, publikim të organizuar dhe analizë të detajuar mbi burimet natyrore, rezervat minerale, zonat me potencial ekonomik, zonat e mbrojtura dhe aktivitetet e shfrytëzimit. Ky sistem synon të garantojë transparencë maksimale, efikasitet institucional dhe vendimmarrje të mbështetur në evidenca, duke shërbyer për interesat e institucioneve publike, investitorëve vendas dhe të huaj, komuniteteve lokale, si dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Krijimi i një infrastrukture të unifikuar të të dhënave minerare nuk është thjesht nevojë praktike, por edhe një kërkesë e drejtpërdrejtë për përafrimin e plotë me rregulloret evropiane. Akti Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. (EU) 2024/1252) vendos detyrimin për publikim dhe raportim periodik të të dhënave kombëtare mbi burimet minerare, duke e kthyer dixhitalizimin dhe unifikimin e informacionit në parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen efektive të Shqipërisë në zinxhirët globalë të furnizimit.

6.2 Situata aktuale

Në Shqipëri ekziston një informacion i konsiderueshëm të dhënash gjeologjike dhe minerare të akumuluar ndër vite, që menaxhohen nga institucionet kryesore të sektorit: AKBN (lejet minerare, të dhënat mbi rezervat, prodhimin dhe aktivitetet operative), SHGJSH (arkiva gjeologjike, hartografi dixhitale tematikore dhe të dhëna nga veprimtaria shkencore), ASIG (hartografi dixhitale e territorit) dhe Qendra Rajonale e Inovacionit të EIT RawMaterials (Roadmap dhe platforma online pilot për menaxhimin e informacionit minerar).

Dixhitalizimi i të dhënave është avancuar veçanërisht në sistemet GIS dhe formatet online të lejeve, hartave e statistikave, duke lehtësuar aksesin për institucionet publike, operatorët lokalë dhe investitorët e huaj.

Megjithatë, mungon platforma e vetme kombëtare që centralizon, harmonizon dhe standardizon të dhënat në format sipas UNFC/JORC dhe rregulloreve të BE, duke e bërë të vështirë koordinimin strategjik, vendimmarrjen në nivele të larta, planifikimin e kerkim zbulimeve të reja dhe zonave objekt licensimi, integrimin me planifikimin territorial si zonat me prioritet turizmin, zonat e mbrojtura, zonat problematike në kuptim të rrisqeve natyrore, etj. si dhe lëshimin e lejeve të reja bazuar në evidenca të krahasueshme.

Në këtë realitet, proceset e licencimit, monitorimit, vlerësimit dhe planifikimit territorial shpesh mbështeten në të dhëna të fragmentuara apo të papërditësuara. Vetë investitorët privatë (brenda e jashtë vendit), institucione të BE dhe komuniteti vendor kanë ende vështirësi në aksesimin e plotë të informacionit për burimet, rezervat, zonat me potencial ekonomik apo statusin ligjor të terreneve minerare.

Ky boshllëk i integritetit të të dhënave gjeologjik dhe minerare e bën urgjente: i) harmonizimin e databazave, ii) standardizimin e informacionit sipas praktikave ndërkombëtare, iii) krijimin e një sistemi kombëtar të integruar e të hapur, që mundëson transparencë, planifikim të qëndrueshëm dhe afrim institucional me ekosistemin evropian për burimet natyrore.

Vendosja e kësaj infrastrukture është jo vetëm domosdoshmëri praktike, por dhe parakusht ligjor sipas Aktit Evropian për Lëndët e Para Kritike (Reg. EU 2024/1252), për të siguruar publikimin dhe raportimin periodik të të dhënave minerare, si një hap kyç drejt një sektori të qëndrueshëm, transparent dhe të integruar me BE.

6.3 Objektivat specifike

6.3.1 OS5.1 – Krijimi i një databaze kombëtare të integruar dhe digjitale për të gjitha të dhënat minerare dhe gjeologjike

Ky objektivi ka për qëllim ngritjen e një sistemi unik informacioni që përfshin të dhënat sasiore dhe cilësore të burimeve minerare sipas vendburimeve, tipologjisë së mineraleve dhe interesit ekonomik e teknologjik. Sistemi do të mundësojë mbledhjen, verifikimin dhe publikimin e të dhënave nga të gjitha burimet shtetërore (AKBN, SHGJSH) dhe private në një format të unifikuar dhe të përditësuar.

6.3.2 OS5.2 – Sigurimi i aksesit të strukturuar dhe të diferencuar për përdoruesit publikë dhe privatë

Ky objektivi synon krijimin e një sistemi me nivele të ndryshme qasjeje për institucionet shtetërore, investitorët privatë, komunitetet akademike dhe aktorët ndërkombëtarë, duke garantuar përdorim të sigurt të informacionit dhe mbrojtje të të dhënave sensitive. Përmes tij, do të rritet ndjeshëm efikasiteti në proceset e planifikimit, monitorimit dhe vendimmarrjes në sektor.

6.3.3 OS5.3 – Mbështetja e vendimmarrjes strategjike, planifikimit të qëndrueshëm dhe transparencës publike

Ky objektivi fokusohet në përdorimin e të dhënave të integruara për planifikimin afatgjatë të zhvillimit minierar, përfshirë: i) përcaktimin e zonave me prioritet kërkimi dhe shfrytëzimi, ii) kufizimin dhe mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore, iii) dhe menaxhimin e marrëdhënieve midis zonave të mbrojtura dhe atyre minerare. Ai parashikon gjithashtu ndërtimin e mekanizmave për monitorim të vazhdueshëm dhe raportim publik, në mënyrë që vendimmarrja të jetë transparente, gjithëpërfshirëse dhe e mbështetur në evidenca shkencore.

6.4 Treguesit kryesorë

7 MASAT PRIORITARE TË QEVERISË PËR IMPLEMENTIM

7.1 POLITIKA 1 – FORCIMI I VLERËSIMIT DHE NXJERRJES SË BURIMEVE MINERARE

7.1.1 Masat Prioritare - OS1 – Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve Gjeologjike

- Masa P1.OS1.MP1 – Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për kërkim–zbulimin mineral

Kjo masë synon rishikimin dhe përditësimin e legjislacionit primar dhe akteteve nënligjore për kërkim–zbulimin mineral, me qëllim: zgjerimin e hapësirës për kërkime të reja, rritjen e afatit të zoterimit të lejes së kërkim–zbulimit, thjeshtimin dhe saktësimin e procedurave të licencimit, si dhe vendosjen e detyrimit ligjor për hartimin periodik të Planit Kombëtar të Kërkimeve–Zbulimeve Minerare.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatues: SHGJSH, AKBN

Mbështetje teknike/koordinuese: RIC Albania

- Masa P1.OS1.MP2 – Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve–Zbulimeve Minerare (CRM)

Kjo masë synon hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Kërkimeve–Zbulimeve Minerare, i cili do të shërbejë si instrument kryesor strategjik për orientimin e kërkimeve gjeologjike drejt lëndëve të para kritike dhe zonave me potencial të lartë ekonomik, në përputhje me kërkesat e CRMA dhe prioritetet kombëtare.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: SHGJSH, AKBN

Partnerë: RIC Albania, universitete, sektori privat

- Masa P1.OS1.MP3 – Kërkime gjeologjike, gjeofizike dhe gjeokimike (airborne survey)

Kjo masë parashikon realizimin e një programi të integruar kërkimesh gjeologjike, gjeofizike dhe gjeokimike, përfshirë survejime ajrore (airborne survey), me synim mbulimin e një sipërfaqeje të konsiderueshme në km² dhe krijimin e dataset-eve të standardizuara e të verifikuara gjeologjikisht. Programi konceptohet si projekt ndër–institucional në shërbim të gjeologjisë, planifikimit territorial dhe infrastrukturës kombëtare të të dhënave.

Autoritet përgjegjës: MIE
Institucione zbatues: SHGJSH
Mbështetje teknike/koordinuese: RIC Albania

- Masa P1.OS1.MP4 – Zbatimi i projekteve kërkimore publike–private në zona prioritare

Kjo masë parashikon zbatimin, duke filluar nga viti 2028, të programit kombëtar të kërkimeve në zonat me potencial të lartë për lëndë të para kritike, me 2 deri në 3 projekte kërkim–zbulimi çdo vit. Projektet do të realizohen përmes skemave të bashkëfinancimit publik–privat dhe/ose përmes financimeve nga donatorët dhe instrumentet e programeve të BE-së, me synim identifikimin sa më të saktë të rezervave të mineraleve të dobishme, me fokus të veçantë tek lëndët e para kritike.

Kjo masë parashikon projektimin dhe vënien në zbatim të skemave të strukturuar bashkëfinancimi për kërkim–zbulimin mineral, duke kombinuar fondet kombëtare me instrumente të BE-së (p.sh. IPA, Horizon Europe) dhe burime të tjera financimi ndërkombëtar (si EBRD, banka zhvillimore etj.). Skemat do të synojnë rritjen e pjesëmarrjes së kapitalit privat në fazat e kërkimit dhe prognozës, përmes granteve të bashkëfinancuara, risk-sharing, garancive dhe mekanizmave të ngjashëm, si dhe përgatitjen e aplikimeve të përbashkëta në programet kërkimore të BE-së dhe instrumentet financiare ndërkombëtare për projekte publik–privat.

Autoritet përgjegjës: SHGJSH
Mbështetje institucionale: MIE, AKBN
Mbështetje teknike/koordinuese: RIC Albania

- Masa P1.OS1.MP5 – Përgatitja e “Exploration Data Packages” për investitorët

Kjo masë synon përgatitjen e pakove të standardizuara të të dhënave (“Exploration Data Packages”) për zonat prioritare, që përfshijnë informacion të plotë gjeologjik, gjeofizik, gjeokimik, juridik dhe mjedisor të verifikuar, të cilat do t’u vihen në dispozicion investitorëve për të ulur pasiguritë dhe kostot e hyrjes në projekte të reja kërkim–zbulimi.

Autoritet përgjegjës: SHGJSH
Mbështetje institucionale: MIE, AKBN

7.1.2 Masat Prioritare - OS2 – Rivlerësimi i vendburimeve sipas standardit UNFC

- Masa P1.OS2.MP1 – Udhëzues teknik për raportimin e burimeve dhe rezervave sipas UNFC

Kjo masë synon hartimin dhe miratimin e një udhëzuesi teknik kombëtar për raportimin e burimeve dhe rezervave minerare në përputhje me standardin UNFC. Udhëzuesi do të përcaktojë klasifikimet, kriteret teknike, formatet e raportimit dhe detyrimet e operatorëve dhe institucioneve, duke siguruar standardizim, krahasueshmëri ndërkombëtare dhe bazë të unifikuar për vendimmarrje dhe financim.

Autoritet përgjegjës: MIE
Institucione zbatuese: SHGJSH, AKBN

- Masa P1.OS2.MP2 – Rivlerësimi i rezervave kombëtare sipas UNFC

Kjo masë parashikon rivlerësimin progresiv të vendburimeve ekzistuese në të gjithë territorin, me objektiv rivlerësimin e të paktën 80% të rezervave kombëtare deri në vitin 2035 sipas UNFC. Procesi do të bazohet në të dhënat ekzistuese, verifikime shtesë në terren dhe analiza laboratorike, duke rritur transparencën, besueshmërinë e të dhënave dhe tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja.

Autoritet përgjegjës: SHGJSH

Bashkëpunim: AKBN, kompani private

- Masa P1.OS2.MP3 – Krijimi i regjistrit kombëtar dixhital të burimeve dhe rezervave (UNFC)

Kjo masë synon ngritjen e një regjistri kombëtar dixhital të burimeve dhe rezervave minerare, të strukturuar sipas UNFC dhe të integruar me sistemin kombëtar të informacionit minerar. Regjistri do të shërbejë si bazë për planifikim strategjik, monitorim dhe raportim, si dhe do të mundësojë qasje të kontrolluar për institucionet, investitorët dhe aktorët e tjerë relevantë.

Autoritet përgjegjës: AKBN

Mbështetje teknike: SHGJSH, RIC Albania

- Masa P1.OS2.MP4 – Trajnime për institucionet dhe kompanite private

Kjo masë parashikon zhvillimin e programeve të strukturuar trajnimi për stafin e MIE, SHGJSH, AKBN, RIC Albania dhe operatorët minerarë, me fokus në aplikimin praktik të UNFC, metodologjitë e rivlerësimit të rezervave, përdorimin e regjistrit dixhital dhe përgatitjen e raporteve të standardizuara. Trajnimet synojnë rritjen e kapaciteteve teknike dhe sigurimin e zbatimit të njëtrajtshëm të standardit në të gjithë sektorin.

Institucione përgjegjëse/zbatuese: MIE, SHGJSH, AKBN, RIC Albania

7.1.3 Masat Prioritae - OS3 – Integrimi me planifikimin territorial dhe zonat e mbrojtura mjedisore

- Masa P1.OS3.MP1 – Modul GIS për integrimin e të dhënave minerare–territoriale

Kjo masë synon zhvillimin e një moduli të dedikuar GIS për integrimin e të dhënave gjeologo–minerare me ato të planifikimit territorial, zonave të mbrojtura mjedisore, infrastrukturës dhe përdorimeve të tjera të tokës. Moduli do të përdoret nga institucionet qendrore dhe vendore për analizë hapësinore, vlerësim të ndikimeve dhe vendimmarrje të informuar për zhvillimin e zonave minerare dhe mbrojtjen e mjedisit.

Autoritet përgjegjës: MIE, MTE

Institucione zbatuese: SHGJSH, AKBN, ASIG

Partnerë: Autoritetet vendore dhe agjencitë përgjegjëse për planifikimin territorial dhe mjedisin

- Masa P1.OS3.MP2 – Përditësimi i planeve kombëtare me zonat e zhvillimit territorial me prioritet minerar

Kjo masë parashikon rishikimin dhe përditësimin e planeve kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit territorial, duke përfshirë qartë zonat me prioritet minerar, kufizimet mjedisore dhe ndërveprimin me sektorë të tjerë (energji, infrastrukturë, turizëm, bujqësi). Qëllimi është që dimensionin minerar të integrohet në mënyrë eksplicite në dokumentet planifikuese, duke shmangur konfliktet e mëvonshme dhe duke orientuar zhvillimin në zona me potencial të lartë dhe ndikim të menaxhueshëm.

Autoritet përgjegjës: MIE, MTE

Institucione zbatuese: SHGJSH, AKBN, ASIG

Partnerë: Autoritetet vendore dhe agjencitë përgjegjëse për planifikimin territorial dhe mjedisin

- Masa P1.OS3.MP3 – Identifikimi i zonave me konflikte hapësinore

Kjo masë synon analizimin dhe identifikimin e zonave ku interesat minerare bien ndesh me zonat e mbrojtura, përdorimet ekzistuese të territorit ose rreziqet mjedisore e natyrore. Rezultati do të jetë një raport sintezë me harta të zonave konfliktuale dhe një paketë rekomandimesh për harmonizim (p.sh. kufizime, kushte të posaçme shfrytëzimi, ose përjashtime), në mënyrë që zhvillimi minerar të jetë i përputhshëm me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Autoritet përgjegjës: MIE, MTE

Institucione zbatuese: SHGJSH, AKBN, ASIG

Partnerë: Autoritetet vendore dhe agjencitë përgjegjëse për planifikimin territorial dhe mjedisin

7.2 POLITIKA 2 – MODERNIZIMI, RICIKLIMI DHE DIVERSIFIKIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS

7.2.1 Masat Prioritare - OS1 – Rregullimi i kornizës ligjore për leje përpunimi dhe procesimi në gjithë zinxhirin e vlerës

- Masa P2.OS1.MP1 – Leje të dedikuara për përpunim, procesim metalurgjik dhe rafinim

Kjo masë synon krijimin e një regjimi të veçantë licencash për aktivitetet e përpunimit, procesimit metalurgjik dhe rafinimit, të ndarë qartë nga lejet e shfrytëzimit minerar, me kushte specifike teknike, mjedisore dhe financiare. Ajo synon të mundësojë zhvillimin e impianteve moderne të pasurimit, rafinimit dhe prodhimit të aliazhëve dhe materialeve të ndërmjetme të orientuara drejt kërkesave dhe standardeve të tregut të BE-së.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

Mbështetje teknike: RIC Albania

- Masa P2.OS1.MP2 – Udhëzues teknik për miratimin dhe monitorimin e skemave teknologjike

Kjo masë parashikon hartimin e një udhëzuesi teknik që përcakton procedurat, kriteret dhe indikatorët për miratimin, monitorimin dhe kontrollin e skemave teknologjike të përpunimit dhe riciklimit nga AKBN. Udhëzuesi do të forcojë rolin e AKBN si autoritet teknik, duke siguruar që teknologjitë të jenë efikase, të sigurta dhe në përputhje me standardet mjedisore të BE-së, përfshirë kërkesat për ekonomi qarkulluese dhe reduktim të ndikimeve në mjedis.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

Partnerë: RIC Albania, operatorë private

- Masa P2.OS1.MP3 – Përafrimi i kuadrit ligjor me CRMA dhe Direktivat Evropiane në fuqi

Kjo masë synon përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar që rregullon përpunimin, mbetjet minerare dhe impiantet e pasurimit me Aktin Evropian për Lëndët e Para Kritike (CRMA) dhe Direktivat Evropiane në fuqi për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse. Ajo përfshin analizën e boshllëqeve ligjore, hartimin e ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore, si dhe vendosjen e detyrimeve të qarta për menaxhimin e sigurt, riciklimin dhe valorizimin e mbetjeve minerare në përputhje me standardet e BE-së.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: MIE, AKBN, SHGJSH

Mbështetje: Ministria e Mjedisit/MTM, RIC Albania

7.2.2 Masat prioritare - OS2 – Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit përmes teknologjive të inovacionit

OS2 synon krijimin e një baze të modernizuar industriale për përpunim, rafinim dhe riciklim të mineraleve, me fokus të teknologjitë me efikasitet të lartë, emetime të ulëta dhe integrim të parimeve të ekonomisë qarkulluese në zinxhirët e vlerës CRM.

- Masa P2.OS2.MP1 – Mbështetja e investimeve në teknologji të avancuara për përpunim dhe riciklim

Kjo masë synon nxitjen e investimeve në impiante të reja, si dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese të përpunimit dhe riciklimit, përmes adoptimit të teknologjive të avancuara si hidrometalurgjia, bioteknologjia, proceset me efikasitet të lartë energjie dhe teknologjitë me emetime të reduktuara. Instrumentet e mbështetjes përfshijnë lehtësira fiskale, skema bashkëfinancimi dhe orientim drejt fondeve evropiane dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë kombëtare në zinxhirët e vlerës së BE-së.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN, operatorë privatë

Partnerë: RIC Albania, institucione financiare ndërkombëtare

- Masa P2.OS2.MP2 – Zbatimi i projekteve pilot me teknologji të avancuara

Kjo masë parashikon zbatimin e projekteve pilot që testojnë dhe demonstrojnë teknologji të avancuara, përfshirë hidrometalurgjinë, in-situ leaching, bioteknologjinë, inteligjencën artificiale dhe sisteme sensor-based sorting në impiantet e pasurimit, rafinimit dhe riciklimit. Qëllimi është optimizimi i proceseve, rritja e rendimentit metalik, ulja e humbjeve në rrjedhën teknologjike dhe reduktimi i konsumit të energjisë dhe ujit, duke rritur njëkohësisht sigurinë teknike dhe kontrollin operacional; targetohen të paktën 4 projekte pilot deri në vitin 2040.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN, operatorë privatë

Mbështetje teknike: RIC Albania, universitete

7.2.3 Masat prioritare - OS3 – Rritja e përpunimit lokal dhe vlerës së shtuar ne vend

- Masa P2.OS3.MP1 – Krijimi i zonave industriale minerare (hubs për pasurim, rafinim dhe prodhim materiali)

Kjo masë synon krijimin e të paktën dy zonave industriale minerare të specializuara, të cilat do të funksionojnë si “hubs” për pasurimin, rafinimin dhe prodhimin e materialeve të ndërmjetme dhe produkteve me vlerë të shtuar për zinxhirët CRM. Zonat do të pajisen me infrastrukturë të përbashkët energjetike, logjistike dhe mjedisore, si dhe me paketa lehtësuese për investitorët strategjikë, me objektiv që ≥ 2 zona industriale të jenë të miratuara dhe funksionale deri në vitin 2040.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN, AIDA, autoritetet vendore

Partnerë: RIC Albania

- Masa P2.OS3.MP2 – Reduktimi i eksportit të lëndës së papërpunuar; Rritja e përpunimit vendas të kromit, bakrit dhe nikelit

Kjo masë fokusohet në rritjen progresive të përpunimit në territor të kromit, bakrit dhe nikelit, me synimin që të paktën 30% e xehërorit të këtyre mineraleve të përpunohet në vend. Instrumentet përfshijnë skema stimulimi për impiantet vendase, kërkesa për raporte vjetore mbi sasitë e përpunuara, si dhe masa për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me lëndë të parë, në mënyrë që të rritet vlera e shtuar kombëtare dhe të reduktohet eksporti i lëndës së papërpunuar.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

- Masa P2.OS3.MP3 – Nxitja e investimeve direkte në zinxhirin e përpunimit të CRM

Kjo masë synon të tërheqë dhe rrisë investimet private në projekte të integruara të përpunimit të lëndëve të para kritike, duke përfshirë prodhimin e ferrokromit, materialeve për bateri dhe aliazhëve të avancuar. Parashikohen instrumente promovimi, incentiva fiskale dhe mbështetje teknike për

projekte që lidhin nxjerrjen, përpunimin dhe prodhimin final, me objektiv rritjen me të paktën 50% të investimeve private në projekte të integruara CRM deri në vitin 2035.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

Institucion koordinues: RIC Albania

7.2.4 Masat prioritare - OS4 – Zhvillimi i industrisë përpunuese dhe ricikluese të lidhur (mbetje/mining waste)

- Masa P2.OS4.MP1 – Plani Kombëtar për Riciklimin dhe Valorizimin e mbetjeve minerare

Kjo masë synon hartimin dhe miratimin e një Plani Kombëtar “mining-waste to resources” që përcakton vizionin, objektivat, prioritetet territoriale dhe masat konkrete për riciklimin dhe valorizimin e mbetjeve minerare. Plani do të përfshijë një listë prioritetesh për dambat dhe skoriet, kriteret për zgjedhjen e projekteve, standardet teknike dhe mjedisore, si dhe një kornizë financimi dhe partneritetesh publike–private.

Autoritet përgjegjës: MIE, MTE

Institucione zbatuese: AKBN

Institucion koordinues: RIC Albania

- Masa P2.OS4.MP2 – Identifikimi dhe karakterizimi i dambave dhe skorieve historike për rikuperim metalesh

Kjo masë parashikon inventarizimin, karakterizimin gjeokimik dhe teknologjik të dambave dhe skorieve historike në zona prioritare (Rubik, Kurbnesh, Kukës, Burrel, Elbasan) për të vlerësuar potencialin e rikuperimit të metaleve si Cu, Zn, Ni, Co, Cr, etj. dhe elementëve të tokave të rralla (REE). Rezultati do të jetë një seri raportesh teknike për çdo sit dhe një databazë e përditësuar kombëtare që mbështet vendimmarrjen për projekte riciklimi dhe investime të reja.

Institucione zbatuese: AKBN, SHGJSH, RIC Albania

- Masa P2.OS4.MP3 – Projekte riciklimi/valorizimi për të paktën 20% të sterileve ekzistuese deri në 2035

Kjo masë synon zbatimin e projekteve konkrete riciklimi dhe valorizimi për të paktën 20% të sterileve dhe tailings ekzistuese, duke rikuperuar metale dhe materiale të tjera të përdorshme dhe duke reduktuar gjurmën mjedisore të depozitave. Monitorimi do të bëhet përmes treguesve si përqindja e sterileve të rikuperuara dhe volumi i metaleve të rikuperuara, ndërsa projektet do të inkurajohen përmes skemave të dedikuara të mbështetjes dhe lehtësimit të procedurave.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: operatorë privatë

- Masa P2.OS4.MP4 – Zbatimi i kuadrit “end-of-waste” dhe certifikimi ambiental i impianteve të pasurimit

Kjo masë parashikon hartimin dhe zbatimin e kuadrit kombëtar “end-of-waste” për materialet e dala nga proceset e pasurimit dhe riciklimit, duke përcaktuar kushtet kur mbetjet minerare klasifikohen si produkte dytësore. Paralelisht synohet certifikimi ambiental i impianteve të pasurimit sipas standardeve përkatëse, me objektiv që një numër në rritje impiantesh të jenë të certifikuara deri në vitin 2030 dhe të sigurojnë menaxhim të sigurt dhe të qëndrueshëm të mbetjeve.

Autoritet përgjegjës: MTE

Partner kryesor: MIE

- Masa P2.OS4.MP5 – Fondi i Rehabilitimit të Zonave Minerare dhe Task-Force Kombëtare për Mbetjet Minerare

Kjo masë synon krijimin e një Fondi të dedikuar për rehabilitimin e zonave minerare të dëmtuara dhe të një Task-Force Kombëtare për Mbetjet Minerare, që do të koordinojë politikën, projektet dhe kontrollin mbi mbetjet minerare. Fondi do të financohet nga buxheti i shtetit, kontributet e operatorëve dhe donatorët, ndërsa Task-Force do të jetë operacionale deri në vitin 2027, me mandat për prioritetizimin e ndërhyrjeve, monitorimin e zbatimit dhe raportimin periodik.

Autoritet përgjegjës: MIE, MTE

Institucione zbatuese: AKBN

7.2.5 Masat prioritare - OS5 – Projekte strategjike CRM dhe integrimi evropian

- Masa P2.OS5.MP1 – Identifikimi dhe zhvillimi i projekteve kombëtare/rajonale si “Strategic Projects under the CRM Act”

Kjo masë synon identifikimin, strukturimin dhe promovimin e projekteve kombëtare dhe rajonale në sektorin e CRM-së që plotësojnë kriteret për t’u klasifikuar si “Strategic Projects” sipas CRM Act, duke përfshirë depozita prioritare, impiante përpunimi dhe projekte integruese rajonale. Deri në vitin 2040 synohet regjistrimi i të paktën 3 projekteve si strategjike, përmes hartimit të paketave të plota teknike dhe financiare, angazhimit me Komisionin Evropian dhe partnerët rajonalë, si dhe koordinimit institucional të përqendruar.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese/partnerë: RIC Albania, AKBN

- Masa P2.OS5.MP2 – Marrëveshje bashkëpunimi industrial dhe teknologjik me kompani evropiane

Kjo masë parashikon zhvillimin e marrëveshjeve afatgjata bashkëpunimi me kompani evropiane në sektorë si çeliku, bateritë dhe industria aero-hapësinore, për të mundësuar furnizim të qëndrueshëm me lëndë të para, përpunim në vend dhe transferim teknologjie. Fokus vendoset te projektet ku Shqipëria ofron lëndë të para dhe kapacitete përpunimi, ndërsa partnerët evropianë sjellin

teknologji, standarde dhe tregje eksporti; progresi matet përmes numrit të marrëveshjeve të nënshkruara dhe vëllimit të eksporteve të produkteve të përpunuara.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

Partnerë: RIC Albania, operatorë privatë

7.3 POLITIKA 3 – SIGURIA, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

7.3.1 Masat prioritare - OS1 – Siguria teknike dhe shëndeti në punë

- Masa P3.OS1.MP1 – Forcimi i kapaciteteve inspektuese të AKSEM

Kjo masë synon pajisjen e AKSEM me infrastrukturë moderne inspektimi (pajisje matëse për ventilimin, gazrat, gjeoteknikën, pajisje personale sigurie), si dhe rritjen e numrit dhe nivelit profesional të inspektorëve përmes trajnimeve të vazhdueshme. Qëllimi është rritja e numrit dhe cilësisë së inspektimeve në miniera dhe impiante përpunimi, duke siguruar zbatimin efektiv të standardeve të sigurisë teknike.

Autoritet përgjegjës: AKSEM

- Masa P3.OS1.MP2 – Përditësimi i Rregullores së Sigurisë Minerare praktikat më të mira të BE-së

Kjo masë parashikon rishikimin e plotë të rregullores ekzistuese të sigurisë minerare, harmonizimin e saj me kërkesat e ISO 45001 dhe praktikat më të mira të BE-së, si dhe miratimin e saj si akt nënligjor detyrues. Rregullorja e re do të përcaktojë qartë detyrimet e operatorëve, procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe mekanizmat e raportimit të aksidenteve, duke forcuar kulturën e sigurisë në sektor.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKSEM, AKBN

- Masa P3.OS1.MP3 – Instalimi i sistemeve të monitorimit në kohë reale

Kjo masë synon vendosjen e sistemeve të monitorimit të vazhdueshëm për parametrat kritikë të sigurisë (ventilim, koncentrim gazrash, stabilitet gjeoteknik, nivel uji etj.) në minierat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Sistemet do të transmetojnë të dhëna në kohë reale drejt qendrave të kontrollit të operatorëve dhe AKSEM, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe parandalim të aksidenteve; progresi matet me numrin e sistemeve të instaluar dhe funksionale deri në vitin 2040.

Autoritet përgjegjës: AKSEM

- Masa P3.OS1.MP4 – Program kombëtar trajnimesh për sigurinë në punë

Kjo masë parashikon zhvillimin e një programi të strukturuar trajnimi për punonjësit e minierave

dhe impianteve të përpunimit, duke mbuluar menaxhimin e rrezikut, përdorimin e PPE, procedurat e emergjencës dhe raportimin e incidenteve. Trajnimet do të realizohen nga AKSEM në bashkëpunim me AKBN dhe RIC Albania, me objektiv rritjen e numrit të punonjësve të trajnuar dhe certifikuar gjatë periudhës 2026–2030.

Institucione përgjegjëse: AKSEM, AKBN, RIC Albania

- Masa P3.OS1.MP5 – Audit teknik i detyrueshëm vjetor për minierat aktive

Kjo masë vendos detyrimin për zhvillimin e auditimeve teknike vjetore të të gjitha minierave aktive, duke kontrolluar përputhshmërinë me rregullat e sigurisë, integritetin e sistemeve teknike dhe menaxhimin e rrezikut. Synohet që 100% e minierave aktive të auditohet çdo vit, me raportime të strukturuar dhe plane korrigjuese të monitoruara nga AKSEM dhe AKBN.

Institucione përgjegjëse: AKSEM, AKBN

7.3.2 Masat prioritare - OS2 – Rehabilitimi dhe menaxhimi i zonave minerare

- Masa P3.OS2.MP1 – Krijimi i Fondit Kombëtar të Rehabilitimit të Zonave Minerare

Kjo masë synon krijimin e një fondi të dedikuar financiar për rehabilitimin e zonave minerare të ndotura, me burime nga buxheti i shtetit, kontributet e operatorëve dhe donatorët. Fondeve do t'u përcaktohen rregulla të qarta përdorimi, kritere prioritarizimi dhe mekanizma raportimi, në mënyrë që fondi të jetë funksional dhe me buxhet të alokuar gjatë gjithë periudhës 2026–2040.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese/partnerë: MF, AKBN

- Masa P3.OS2.MP2 – Hartimi i Planit Kombëtar të Rehabilitimit

Kjo masë parashikon hartimin dhe miratimin e një Plani Kombëtar të Rehabilitimit që përcakton zonat prioritare, objektivat e rehabilitimit, standardet teknike dhe mjedisore, si dhe koston dhe afatet e ndërhyrjeve. Plani do të shërbejë si dokument kornizë për përdorimin e Fondit të Rehabilitimit dhe për koordinimin e projekteve ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: MTE, AKBN

- Masa P3.OS2.MP3 – Inventarizimi dhe hartëzimi i ndotjeve minerare dhe krijimi i databazës kombëtare

Kjo masë synon identifikimin, klasifikimin dhe hartëzimin e të gjitha ndotjeve minerare në territor (damba, sterile, ujëra të ndotura, zona të degraduara), si dhe ndërtimin e një databaze kombëtare funksionale. Databaza do të përmbajë informacione mbi llojin e ndotjes, nivelin e rrezikut, pronësinë dhe nevojat për ndërhyrje, duke u bërë bazë për planifikimin e projekteve të rehabilitimit.

Institucione zbatuese: AKBN, SHGJSH, RIC Albania

- Masa P3.OS2.MP4 – Zbatimi i të paktën 3 projekteve madhore rehabilitimi deri në 2040

Kjo masë parashikon projektimin dhe zbatimin e të paktën tre projekteve të mëdha rehabilitimi në zonat minerare me rrezik dhe ndikim më të lartë, bazuar në Planin Kombëtar dhe databazën e ndotjeve. Suksesi do të matet përmes numrit të projekteve të realizuara, sipërfaqes së rehabilituar dhe reduktimit të rrezikut mjedisor dhe shëndetësor për komunitetet lokale.

Institucione zbatuese: AKBN, AKSEM

- Masa P3.OS2.MP5 – Monitorim vjetor i zonave të pezulluara/revokuara

Kjo masë synon krijimin e një regjim monitorimi sistematik për zonat minerare me leje të pezulluara ose të revokuara, me qëllim kontrollin e stabilitetit të dambave, rrjedhjeve të ndotura dhe rreziqeve të tjera mjedisore. AKBN dhe AKSEM do të përgatisin raporte vjetore monitorimi dhe do të propozojnë masa korrigjuese kur identifikohen rreziqe të reja ose përkeqësim i gjendjes.

Institucione zbatuese: AKBN, AKSEM

7.3.3 Masat prioritare - OS3 – Standardet mjedisore dhe certifikimi

- Masa P3.OS3.MP1 – Certifikim i detyrueshëm mjedisor për impiantet e reja

Kjo masë synon që të gjitha impiantet e reja të pasurimit, rafinimit dhe riciklimit në sektorin minerar të pajisen detyrimisht me certifikim mjedisor sipas ISO 14001 dhe standardeve ESG, si kusht për marrjen ose rinovimin e lejeve. Kërkesat do të përfshijnë sisteme të menaxhimit mjedisor, monitorim të emetimeve, menaxhim të mbetjeve dhe raportim periodik ESG, me objektivin që 100% e impianteve të rinj të jenë të certifikuar në periudhën 2026–2040.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese: AKBN

- Masa P3.OS3.MP2 – Reduktimi me 30% i konsumit energjetik për ton produkt deri në 2040

Kjo masë parashikon vendosjen e objektivave detyruese për reduktimin gradual të konsumit specifik të energjisë (kWh/ton produkt) në miniera dhe impiante përpunimi, me një ulje kumulative prej të paktën 30% deri në vitin 2040. Operatorët, nën mbikëqyrjen e MIE-së, do të implementojnë masa si auditime energjetike, modernizim pajisjesh, rikuperim të nxehtësisë dhe optimizim të proceseve, ndërsa progresi do të dokumentohet në raportet vjetore ESG dhe do të përdoret si kriter për lehtësira dhe licencim.

Institucione përgjegjëse: MIE

7.3.4 Masat prioritare - OS4 – Përshpejtimi i tranzicionit drejt dekarbonizimit dhe përshtatjes klimatike

- Masa P3.OS4.MP1 – Zbatimi i Planit të Uljes së Emetimeve të GHG në industrinë minerare

Kjo masë synon zbatimin e një plani të detajuar sektorial për reduktimin gradual të emetimeve të gazeve serrë në industrinë minerare, me objektiva vjetore të uljes së emetimeve për ton produkti. Zbatimi do të monitorohet përmes raporteve vjetore GHG dhe llogaritjes së tonëve CO2 ekuivalent të kursyer, duke lidhur rezultatet me skemat kombëtare dhe europiane të klimës.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese/partnerë: MTM, AKBN

- Masa P3.OS4.MP2 – Zbatimi i Direktivës ETS/CBAM dhe raportimi i carbon footprint

Kjo masë parashikon përafrimin dhe zbatimin progresiv të kërkesave të Sistemit Evropian të Tregtimit të Emetimeve (ETS) dhe Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM) për operatorët minerarë dhe të përpunimit. Kompanitë do të detyrohen të matin dhe raportojnë gjurmën e karbonit të produkteve, të përgatisin raporte vjetore dhe të rrisin gradualisht numrin e subjekteve të përfshira, duke ulur rrezikun rregullator dhe kostot e përfshira nga CBAM në tregjet e BE-së.

Autoritet përgjegjës: MIE

Institucione zbatuese/partnerë: MTM, AKBN

7.4 POLITIKA 4 – KAPITALI NJERËZOR DHE TEKNOLOGJIA

7.4.1 Masat prioritare - OS4.1 – Nxitja e interesit publik dhe të rinjve për arsimim në gjeologji dhe miniera

- Masa P4.OS4.1.MP1 – Fushata kombëtare për promovimin e profesioneve minerare/CRM

Kjo masë synon organizimin e fushatave të vazhdueshme informuese dhe promovuese (media, rrjete sociale, evente në shkolla dhe universitete) për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe të rinjve mbi rolin e profesioneve në gjeologji, miniera dhe lëndë të para kritike. Do të realizohen çdo vit aktivitete të strukturuar me materiale edukative, modele karriere dhe shembuj praktikë nga industria.

Institucione përgjegjëse: MIE, RIC Albania, UT

- Masa P4.OS4.1.MP2 – Program kombëtar bursash për degët teknike

Kjo masë parashikon krijimin e një programi kombëtar bursash për studentët në degët gjeologji, inxhinieri minerare, përpunim materialesh, mjedis dhe fusha të lidhura me CRM, me prioritet për

të rinjtë nga zonat minerare. Skema do të mbulojë tarifa studimi dhe mbështetje shtesë financiare, e lidhur me performancën akademike dhe angazhimin në praktika profesionale në sektor.

Institucione përgjegjëse: MAS, MIE, RIC Albania

- Masa P4.OS4.1.MP3 – “Java e Mineraleve” dhe vizita studimore

Kjo masë synon organizimin vjetor të “Javës së Mineraleve”, me aktivitete në shkolla dhe universitete, panairë karriere dhe vizita studimore në miniera, impiante përpunimi dhe qendra kërkimore. Qëllimi është rritja e numrit të nxënësve dhe studentëve pjesëmarrës, përmes eksperiencave praktike që prezantojnë teknologjitë moderne, standardet e sigurisë dhe mundësitë e punësimit në sektor.

Institucione përgjegjëse: RIC, shkollat profesionale, UT

- Masa P4.OS4.1.MP4 – Platformë informuese dhe edukative për zonat minerare

Kjo masë parashikon zhvillimin e një platforme dixhitale interaktive që ofron informacion edukativ mbi gjeologjinë, zonat minerare, projektet kryesore, aspektet mjedisore dhe mundësitë e karrierës. Platforma do të integrojë harta, materiale multimediale, module mësimore dhe burime për mësuesit, duke u bërë një mjet funksional për edukim dhe transparencë ndaj publikut.

Institucion përgjegjës: RIC Albania

7.4.2 Masat prioritare - OS4.2 – Përshtatja e programeve arsimore, kërkimore dhe profesionale me tregun modern të punës

- Masa P4.OS4.2.MP1 – Azhurnimi i kurrikulave universitare dhe profesionale

Kjo masë synon rishikimin dhe përditësimin e programeve të studimit në universitet dhe shkolla profesionale në fushat e gjeologjisë, minierave, materialeve dhe mjedisit, duke i përafruar me nevojat e tregut modern të punës dhe kërkesat e industrisë minerare/CRM. Kurrikulat e reja do të përfshijnë kompetenca praktike, projekte në bashkëpunim me industrinë dhe komponentë mbi dixhitalizimin, sigurinë dhe ekonominë qarkulluese. Institucione përgjegjëse: MAS, UT, shkollat profesionale, RIC Albania

- Masa P4.OS4.2.MP2 – Futja e moduleve IA, GIS, HSE dhe modelimit 3D

Kjo masë parashikon zhvillimin dhe integrimin në programe të moduleve të reja mbi inteligjencën artificiale, sistemet GIS, shëndetin dhe sigurinë në punë (HSE) dhe modelimin 3D të proceseve gjeologjike dhe minerare. Qëllimi është rritja e numrit të moduleve bashkëkohore që u japin studentëve aftësi për të përdorur teknologjitë më të fundit në eksplorim, projektim dhe menaxhim operacional. Institucione përgjegjëse: UT-FGJM, RIC Albania

- Masa P4.OS4.2.MP3 – Skema e praktikave profesionale me industrinë

Kjo masë synon krijimin e një skeme të strukturuar praktikash profesionale për studentët në bashkëpunim me kompanitë minerare dhe institucionet publike, me marrëveshje të qarta mbi rolet, kohëzgjatjen dhe objektivat e praktikës. Numri i kompanive të përfshira dhe i studentëve pjesëmarrës do të rritet gradualisht, duke lehtësuar kalimin nga arsimi në punësim dhe duke harmonizuar aftësitë e të rinjve me kërkesat reale të industrisë. Institucione përgjegjëse: UT, MIE, RIC Albania, operatorët minerare

7.4.3 Masat prioritare - OS4.3 – Krijimi i infrastrukturës moderne kërkimore dhe laboratorike

- Masa P4.OS4.3.MP1 – Krijimi i Qendrës Kombëtare të Trajnimit dhe Laboratorëve CRM

Kjo masë synon ngritjen dhe funksionalizimin e një qendre kombëtare për trajnime praktike dhe kërkim laboratorik në fushën e lëndëve të para kritike, e pajisur me laboratore moderne analizash, testimesh teknologjike dhe module trajnimi për studentë, specialistë dhe inspektorë. Qendra do të shërbejë si pikë referimi kombëtare dhe rajonale për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe për testimin e skemave të reja teknologjike në kushte të kontrolluara. Institucion përgjegjës: RIC Albania

- Masa P4.OS4.3.MP2 – Modernizimi i laboratorëve ekzistues

Kjo masë parashikon inventarizimin dhe modernizimin e laboratorëve ekzistues gjeologjikë, minerarë dhe mjedisorë përmes pajisjeve të reja analitike, sistemeve dixhitale të menaxhimit të të dhënave dhe standardizimit sipas kërkesave të BE-së. Objektivi është rritja graduale e numrit të laboratorëve të modernizuar, duke mundësuar analiza më të sakta për eksplorim, kontroll cilësie, mjedis dhe mbetje minerare. Institucione përgjegjëse: SHGJSH, AKBN

- Masa P4.OS4.3.MP3 – Impiant pilot për testimin e teknologjive të reja

Kjo masë synon projektimin, ndërtimin dhe vënien në punë të një impianti pilot ku mund të testohen në shkallë gjysmë-industriale teknologji të reja për pasurim, rafinim, riciklim dhe valorizim të mbetjeve minerare. Impianti do të përdoret për projekte kërkimore, demonstrime për investitorët dhe validim të skemave para aplikimit në impiante komerciale, duke ulur rrezikun teknik dhe financiar për modernizimin e sektorit. Institucione përgjegjëse: MIE, RIC Albania, AKBN

7.4.4 Masat prioritare - OS4.4 – Nxitja e rikthimit të specialistëve të diasporës dhe forcimi i arsimit profesional

- Masa P4.OS4.4.MP1 – Program për rikthimin e ekspertëve të diasporës

Kjo masë synon krijimin e një programi të dedikuar për identifikimin, angazhimin dhe rikthimin e ekspertëve shqiptarë të diasporës në fushat e gjeologjisë, minierave, materialeve dhe mjedisit, përmes pakove të posaçme incentivash profesionale dhe financiare. Programi do të matet përmes

numrit të ekspertëve të rikthyer dhe kontributit të tyre në institucione publike, universitete dhe industri. Institucione përgjegjëse: MIE, RIC Albania

- Masa P4.OS4.4.MP2 – Program mentorimi diaspora–universitet

Kjo masë parashikon ngritjen e një rrjeti mentorësh nga diaspora akademike dhe industriale, të cilët do të punojnë në distancë dhe gjatë vizitave në vend me studentë dhe të rinj profesionistë në universitetet shqiptare. Programi do të strukturohet në cikle vjetore mentorimi, seminare online dhe shkëmbime, me tregues kryesorë numrin e mentorëve të përfshirë dhe numrin e studentëve pjesëmarrës. Institucione përgjegjëse: RIC Albania, UT

7.4.5 Masat prioritare - OS4.5 – Rritja e kapaciteteve institucionale për monitorim, kontroll dhe menaxhim cilësor

- Masa P4.OS4.5.MP1 – Trajnime të avancuara për monitorimin e shfrytëzimit të minierave në sipërfaqe dhe nëntokë

Kjo masë synon rritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve të AKBN dhe AKSEM përmes programeve të avancuara trajnime mbi monitorimin teknik të shfrytëzimit, analizën e rrezikut gjeoteknik, vlerësimin e stabilitetit të dambave dhe përdorimin e pajisjeve moderne matëse. Rezultati pritët të reflektohet në rritjen e numrit të inspektorëve të certifikuar dhe në cilësinë e kontrolleve në terren gjatë periudhës 2026–2040. Institucione përgjegjëse: AKBN, AKSEM.

- Masa P4.OS4.5.MP2 – Pajisje digjitale dhe sisteme monitorimi në kohë reale

Kjo masë parashikon blerjen dhe instalimin e pajisjeve digjitale dhe sistemeve të monitorimit në kohë reale (sensorë për presion, deformime, nivel ujërash, gazra, etj.) në miniera dhe dambat kryesore, si dhe krijimin e një platforme qendrore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Numri i pajisjeve të instaluar dhe funksionale do të jetë treguesi kryesor i progresit, duke mundësuar reagim të shpejtë ndaj rreziqeve dhe menaxhim më cilësor të sigurisë teknike. Institucione përgjegjëse: AKSEM, AKBN.

7.5 POLITIKA 5 – INFORMACION I INTEGRUAR DHE TRANSPARENÇË

7.5.1 Masat prioritare - OS5.1 – Krijimi i një databaze kombëtare të integruar dhe dixhitale për të gjitha të dhënat minerare dhe gjeologjike

- Masa P5.OS5.1.MP1 – Ndërtimi i databazës kombëtare të integruar minerare

Kjo masë synon projektimin dhe zhvillimin e një databaze kombëtare dixhitale, ku integrohen të gjitha të dhënat kryesore minerare dhe gjeologjike (vendburime, licenca, prodhim, rezerva, mbetje, infrastrukturë). Databaza do të jetë funksionale, me qasje të strukturuar për institucionet dhe përdoruesit e autorizuar, duke mundësuar analizë, raportim dhe planifikim strategjik në nivel kombëtar. Institucione përgjegjëse: SHGJSH, AKBN, RIC Albania.

- Masa P5.OS5.1.MP2 – Dixhitalizimi dhe harmonizimi i arkivave gjeologjike/hartografike

Kjo masë parashikon skanimin, dixhitalizimin dhe standardizimin e arkivave ekzistuese gjeologjike dhe hartografike (raporte, profile, harta analoge), si dhe organizimin e tyre sipas formateve të unifikuara. Qëllimi është rritja e numrit të materialeve të dixhitalizuara dhe aksesueshmëria e tyre për analiza, kërkim dhe investime, duke reduktuar rrezikun e humbjes së të dhënave historike. Institucione përgjegjëse: SHGJSH, AKBN.

- Masa P5.OS5.1.MP3 – Integrimi i të dhënave të lejeve, prodhimit, rezervave dhe hartave në një sistem të vetëm

Kjo masë synon zhvillimin e një sistemi të unifikuar informacioni ku të dhënat e lejeve minerare, prodhimit, rezervave, hartave gjeologjike dhe mjedisore lidhen në mënyrë modulare dhe të integruar. Numri i moduleve të integruara do të jetë tregues kyç, duke siguruar që vendimmarrja institucionale dhe analiza për investitorët të bazohet në të dhëna koherente dhe të përditësuara në kohë reale. Institucione përgjegjëse: AKBN, SHGJSH, RIC Albania

7.5.2 Masat prioritare - OS5.2 – Sigurimi i aksesit të strukturuar dhe të diferencuar për përdoruesit publikë dhe privatë

- Masa P5.OS5.2.MP1 – Krijimi i sistemit me nivele të diferencuara qasjeje

Kjo masë synon ngritjen e një sistemi të centralizuar aksesesh ku të dhënat minerare dhe gjeologjike ofrohen sipas niveleve të ndryshme (institucione, investitorë, publik), me role dhe autorizime të qarta për çdo kategori përdoruesi. Sistemi i aksesit do të jetë funksional në periudhën 2026–2040, duke garantuar transparencë, por edhe mbrojtje të informacionit konfidencial dhe të të dhënave personale. Institucione përgjegjëse: MIE, SHGJSH, AKBN, RIC Albania.

- Masa P5.OS5.2.MP2 – Vendosja e protokolleve të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

Kjo masë parashikon hartimin dhe zbatimin e protokolleve të standardizuara për sigurinë kibernetike, ruajtjen, backup-in dhe anonimizimin e të dhënave, në përputhje me kuadrin kombëtar dhe atë të BE-së për mbrojtjen e të dhënave. Protokollet do të jenë në zbatim të plotë gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sistemit, duke minimizuar rreziqet e aksesit të paautorizuar dhe manipulimit të informacionit. Institucione përgjegjëse: MIE, SHGJSH, AKBN RIC Albania,

- Masa P5.OS5.2.MP3 – Trajnime për përdoruesit institucionalë dhe private

Kjo masë synon organizimin e trajnimeve periodike për përdoruesit institucionalë dhe privatë të databazës kombëtare, për përdorimin e sistemit të aksesit, interpretimin e të dhënave dhe respektimin e protokolleve të sigurisë. Numri i përdoruesve të trajnuar do të shërbejë si tregues i përhapjes së kapaciteteve, duke siguruar shfrytëzim të sigurt dhe efikas të platformave dixhitale. Institucion përgjegjës: RIC Albania

7.5.3 Masat prioritare - OS5.3 – Mbështetja e vendimmarrjes strategjike, planifikimit të qëndrueshëm dhe transparencës publike

- Masa P5.OS5.3.MP1 – Publikimi vjetor i Raportit Kombëtar të Sektorit Minerar

Kjo masë synon hartimin dhe publikimin çdo vit të një Raporti Kombëtar të Sektorit Minerar, që përmbledh të dhënat mbi kërkimin, prodhimin, rezervat, investimet, ndikimet mjedisore dhe performancën socio-ekonomike të sektorit. Raporti do të përdoret si instrument referimi për vendimmarrjen strategjike, dialogun me palët e interesuara dhe investime. Institucione përgjegjëse: MIE, RIC Albania, AKBN, SHGJSH

- Masa P5.OS5.3.MP2 – Identifikimi dhe publikimi i zonave me potencial mineral

Kjo masë parashikon identifikimin, vlerësimin dhe publikimin e zonave me potencial të lartë mineral, të aksesueshme për investitorët dhe institucionet. Numri i zonave të publikuara do të tregojë shkallën e transparencës dhe tërheqjes së mundshme të investimeve të reja. Institucione përgjegjëse: AKBN, SHGJSH

- Masa P5.OS5.3.MP3 – Mekanizma konsultimi publik dhe transparencë komunitare

Kjo masë synon ngritjen dhe institucionalizimin e mekanizmave të konsultimit publik (dëgjesa, forume lokale, platforma online) për projektet dhe politikat minerare, veçanërisht në zonat ku zhvillohen aktivitete nxjerrëse. Numri i konsultimeve vjetore dhe përfshirja e komuniteteve lokale do të jenë tregues kyç për rritjen e transparencës, besimit dhe pranueshmërisë sociale të projekteve. Institucione përgjegjëse: MIE, AKBN, SHGJSH, bashkitë, RIC Albania.

8 PJESA IV – IMPLEMENTIMI, PËRGJEGJËSIA DHE KOORDINIMI

8.1 Mekanizmat institucionalë për zbatim

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026–2040 do të mbështetet në një arkitekturë të qartë institucionale, e cila garanton koordinim ndërinstitutional, qartësi përgjegjësish dhe zbatim efektiv të politikave dhe masave prioritare.

Ministria përgjegjëse për energjinë dhe sektorin mineral (MIE) do të ushtrojë rolin udhëheqës strategjik, duke siguruar drejtimin politik, koordinimin ndërsektorial dhe integrimin e Strategjisë në kuadrin kombëtar të planifikimit dhe buxhetimit afatmesëm dhe afatgjatë.

Për zbatimin operativ të masave dhe projekteve prioritare aktivizohen një sërë institucionesh teknike sikurse janë SHGJSH, AKBN, AKSEM, të cilat veprojnë në bazë të planeve vjetore të punës, faturimit buxhetor dhe akteve nënligjore që burojnë nga Strategjia. Drejtoria përkatëse në MIE, siguron koordinimin e përditshëm, raportimin e progresit dhe ndërveprimin me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet e Bashkimit Evropian.

8.2 Përgjegjësitë e institucioneve

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mban rolin politikbërës dhe drejtues për sektorin minerar, duke hartuar dhe miratuar kuadrin ligjor e nënligjor, përcaktuar prioritetet e investimeve, aprovuar planet dhe programet kombëtare, si dhe koordinuar veprimtarinë me ministritë e tjera të linjës.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) funksionon si organ kryesor teknik për sektorin, përgjegjëse për licencimin, vlerësimin teknik–ekonomik të projekteve dhe monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve në fushën e kërkimit, shfrytëzimit, përpunimit dhe raportimit të të dhënave minerare.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) është institucioni kombëtar për kërkim–zbulimin gjeologjik, vlerësimin e burimeve dhe rezervave, hartografinë gjeologjike dhe studimet aplikative, si dhe përgatitjen e paketave të standardizuara të të dhënave kërkimore (“Exploration Data Packages”) për investitorët strategjikë.

RIC Albania vepron si qendër inovacioni dhe koordinator ndërmjet institucioneve publike, universiteteve, rrjetit evropian EIT RawMaterials dhe sektorit privat, duke mbështetur projektet kërkimore, transferimin e teknologjive të reja, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe ndërkombëtarizimin e zinxhirit CRM/SRM.

Albeiti (Albanian EITI) siguron transparencën dhe raportimin e rregullt të të ardhurave nga sektori nxjerrës, përfshirë minierat, përmes mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave financiare dhe fiskale, si dhe zhvillon procese dialogu me palët e interesuara për qeverisjen e mirë të burimeve natyrore.

Inspektorati Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) ushtron rolin rregullator dhe inspektues për sigurinë teknike në miniera dhe impiante përpunimi, përmes kontrolleve periodike, auditimeve teknike, verifikimit të sistemeve të monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të rregulloreve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Autoritetet vendore (bashkitë) integrojnë dimensionin minerar në planet e përgjithshme vendore, administrojnë ndikimet lokale të projekteve, zhvillojnë proceset e konsultimit me komunitetet dhe monitorojnë respektimin e kushteve të lejeve brenda territorit të tyre.

Autoritetet mjedisore dhe inspektuese mbulojnë vlerësimin dhe licencimin mjedisor, monitorimin e emetimeve, menaxhimin e mbetjeve, sigurinë teknike dhe shëndetin në punë, duke garantuar përputhshmëri me standardet e BE-së dhe objektivat kombëtare për tranzicion të gjelbër dhe zhvillim të qëndrueshëm.

8.3 Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë realizohet përmes një sistemi të kombinuar raportimi, i koordinuar nga ministria përgjegjëse dhe i mbështetur në treguesit e përcaktuar në Matricën e Masave Prioritare.

Institucionet përgjegjëse sektoriale (MIE, AKBN, SHGJSH, MTM, AKSEM, RIC Albania, Albeiti, bashkitë) dorëzojnë raporte periodike progresi, të cilat përfshijnë ecurinë e masave, realizimin e treguesve, përdorimin e buxhetit dhe problematikat e hasura.

Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë Minerare integrohet me Raportin Kombëtar të Sektorit Minerar dhe publikohet në platformën kombëtare të informacionit, duke siguruar transparencë për qytetarët, investitorët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një rishikim i ndërmjetëm strategjik parashikohet të realizohet rreth vitit 2030, për të vlerësuar arritjen e objektivave të dekadës së parë dhe për të përshtatur masat për periudhën 2031–2040 në funksion të zhvillimeve të reja teknologjike dhe të acquis të BE-së.

8.4 Pjesëmarrja e aktorëve privatë, akademikë dhe shoqërisë civile

Sektori privat përfshihet në mënyrë aktive në zbatimin e Strategjisë përmes investimeve në kërkim-zbulim, shfrytëzim, përpunim dhe riciklim, nëpërmjet mekanizmave të bashkëfinancimit publik–privat, projekteve strategjike CRM dhe platformave të partneritetit industrial me kompanitë evropiane.

Kompanitë minerare dhe përpunuese angazhohen gjithashtu në raportimin ESG, pjesëmarrjen në konsultime publike dhe në zbatimin e standardeve të sigurisë dhe mjedisit, si kusht për akses në tregjet e BE-së dhe për regjistrimin e projekteve si “Strategic Projects under the CRM Act”.

Universitetet dhe institucionet kërkimore luajnë rol të rëndësishëm në përditësimin e programeve arsimore, zhvillimin e projekteve kërkimore të aplikuara, formimin profesional dhe transferimin e teknologjisë drejt industrisë dhe institucioneve publike, në bashkëpunim të ngushtë me RIC Albania.

Shoqëria civile dhe komunitetet lokale përfshihen përmes mekanizmave të strukturuar të konsultimit publik, transparencës së të dhënave dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje për projektet kryesore, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, EITI-t dhe konventave mjedisore të BE-së.

9 PJESA V Analiza Buxhetore

9.1 Vlerësimi i kostove indikative të strategjisë 2026–2040

Metodologjia e llogaritjes së buxhetit për Strategjinë Minerare 2026–2040 është hartuar në përputhje me instrumentet dhe dokumentet financiare të miratuara zyrtarisht: Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), miratuar me VKM nr. 372, datë 2.7.2025, Ligjin e Buxhetit për vitin 2026 dhe Strategjinë Kombëtare të Specializimit Inteligjent (S3), miratuar me VKM nr. 824, datë 26.12.2024.

Kjo qasje garanton që vlerësimi i kostove të jetë i integruar në kuadrin fiskal mesvjeçar dhe në prioritetet horizontale të politikave të inovacionit dhe tranzicionit të gjelbër.

Metodologjia përcakton dy periudha buxhetore të dallueshme: një fazë e parë e investimeve të shtuara deri në vitin 2030, e cila përkon me objektivin kombëtar të aderimit në Bashkimin Evropian, dhe një fazë e dytë e konsolidimit për periudhën 2031–2040, ku fokusi zhvendoset tek ruajtja dhe zgjerimi i arritjeve. Në fazën 2026–2030, politikat e Strategjisë Minerare janë të sinkronizuara me S3, ndaj edhe tavanit buxhetor ruhet në linjë me pritshmëritë ambicioze të kësaj strategjie.

S3 parashikon një financim total prej rreth 5,912,000,000 lekësh (54,993,500 euro) për periudhën 2025–2030, që korrespondon me rreth 11 milionë euro në vit, një nivel dukshëm më i lartë se buxheti mesatar vjetor historik i sektorit (rreth 5.1 milionë euro/vit). Kjo kërkon mobilizimin e burimeve shtesë përtej fondeve tradicionale buxhetore, veçanërisht për masat që lidhen me modernizimin teknologjik, dixhitalizimin, kërkim–zbulimin (përfshirë survejet ajrore), standardizimin sipas UNFC dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Në fazën e dytë, 2031–2040, buxheti vjetor parashikohet të rritet me një normë fikse prej 3% në vit, me qëllim ruajtjen e fuqisë blerëse reale, garantimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe vijueshmërinë e investimeve në infrastrukturën minerare dhe ekosistemin CRM/SRM.

Në këtë kuadër janë modeluar dy opsione buxhetore për periudhën 2031–2040, të cilat ndryshojnë në bazën mbi të cilën indeksohet rritja: buxheti i vitit 2026 (Opsioni I) ose mesatarja vjetore e S3 për 2025–2030 (Opsioni II).

Sipas Opsionit I, buxheti i kërkuar total për zbatimin e Strategjisë Minerare 2026–2040 arrin në 12,350,000,000 lekë, ekuivalente me rreth 114,884,000 euro.

Sipas Opsionit II, buxheti total i kërkuar për të njëjtën periudhë arrin në 19,466,891,000 lekë, ekuivalente me rreth 181,087,000 euro, duke reflektuar një skenar më të zgjeruar investimesh.

9.2 Burimet e financimit

Zbatimi i Strategjisë Minerare 2026–2040 mbështetet në një kombinim burimesh financimi, ku buxheti i shtetit luan rol themelor, por nuk është i vetmi instrument. Buxheti kombëtar mbulon kostot bazë institucionale, një pjesë të investimeve kapitale dhe shpenzimet e lidhura me harmonizimin ligjor, monitorimin, rehabilitimin dhe forcimin e kapaciteteve, në linjë me PBA-në dhe Ligjin vjetor të Buxhetit.

Një komponent i rëndësishëm financimi pritet nga programet e BE-së (IPA III, Horizon Europe, InvestEU, IPCEI CRM) dhe nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë, të cilat synohen të mbështesin veçanërisht projektet e kërkim–zbulimit, laboratorët kombëtarë, platformën kombëtare të informacionit dhe projektet pilot të riciklimit dhe inovacionit teknologjik. Përveç kësaj, sektori privat pritet të kontribuojë përmes investimeve direkte dhe skemave të bashkëfinancimit publik–privat, sidomos në fushat e përpunimit, riciklimit dhe projekteve strategjike CRM.

Në terma indikativë, pritet që rreth 40–50% e kostove totale të mbulohen nga burimet buxhetore kombëtare, 25–35% nga fondet e BE-së dhe donatorët, 15–25% nga investimet private dhe pjesa

tjetër nga mekanizma të posaçëm investimi dhe garancie në kuadrin evropian. Ky konfigurim kërkon një qasje aktive të institucioneve shqiptare në përgatitjen e projekteve të kualifikuara dhe në forcimin e partneriteteve ndërkombëtare.

9.3 Hendeku financiar dhe krahasimi i dy opsioneve buxhetore

Për shkak të diferencës mes nivelit historik të financimit të sektorit dhe volumit të nevojshëm për të realizuar objektivat ambicioze të Strategjisë, krijohet një hendek financiar i konsiderueshëm, veçanërisht për masat kapitale që lidhen me kërkim–zbulimin, dixhitalizimin, laboratorët, riciklimin dhe kërkimin shkencor. Ky hendek është më i theksuar në dekadën e dytë (2031–2040), kur parashikohen investimet më të mëdha në përpunim, rafinim dhe diversifikim të zinxhirit të vlerës CRM/SRM.

Opsioni I llogarit rritjen buxhetore duke marrë për bazë buxhetin e vitit 2026, i cili është afërsisht 10% më i lartë se niveli i parashikuar në PBA, dhe aplikon një indeksim 3% në vit për periudhën 2031–2040. Ky opsion krijon një skenar më konservator, që mbulon nevojat bazë, por ka kapacitet më të kufizuar për të absorbuar plotësisht kostot e projekteve shumëkapitale në dekadën e dytë.

Opsioni II, në të kundërt, merr si bazë mesataren vjetore të buxhetit të parashikuar nga S3 për periudhën 2025–2030 (1,182,400,000 lekë) dhe aplikon indeksimin 3% mbi këtë nivel për vitet 2031–2040. Kjo qasje shmang rrezikun e nënvlerësimit të nevojave financiare, duke reflektuar më besnikërisht kostot reale të modernizimit industrial, kërkimit dhe infrastrukturës teknologjike.

Në këtë kuptim, Opsioni II siguron një planifikim më realist dhe të qëndrueshëm afatgjatë, sepse mbështetet në kapacitetin mesatar pesëvjeçar të projektuar nga S3 dhe krijon hapësirë të mjaftueshme për të përballuar angazhimet që burojnë nga CRMA, standardet mjedisore dhe kërkesat e raportimit ndërkombëtar (UNFC–CRIRSCO, ETS/CBAM). Për këtë arsye, ai konsiderohet më i përshtatshëm për mbështetjen e objektivave të integritetit evropian dhe për reduktimin e hendekut financiar në dekadën e dytë të zbatimit të strategjisë.

Të dy opsionet mbështeten në të njëjtën bazë për periudhën 2026–2030 (buxhetimi i S3, 5,912,000,000 lekë), por ndryshojnë ndjeshëm në qasjen ndaj dekadës së dytë dhe kapacitetit për të mbyllur hendekun financiar. Opsioni I ofron një variant “bazë” me indeksim 3% mbi vitin 2026, ndërsa Opsioni II përdor mesataren vjetore të S3 si bazë për indeksim dhe siguron një nivel më të lartë, më të qëndrueshëm financimi për modernizimin industrial dhe përmbushjen e angazhimeve europiane.

Tabela 1 – Krahasimi i dy opsioneve buxhetore

Elementi	Opsioni I – Variant bazë	Opsioni II – Varianti i duhur
Baza e indeksimit 2031–2040	Buxheti i vitit 2026 (rreth +10% mbi PBA)	Mesatarja vjetore S3 2025–2030: 1,182,400,000 lekë

Elementi	Opsioni I – Variant bazë	Opsioni II – Varianti i duhur
Buxheti total 2026–2040	12,350,000,000 lekë (rreth 114.9 milionë euro)	19,466,891,000 lekë (rreth 181.1 milionë euro)
Mbështetja për projekte CRM	E kufizuar; rrezik i lartë nënfinancimi në dekadën e dytë	E plotë; hapësirë e mjaftueshme për projekte strategjike dhe zinxhirë CRM
Mbyllja e hendekut financiar	Hendek i madh, veçanërisht në Politikat 1–2–3	Hendek dukshëm më i menaxhueshëm në të gjitha politikatat
Rreziku për objektivat e BE-së	I lartë; rrezik mos-përmbushjeje afatgjatë të detyrimeve nga CRMA dhe direktivat	I ulët; mundëson përputhje të plotë me CRMA, acquis dhe standardet sektoriale

9.4 Arsye kryesore për zgjedhjen e Opsionit II

Opsioni II vlerësohet si varianti më i përshtatshëm për buxhetimin afatgjatë të Strategjisë Minerare 2026–2040, pasi bazohet në mesataren vjetore reale të buxhetimit pesëvjeçar të parashikuar nga Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3), dhe jo në një vit të vetëm reference. Kjo qasje shmang efektin e luhatjeve vjetore dhe siguron një bazë më të qëndrueshme dhe më përfaqësuese për planifikimin fiskal, duke rritur parashikueshmërinë e shpenzimeve publike për periudhën 2031–2040.

Përdorimi i mesatares së S3 si bazë llogaritjeje e bën buxhetimin për dekadën e dytë më të qëndrueshëm dhe proporcional me ambicet reale të politikave sektoriale, veçanërisht në një fazë kur pritet intensifikimi i investimeve në përpunim dhe rafinim mineral, riciklim dhe ekonomi qarkulluese, infrastrukturë laboratorike, si dhe sisteme të avancuara të monitorimit dhe dixhitalizimit. Këto ndërhyrje kërkojnë angazhime financiare të vazhdueshme dhe jo ciklike, të cilat nuk mund të mbështeten në një bazë buxhetore minimale.

Opsioni II krijon gjithashtu kapacitet financiar të mjaftueshëm për të adresuar hendekun ekzistues të financimit në kuadër të Politikave 1 dhe 2, ku nevojat kapitale janë më të larta dhe ku ndikimi në konkurrueshmërinë afatgjatë të sektorit mineral dhe të zinxhirëve CRM është më i drejtpërdrejtë. Në veçanti, ky opsion mbështet në mënyrë më të plotë financimin e kërkimit–zbulimit, dixhitalizimit të të dhënave minerare, projekteve të riciklimit dhe zhvillimit të projekteve strategjike në kuadër të Aktit Evropian për Lëndët e Para Kritike.

Së fundi, Opsioni II siguron mbulim të plotë financiar për detyrimet shtesë që priten pas vitit 2030, të cilat lidhen me përshejtimin e procesit të integritimit evropian. Këto përfshijnë: përafrimin e plotë me direktivat e Bashkimit Evropian, zbatimin e standardeve UNFC për raportimin e burimeve minerare, përfshirjen progresive në mekanizmat ETS dhe CBAM, certifikimet ESG për operatorët privatë, rehabilitimin e zonave minerare të ndotura dhe funksionalizimin e laboratorëve kombëtarë të analizës dhe certifikimit. Në këtë kontekst, Opsioni II ofron një kornizë financiare realiste, të qëndrueshme dhe të përputhshme me kërkesat e BE-së, duke reduktuar rrezikun e nënfinancimit strukturor të sektorit në fazën e konsolidimit.

Tabela 2 – Opsioni II: Tabela buxhetore e detajuar sipas politikave (000 lekë)

Politika	PERIUDHA 2026-2030 (S3)				PERIUDHA 2031-2040 (Indeksim 3%)			TOTALI	
	Total (000 Lekë)	Buxheti Shtetit	IPA Aktual	Hendek	Total (000 Lekë)	Buxheti Shtetit 90%	Hendek 10%	Total (000 Lekë)	Total (Euro)
Politika 1	1,400,000	500,000	108,000	792,000	3,209,886	2,888,898	320,989	4,609,886	42,883
Politika 2	2,300,000	800,000	387,000	1,113,000	5,273,384	4,746,046	527,338	7,573,384	70,450
Politika 3	1,000,000	350,000	0	650,000	2,292,776	2,063,498	229,278	3,292,776	30,630
Politika 4	800,000	400,000	365,000	35,000	1,834,221	1,650,799	183,422	2,634,221	24,504
Politika 5	412,000	100,000	0	200,000	944,624	850,161	94,462	1,356,624	12,620
TOTAL STRAT EGJI	5,912,000	2,150,000	860,000	2,790,000	13,554,891	12,199,402	1,355,489	19,466,891	181,087

10 ANEKSET

10.1 ANEKS 1 – MATRICA E MASAVE PRIORITARE

MATRICA E MASAVE – POLITIKA 1
“FORCIMI I VLERËSIMIT DHE NXJERRJES SË BURIMEVE MINERARE”

POLITIKA	OBJEKTIVAT SPECIFIKE	MASAT PRIORITARE	TREGUESIT	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	AFATI
POLITIKA 1 – Forcimi i vlerësimit dhe nxjerrjes së burimeve minerare	OS 1 – Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Kërkimeve Gjeologjike	1.1 Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që mundësojnë zgjerimin e kërkimeve minerare, përmirësimin e procedurave të licencimit per kerkim zbulimin e mineraleve ne teresi dhe lendet e para kritike ne vecanti	Ligji/Udhëzimi i miratuar	MIE, SHGJSH, AKBN, RIC Albania	2026 - 2027
		1.2 Hartimi I Programit Kombetar i Kerkimeve Minerare, si instrument strategjik per orientimin e kerkimeve kombetare ne perputhje me Aktin Evropian per Lendet e Para Kritike (CRM ACT)prognozë për CRM dhe zonat me potencial të lartë	Programi Kombetar I Kerkim Zbulimit i miratuar	SHGJSH, AKBN, RIC Albania	2026– 2028
		1.3 Kerkim zbulime gjeologjike, gjeofizike dhe gjeokimike (airborne survey)	km² të mbuluara; dataset-e të verifikuara	SHGJSH	2026– 2030
		1.4 Zbatimi, duke filluar nga viti 2028, nga SHGJSH, i programit kombëtar të kërkimeve në zonat me potencial të lartë për lëndë të para kritike me 2 deri 3 projekte kërkimore private ose private & publike çdo vit	2 deri 3 projekte kërkim-zbulimi private publike çdo vit,	SHGJSH, MIE, RIC Albania	2028-2040
		1.5 Përgatitja e “Exploration Data Packages”, për t’u ofruar investitorëve informacion të standardizuar dhe të verifikuar gjeologjikisht.	20 paketa deri në 2030	SHGJSH	2030 - 2040
POLITIKA 1	OS 2 – Rivlerësimi i vendburimeve sipas UNFC	2.1 Udhëzuesi teknik për aplikimin e UNFC	Udhëzuesi i miratuar	MIE, SHGJSH, RIC Albania	2026– 2027
		2.2 Rivlerësimi i rezervave kombëtare sipas UNFC	80% e rezervave deri 2035	SHGJSH, AKBN	2026– 2040
		2.3 Regjistri dixhital i burimeve minerare (UNFC)	Regjistër funksional	AKBN, SHGJSH	2026– 2040
		2.4 Trajnime për institucionet dhe operatorët	Nr. trajnimeve & certifikimeve	MIE, SHGJSH, AKBN, RIC Albania	2026– 2030
POLITIKA 1	OS 3 – Integrimi i kërkimeve gjeologjike me planifikimin hapësinor dhe zonat e mbrojtura mjedisore	3.1 Modul GIS për integrim të të dhënave minerare– territoriale	Modul funksional	MIE, SHGJSH, AKBN, ASIG	2025– 2027
		3.2 Përditësimi i planeve kombëtare me zonat e zhvillimit territorial me prioritet minerar	Dokumente të harmonizuara	MIE, MTE, Bashkitë, AKBN, SHGJSH	2026– 2030
		3.3 Identifikimi i zonave me konflikte hapësinore	Raport sintezë; zona të harmonizuara	MIE, MTE, Bashkite, AKBN, SHGJSH	2026– 2028
TOTALI (000 Leke)	4,609,886				
Totali 2026-2030	1,400,000				
Totali 2031-2040	3,209,886				

MODERNIZIMI, RICIKLIMI DHE DIVERSIFIKIMI I ZINXHIRIT TË PLOTË TË VLERËS NË SEKTORIN MINERAR

POLITIKA	OBJEKTIVAT SPECIFIKE	MASAT PRIORITARE	TREGUESIT PËR ÇDO MASË	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	AFATI
POLITIKA 2 – Modernizimi, riciklimi dhe diversifikimi i zinxhirit të plotë të vlerës në sektorin minerar	OS 1 – Rregullimi i kornizës ligjore për leje përpunimi dhe procesimi në gjithë zinxhirin e vlerës	1.1 Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore për licenca të dedikuara për përpunim, procesim metalurgjik dhe rafinim	Ligj/ndryshime ligjore dhe aktet nënligjore të miratuara.	MIE, AKBN, RIC Albania	2026-2030
		1.2 Përgatitja e udhëzuesit teknik për miratimin dhe monitorimin e skemave teknologjike të miratuara nga AKBN	Udhëzuesi teknik i publikuar; nr. skemave të miratuara; nr. i kontrolleve teknologjike vjetore	MIE, AKBN, RIC Albania	2026–2030
		1.3 Përafrimi i plotë i kornizës ligjore me CRM Act dhe Direktivat Evropiane ne fuqi	Raport vlerësimi i BE; dispozita kombëtare të përafruara deri në 2030	MIE, AKBN, SHGJSH, RIC Albania	2026-2030
POLITIKA 2	OS 2 – Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit dhe riciklimit përmes teknologjive të inovacionit	2.1 Mbështetja e investimeve në teknologji të avancuara për përpunim dhe riciklim; Ndërtimi i të paktën 3 impianteve të reja përpunimi/riciklimi sipas standardeve ISO dhe ESG	≥3 impiante të ndërtuara dhe certifikuara deri në 2040	MIE, AKBN, RIC Albania, operatore private	2026–2040
		2.2 Zbatimi i projekteve pilot me teknologji të avancuara (hidrometalurgji, in-situ leaching, bioteknologji, AI, sensor-based sorting)	≥4 projekte pilot të zbatuara; raporte teknike dhe rezultate të vlerësuara	RIC, universitete, AKBN, operatorë private	2026–2040
	OS 3 – Rritja e përpunimit lokal dhe e vlerës së shtuar në vend	3.2 Krijimi i të paktën 2 zonave industriale minerare (hubs për pasurim, rafinim, prodhim material)	≥2 zona industriale të miratuara dhe funksionale deri në 2040	MIE, AIDA, Bashkitë, AKBN, RIC Albania	2027–2040
		3.4 Reduktimi i eksportit të lëndës së papërpunuar; Arritja e objektivit që të paktën 30% e kromit, bakrit dhe nikelit të përpunohet në vend	% e xeherorit të përpunuar në territor; raportime vjetore	MIE, AKBN	2026–2030
		3.5 Nxitja e investimeve të direkte në zinxhirin e përpunimit të CRM (ferrokrom, bateri, aliazh)	Rritje 50% e investimeve private në projekte të integruara CRM deri në 2035	MIE, AKBN, RIC Albania	2026–2035
	OS 4 – Zhvillimi i industrisë përpunuese dhe ricikluese të lidhur (mbetje/mining waste)	4.1 Hartimi i Planit Kombëtar për Riciklimin dhe Valorizimin e mbetjeve minerare (mining-waste to resources)	Plani i miratuar; lista e prioriteteve për dambat dhe skoriet	MIE, MTE, AKBN	2026-2028

		4.2 Identifikimi dhe karakterizimi i dambave dhe skorieve historike (Rubik, Kurbnesh, Kukës, Burrel, Elbasan) për rikuperim metalesh	Raporte teknike për çdo sit; databazë e përditësuar për Cu, Zn, Ni, Co, Cr, REE	AKBN, SHGJSH, RIC Albania	2026–2028
		4.3 Zbatimi i projekteve të riciklimit/valorizimit për të paktën 20% të sterileve ekzistuese deri në 2035	% e sterileve të rikuperuara; volum metalesh të rikuperuara	MIE, operatorë privatë	2026–2035
		4.4 Zbatimi i kuadrit “end-of-waste” dhe certifikimi ambiental i impianteve të pasurimit	Kuadri end-of-waste i miratuar; nr. impianteve të certifikuara deri në 2030	MTE, MIE	2026–2035
		4.5 Krijimi i Fondit të Rehabilitimit të Zonave Minerare dhe Task-Force Kombëtare për Mbetjet Minerare	Fondet funksionale; Task-Force operacionale deri në 2027	MIE, AKBN, MTE	2026–2030
POLITIKA 2	OS 5 – Integrimi i zinxhirit të furnizimit dhe projekteve strategjike në kuadër të CRM Act	5.1 Identifikimi dhe zhvillimi i projekteve kombëtare/rajonale që mund të klasifikohen si “Strategic Projects under the CRM Act”	≥3 projekte të regjistruara si Strategjike deri në 2040	MIE, RIC, AKBN	2026–2040
		5.2 Krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit industrial dhe teknologjik me kompani evropiane (çelik, bateri, aero-hapësirë)	Nr. marrëveshjeve të nënshkruara; volum eksportesh të produkteve të përpunuara	MIE, RIC Albania, operatorë privatë	2026–2035
Totali (000 Leke)	2,300,000				
Totali 2026-2030	5,273,384				
Totali 2031-2040	7,573,384				

MATRICA E MASAVE – POLITIKA 3

“SIGURIA, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM”

POLITIKA	OBJEKTIVI SPECIFIK	MASAT PRIORITARE	TREGUESIT	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	AFATI
POLITIKA 3 – Siguria, Mjedisi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm	OS1 – Rritja e sigurisë teknike në punë	1.1 Forcimi i kapaciteteve inspektuese të AKSEM (pajisje, staf, trajnime)	Nr. inspektimeve; staf i trajnuar; pajisje të blera	AKSEM	2026–2030
		1.2 Përditësimi i Rregullores së Sigurisë Minerare me praktikat më të mira të BE së	Rregullorja e miratuar	MIE, AKSEM, AKBN	2026–2030
		1.3 Instalimi i sistemeve të monitorimit në kohë reale (ventilim, gazra, gjeoteknikë)	Nr. sistemeve të instaluara	AKSEM	2026–2040
		1.4 Program kombëtar trajnimesh për sigurinë në punë	Nr. punonjësve të trajnuar	AKSEM, AKBN, RIC Albania	2026–2030
		1.5 Audit teknik i detyrueshëm vjetor për minierat aktive	100% minierave të audituara	AKSEM, AKBN	2026–2040
POLITIKA 3	OS2 – Rehabilitimi i zonave të ndotura	2.1 Krijimi i Fondit Kombëtar të Rehabilitimit të Zonave Minerare	Fondi funksional; buxhet i alokuar	MIE, MF, AKBN	2026–2040
		2.2 Hartimi i Planit Kombëtar të Rehabilitimit	Plani i miratuar	MIE, MTE, AKBN	2026–2030
		2.3 Inventarizim dhe hartëzim i ndotjeve minerare + databaza kombëtare	Databaza funksionale	AKBN, SHGJSH, RIC Albania	2026–2030
		2.4 Zbatimi i të paktën 3 projekteve madhore rehabilitimi deri në 2040	Nr. projekteve të realizuara	AKBN, AKSEM	2027–2040
		2.6 Monitorim vjetor i zonave të pezulluara/revokuara	Raporte vjetore monitorimi	AKBN, AKSEM	2026–2030
POLITIKA 3	OS3 – Standardet mjedisore dhe ESG	3.1 Certifikim i detyrueshëm mjedisor (ISO 14001, ESG) për impiantet e reja	100% impianteve të rinj të certifikuar	MIE, AKBN	2026–2040
		3.6 Reduktim me 30% të konsumit energjetik/ton deri në 2040	Raporte ESG	Operatorët, MIE	2026–2040
POLITIKA 3	OS4 – Përshpejtimi i tranzicionit drejt dekarbonizimit dhe përshtatjes klimatike	4.1 Zbatimi i Planit të Uljes së Emetimeve të GHG në industrinë minerare (target vjetor/ton)	Raporte vjetore GHG, ton CO2 eq kursyer	MIE, MTM, AKBN	2026-2040
		4.4 Zbatimi i Direktivës ETS/CBAM dhe raportimi i carbon footprint	Raporte vjetore, nr. kompanive të përfshira	MIE, MTM, AKBN	2026-2040
Totali (000 Leke)		1,000,000			
Totali 2026-2030		2,292,776			
Totali 2031-2040		3,292,776			

“FORCIMI I KAPITALIT NJERËZOR DHE TEKNOLOGJISË”

POLITIKA	OBJEKTIVI SPECIFIK	MASAT PRIORITARE	TREGUESIT	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	AFATI
POLITIKA 4 – Forcimi i kapitalit njerëzor dhe teknologjisë	OS4.1 – Nxitja e interesit publik dhe të rinjve për arsimim ne gjeologji dhe miniera	4.1.1 Fushata kombëtare për promovimin e profesioneve minerare/CRM	Nr. aktiviteteve	MIE, RIC Albania, UT	2026–2040
		4.1.2 Program kombëtar bursash për degët teknike	Nr. bursave	MAS, MIE, RIC Albania	2026–2040
		4.1.3 “Java e Mineraleve” + vizita studimore	Nr. nxënësve pjesëmarrës	RIC, Shkolla profesionale, UT	2026–2040
		4.1.4 Platformë informuese, educative për zonat minerare	Platforma funksionale	RIC Albania	2026–2030
POLITIKA 4	OS4.2 – Përshtatja e programeve arsimore, kërkimore dhe profesionale me tregun modern të punës	4.2.1 Azhornimi i kurrikulave universitare dhe profesionale	Kurrikula të miratuara	MAS, UT, Shkolla profesionale, RIC Albania	2026–2030
		4.2.2 Futja e moduleve IA, GIS, HSE, modelim 3D	Nr. moduleve të reja	UT-FGJM, RIC Albania	2026–2040
		4.2.3 Skema e praktikave profesionale me industrinë	Nr. kompanive të përfshira	UT, MIE, RIC Albania, Operatorët minerare	2026–2040
POLITIKA 4	OS4.3 – Krijimi i infrastrukturës moderne kërkimore dhe laboratorike	4.3.1 Krijimi i Qendrës Kombëtare të Trajnimit dhe Laboratorëve CRM	Qendra funksionale	RIC Albania	2026–2030
		4.3.2 Modernizimi i laboratorëve	Nr. laboratorëve të modernizuar	SHGJSH, AKBN	2026–2040
		4.3.3 Impiant pilot për testimin e teknologjive të reja	Impianti funksional	MIE, RIC Albania, AKBN	2027–2040
POLITIKA 4	OS4.4 – Nxitja e rikthimit të specialistëve të diasporës dhe forcimi i arsimit profesional	4.4.1 Program për rikthimin e ekspertëve të diasporës	Nr. ekspertëve të rikthyer	MIE, RIC Albania	2026–2040
		4.4.2 Program mentorimi diaspora–universitet	Nr. mentorëve; nr. studentëve	RIC Albania, UT	2026–2040
POLITIKA 4	OS4.5 – Rritja e kapaciteteve institucionale për monitorim, kontroll dhe menaxhim cilësor	4.5.1 Trajnime të avancuara për monitorimin e shfrytëzimit te minierave ne siperfaqe apo nentokesore	Nr. inspektorëve të certifikuar	AKBN, AKSEM	2026–2040
		4.5.2 Pajisje digjitale dhe sisteme monitorimi në kohë reale	Nr. pajisjeve të instaluara	AKSEM, AKBN	2026–2040
Totali (000 Leke)		800,000			
Totali 2026-2030		1,834,221			
Totali 2031-2040		2,634,221			

MATRICA E MASAVE – POLITIKA 5

“INFORMACION I INTEGRUAR DHE TRANSPARENCË NË SEKTORIN MINERAR”

POLITIKA	OBJEKTIVI SPECIFIK	MASAT PRIORITARE	TREGUESIT	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	AFATI
POLITIKA 5	OS5.1 – Krijimi i një databaze kombëtare të integruar dhe dixhitale për të gjitha të dhënat minerare dhe gjeologjike	5.1.2 Ndërtimi i databazës kombëtare të integruar minerare	Databaza funksionale	RIC Albania, AKBN, SHGJSH	2026–2040
		5.1.3 Dixhitalizimi dhe harmonizimi i arkivave gjeologjike/hartografike	Nr. materialeve të dixhitalizuara	SHGJSH, AKBN	2026–2040
		5.1.4 Integrimi i të dhënave të lejeve, prodhimit, rezervave dhe hartave në një sistem të vetëm	Nr. moduleve të integruara	AKBN, SHGJSH, RIC Albania	2026–2040
POLITIKA 5	OS5.2 – Sigurimi i aksesit të strukturuar dhe të diferencuar për përdoruesit publikë dhe privatë	5.2.1 Krijimi i sistemit me nivele të diferencuara qasjeje	Sistemi i aksesit funksional	MIE, RIC Albania, AKBN, SHGJSH	2026–2040
		5.2.2 Vendosja e protokolleve të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave	Protokollet në zbatim	MIE, RIC Albania, AKBN, SHGJSH	2026–2040
		5.2.3 Trajnime për përdoruesit institucionalë dhe privatë	Nr. përdoruesve të trajnuar	RIC Albania	2026–2040
POLITIKA 5	OS5.3 – Mbështetja e vendimmarrjes strategjike, planifikimit të qëndrueshëm dhe transparencës publike	5.3.1 Publikimi vjetor i Raportit Kombëtar të Sektorit Minerar	Raporti vjetor i publikuar	MIE, RIC Albania, AKBN, SHGJSH, Albeiti	2026–2040
		5.3.2 Identifikimi dhe publikimi i zonave me potencial minerar	Nr. zonave të publikuara	AKBN, SHGJSH	2026–2040
		5.3.3 Mekanizma konsultimi publik dhe transparencë komunitare	Nr. konsultimeve vjetore	MIE, RIC Albania, AKBN, SHGJSH, Bashkitë, AlbEiti	2026–2040
Totali (000 leke)		412,000			
Totali 2026-2030		944,624			
Totali 2031-2040		1,356,624			

10.2 ANEKS 2 – REZERVAT MINERARE, TREGUESIT SASIORE DHE CILESORE

Nr	Lloji i Mineralit	Sasia (në ton/m ³)	Përmbajtja mesatare
1	Kromi	31,074,927 ton	29.93 % Cr ₂ O ₃
2	Bakri	40,250,498 ton	1.45 % Cu
3	Zinku	3,038,211 ton	1.61 % Zn
4	Ari	3,419 kg	3.035 gr/ton Au
5	Hekur - Nikeli	247,884,220 ton	44.3 % Fe ₂ O ₃
6	Hekuri pa nikel	3,923,700 ton	24.22% Fe ₂ O ₃
7	Nikeli Silikat	104,096,767 ton	1.16% Ni
8	Nikeli sulfur	2,222,758 ton	0.34 % Ni
9	Titanomagnetiti	78,323,738 ton	6.01% TiO ₂
10	Boksitet	20,029,883 ton	42.03 %
11	Platini (EGP)	572 kg	0.5-4 gr/t Pt
12	Arseniku	10,000 ton	As 13.25%
13	Mangani	309,600 ton	21.96% MnO
14	Uraniumi	29,000 ton	0.01-0.77% U ₃ O ₈
15	Polimetalet	654,300 ton	0.8% Zn
15	Albitofiret	2,000,000 ton	63.93-71.74% SiO ₂
16	Argjilat	221,979,365 ton	9-14% Al ₂ O ₃
17	Asbesti	31,099,860 ton	
18	Bariti	60,227 ton	38.06 % BaSO ₄
19	Bazaltet	75,732,694 m ³	
20	Bojërat e dheut	215,500 ton	
21	Dolomitet	151,928,000 ton	18-21.7% MgO
22	Fluoriti	76,728 ton	65 % CaF ₂
23	Fosforitet	46,587,088 ton	5-33 % P ₂ O ₅
24	Fosforitet uranmbajtëse	2,968,000 ton	4-10 % P ₂ O ₅ ; 0.03-0.045 U ₃ O ₈
25	Gëlqerorët	939,448,663 m ³	
26	Gurët dekorativë	52,4180,359 m ³	
27	Gipset	114,053,600 ton	75-94.74% CaSO ₄ ·2H ₂ O
28	Granitet	932,019 ton	
29	Talku, gurët e talkut	851,642 ton	23-28% MgO

30	Inerte lumore	521,476,384 m ³	
31	Inertet karbonatike	23,459,687 m ³	
32	Kaolina	4,165,100 ton	21-34.22% Al ₂ O ₃
33	Kripa e gurit	607,350,000 ton	64-90% NaCl
34	Kuarci	18,480,000 ton	93-99% SiO ₂
35	Kuarcitet	7,028,764 ton	91-98% SiO ₂
36	Magnezitet	1,096,800 ton	23.89-45.95 MgO
37	Olivinitet	47,213,768 m ³	46.2-51.52% MgO
38	Rërat kuarcore	25,1403,085 ton	53.2-88.65% SiO ₂
39	Selenitet	180,000 ton	
40	Shkrifërimet	106,120,470 ton	
41	Silicorët	803,000 ton	82-89% SiO ₂
42	Squfuri	1,716,254 ton	30.6-44.98% S
43	Travertinat	308,949 m ³	
44	Trepelet	3,650,000 ton	65-90% SiO ₂
45	Tufet vullkanike	2,943,000 ton	40-77% SiO ₂
46	Xhami vullkanik	2,084,000 ton	48-88% SiO ₂
47	Qymyret	767,599,000 ton	1800-3600 kkal/kg
48	Bitumet	7,523,000 ton	9117 kkal/kg
49	Torfat	143,507,875 ton	1800-2700 kkal/kg
50	Ranorët bituminozë	347,139,347 ton	8-10 % bitum
51	Pirobitume (Zhavorr bituminoz)	5,639,683 ton	4500 kkal/kg

Burimi: Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore